



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM PËR RAPORTIN
FINANCIAR VJETOR TË QEVERISË PËR BUXHETIN E
REPUBLIKËS SË KOSOVËS
2020**

Prishtinë, gusht 2021

Tabela e përmbatjes

Lista e shkurtesave.....	4
Fjala e Auditorës së Përgjithshme.....	5
Hyrje.....	6
Përmbledhja ekzekutive.....	7
Pjesa e parë: Pasqyrat Financiare Vjetore	11
1. Auditimi i Raportit Financiar Vjetor 2020	11
1.1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	12
1.2 Opinioni i auditimit	13
2. Deklarata mbi kufirin e lejuar të deficitit buxhetor	16
3. Siguria e informacionit në SIMFK.....	21
3.1 Kontrollët e sigurisë së informacionit	21
3.2 Kontrollët e aplikacioneve të teknologjisë së informacionit.....	26
4. Analiza e Buxhetit Shtetëror	32
4.1 Analiza e të hyrave të përgjithshme buxhetore dhe e shpenzimeve.....	35
4.2.1 Analiza e të hyrave buxhetore sipas kategorive ekonomike	36
4.2.2 Analiza e të hyrave buxhetore (struktura)	37
4.2.3 Analiza e shpenzimeve sipas kategorive	40
4.2.4 Realizimi i shpenzimeve buxhetore (struktura e shpenzimeve)	42
4.2 Pasqyra e pasurive në para të gatshme dhe bilanceve të fondeve	51
5. Analiza e shënimeve shpjeguese.....	53
5.1 Baza e përgatitjes, politikat kontabël dhe raportimi	53
5.2 Konsolidimi i të dhënave nga Pasqyrat individuale me Pasqyrat e Qeverisë	54
5.3 Borxhet publike (të brendshme dhe të jashtme) dhe garancitë shtetërore, si dhe stoqet e borxhit shtetëror	55
6. Pasuritë	61
7. Llogaritë e arkëtueshme	64
8. Detyrimet e papaguara dhe ato kontingjente	67
9. Pagesat sipas nenit 39.2 të LMFPF.....	70
9.1 Pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe përmbartimore	71
10. Të dhënat e punësimit	73
10.1 Të punësuarit jashtë listës së pagave.....	73
10.2 Të punësuarit përmes Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta	73
Pjesa e dytë – Përmbledhja e rezultateve të auditimeve individuale.....	74
11. Zbatimi i rekomandimeve	74

11.1	Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në RVA-në për 2019.....	74
11.2	Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale 2019.....	75
12.	Opinionet e auditimeve në raportet individuale 2020	78
12.1	Rekomandimet e dhëna në raportet individuale për vitin 2020.....	78
13.	Sistemi i auditimit të brendshëm.....	80
14.	Prokurimi.....	82
14.1	Parregullsitë në fushën e prokurimit publik.....	82
15.	Aplikueshmëria e ligjeve dhe sfidat ligjore	85
16.	Çështjet e ndërlidhura me shpenzimet për menaxhimin e pandemisë Covid -19.....	87
	Pjesa e tretë - Auditimet e performancës dhe ndërmarrjeve publike	89
17.	Auditimet e performancës	89
18.	Ndërmarrjet Publike.....	96
18.1	Opinionet e auditimit për Ndërmarrjet Publike.....	96
18.2	Rekomandimet e vitit paraprak dhe niveli i zbatimit.....	97
18.3	Prokurimet në ndërmarrjet publike	98
18.4	Analiza e gjendjes financiare në Ndërmarrjet Publike	101
	Shtojcat:	103
	Shtojca I: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna në RVA 2019.....	104
	Shtojca II: Shpjegimi i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	118
	Shtojca III: Letra e konfirmimit.....	121
	Shtojca IV: Pasqyrat kryesore financiare të Qeverisë 2020	122

Lista e shkurtesave

AP	Auditori i Përgjithshëm	MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit	MF	Ministria e Financave ¹
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës	MAPL	Ministria e Administratës Publike
BB	Banka Botërore	MFPP	Menaxhimi i Financave Publike dhe Përgjegjësitë
BE	Bashkimi Evropian	MAP	Ministria e Administratës Publike
BPV	Bruto Produkti Vendor	MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
BRK	Buxheti i Republikës së Kosovës	NJQH/AB	Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm
BQK	Banka Qendrore e Kosovës	NjAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
DK	Doganat e Kosovës	NP	Ndërmarrjet Publike
GPD	Grantet e Përcaktuara të Donatorëve	OB	Organizata Buxhetore
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar	OShP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
IFN	Institucionet Financiare Ndërkombëtare	PFV	Pasqyrat Financiare Vjetore
KA	Komiteti i Auditimit	ShSKUK	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
KBFP	Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike	RFV/BRK	Raporti Financiar Vjetor i Buxhetit të Republikës së Kosovës
KMFP	Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike	RVA	Raporti Vjetor i Auditimit
LMFPP	Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë	SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës
LPP	Ligji për Prokurim Publik	SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
LShC	Ligji i Shërbimit Civil	SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik
LIVTh	Llogaria e Vetme e Thesarit	SFQ	Statistikat Financiare Qeveritare të FMN-së
KOSTT	Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës	ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
KRPP	Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik		
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli		

¹ Nga viti 2021 kjo Ministri është riemëruar si Ministria e Financave, Punës dhe Tranfereve (MFPT)

Fjala e Auditorës së Përgjithshme

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Kam kënaqësinë që t'iu dorëzoj Raportin Vjetor të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Buxhetit të Republikës të Kosovës, të vitit 2020. Duke qenë se ky është komunikimi i im i parë formal, në cilësinë e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës, më lejoni që fillimisht të shpreh konsideratën time për besimin që më keni dhënë për të udhëhequr me një institucion kaq të rëndësishëm për vendin. Unë zotohem që këtë besim tuajin do ta kthej në përgjegjësi dhe përkushtim për të përmbushur mandatin tim ligjor e kushtetues.

Gjatë sezonit auditues 2020/21, kemi kryer 127 auditime, që përfshijnë: raportin financiar vjetor të buxhetit të Republikës së Kosovës me vlerë rreth 2.5 miliardë euro; 90 organizata buxhetore; 12 ndërmarrje publike nga sektorë të ndryshëm; 11 auditime të performancës si dhe 13 projekte të financuara nga Banka Botërore dhe SIDA.

Edhe gjatë këtij sezoni auditues, jemi fokusuar në vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, pajtueshmërinë e vendimeve të subjekteve të audituara me kuadrin ligjor, cilësinë e raportimit financiar, si dhe çështjet që kanë të bëjnë me vlerën për para. Përveç çështjeve të përsëritura përsa i përket mangësive në planifikimin buxhetor, auditimet tona kanë rezultuar me një numër gjetjesh edhe në fushat tjera, prej të cilave do të veçoja në radhë të parë nevojën për përmirësimin e menaxhimit të pasurisë, të borxhit publik, të detyrimeve të papaguara, të llogarive të arkëtueshme, etj.

Zyra Kombëtare e Auditimit, në kuadër të auditimit të buxhetit të shtetit, ka kryer edhe auditimin e Teknologjisë së Informacionit në Thesar për të vlerësuar nëse ky institucion ka krijuar ambient të sigurt në mënyrë që Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës të ruaj integritetin, konfidencialitetin dhe disponueshmërinë e tij. Rezultatet e auditimit kanë treguar se përkundër përmirësimeve të ndërmarra në këtë sistem, ende nevojitet të forcohen mekanizmat për siguri të informacionit, në mënyrë që sistemet e informacionit të jenë më të mbrojtura.

Shqetësuese vazhdon të mbetet niveli jo i kënaqshëm i zbatimit të rekomandimeve. Ndonëse përpjekjet e koordinuara të ZKA-së dhe të komisioneve parlamentare të Kuvendit për rritjen e përgjegjësisë së drejtuesve të subjekteve të audituara kanë filluar të japin efekte pozitive (është rritur përqindja e rekomandimeve të zbatuara nga 40% në vitin paraprak, në 45% për vitin aktual), përmirësimi i mëtejshëm në këtë fushë, kërkon përkushtim më të madh të vendimmarrësve.

Më lejoni që në fund të këtij adresimi, të falënderoj Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe komisionet parlamentare për mbështetjen dhe bashkëpunimin korrekt gjatë këtij sezoni auditues. Dëshiroj poashtu, të shpreh vlerësimin tim për sjelljen bashkëpunuese të të gjitha subjekteve të audituara, gjatë procesit të auditimit.

Një falënderim i veçantë për personelin e ZKA-së, të cilët në rrethana sfiduese të pandemisë kanë dhënë maksimumin nga vetja për të përmbyllur me sukses këtë sezonë të auditimit, gjatë së cilës për herë të parë, është zbatuar sistemi elektronik për menaxhimin e auditimit dhe metodologjia e përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë.

Auditore e Përgjithshme,

Prishtinë, gusht 2021

Vlora Spanca

Hyrje

Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) paraqet një dokument përmbledhës të gjetjeve dhe konkluzioneve të auditimit, si dhe rekomandimeve të dhëna për vitin fiskal 2020 dhe shpreh Opinionin e Auditimit (në përputhje me SNISA 200) për Raportin Financiar Vjetor të Qeverisë së Kosovës për vitin 2020. Raporti prezanton një përmbledhje të çështjeve kyçe në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrolleve dhe i mundëson Kuvendit iniciimin dhe zbatimin e llogaridhënies financiare të Qeverisë për përdorimin e burimeve publike.

Në këtë raport, fushë e veçantë e rishikimit është Raporti Financiar Vjetor i Qeverisë, por pjesë të raportit janë edhe gjetjet dhe konkluzionet e dala nga raportet individuale të auditimeve të kryera për organizatat buxhetore dhe autoritetet tjera publike. Këtë vit për herë të parë ky raport përmban edhe rezultatet nga auditimi i teknologjisë së informacionit që është kryer në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës. Pra, raporti paraqet një version të zgjeruar dhe përveç auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë, përfshin informata edhe për auditime të tjera të kryera gjatë sezonit auditues 2020/2021, siç janë auditimet e performancës, të menaxhimit, sistemeve të teknologjisë së informacionit, të projekteve të donatorëve, etj.

Raporti përmban tri pjesë kryesore:

- (a) pjesa e parë paraqet rezultatet e auditimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të Qeverisë për vitin 2020;
- (b) pjesa e dytë paraqet informata të rëndësishme për vitin raportues, por që nuk kanë ndonjë lidhje direkte dhe nuk i ndikojnë PFV-të e Qeverisë; dhe
- c) pjesa e tretë paraqet informata për shpenzimet e menaxhimit të Covid-19, auditimet e performancës dhe të ndërmarrjeve publike.

Pjesa e parë përmban dhjetë kapituj kryesor që janë pjesë përbërëse të PFV-ve të BRK-së: (1) Opinioni i auditimit; (2) Deklarata mbi kufirin e lejuar të deficitit buxhetor, (3) Siguria e informacionit në SIMFK; (4) Analizat e Buxhetit Shtetëror; (5) Analiza e shënimeve shpjeguese; (6) Pasuritë; (7) Llogaritë e arkëtueshme; (8) Detyrimet e papaguara dhe kontingjente; (9) Pagesat sipas nenit 39.2 të LMFP; dhe (10) Të dhënat e punësimit.

Pjesa e dytë përmban informacione për çështjet si vijon: (11) Zbatimi i rekomandimeve nga vitet paraprake; (12) Opinionet e auditimeve individuale; (13) Sistemi i auditimit të brendshëm; (14) Prokurimi; dhe (15) Aplikueshmëria e ligjeve dhe sfiadat ligjore;

Pjesa e tretë përmban kapitujt: (16) Çështjet e ndërlidhura me shpenzimet për menaxhimin e pandemisë Covid-19, (17) Auditimet e performancës; dhe (18) Ndërmarrjet publike.

Përveç tri pjesëve kryesore, raporti ka edhe tri Shtojca, të cilat kanë të bëjnë me: (1) Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna në RVA-në 2019; (2) Shpjegimi i llojeve të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja; dhe (3) Pasqyrat Financiare të Qeverisë.

Informacione më të hollësishme për raportet individuale të auditimit, mund të gjeni në faqen tonë të internetit: <https://www.zka-rks.org>

Përmbledhja ekzekutive

Në pajtim me Planin vjetor të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit gjatë sezonit auditues 2020/21 ka kryer 127 raporte, prej të cilave: Reportin për Pasqyrat Financiare të Qeverisë, 90 Auditime Financiare dhe të Pajtushmërisë për organizata buxhetore, 12 auditime të ndërmarrjeve publike, 13 auditime të projekteve të Bankës Botërore dhe donatorëve tjerë si dhe 11 auditime të performancës. Rezultatet e këtyre auditimeve janë përmbledhur në këtë Raport.

Sipas opinionit të Auditorit të Përgjithshëm, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Qeverisë për vitin 2020 paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Më gjerësisht, shih kapitullin 1.2.

Auditimet e vitit 2020 kanë nxjerrë në pah një sërë mangësish dhe dobësish në shumicën e organizatave buxhetore, të cilat karakterizojnë një menaxhim të dobët të fondeve buxhetore, si dhe mos arritjen e vlerës për para. Një qasje sistematike dhe më e fokusuar në zgjidhjen dhe adresimin e problemeve të identifikuara, do të ishte më se e nevojshme, në mënyrë që t'i hapet rrugë menaxhimit më të mirë dhe shërbimeve më të mira për qytetarët. Konkluzionet kryesore të raportit nënvizojnë nevojën për një vëmendje të shtuar të drejtuesve të subjekteve publike për forcimin e masave dhe përmirësimin e proceseve në fushat e identifikuara si në vijim:

- a) **Cilësia e raportimit** - Raporti Financiar Vjetori i Buxhetit të Republikës së Kosovës ishte përgatitur brenda afateve ligjore. Thesari kishte dorëzuar në Qeveri për aprovim këtë Raport me 16 mars 2021, ndërsa i njëjti në mënyrë zyrtare i është dorëzuar ZKA-së për auditim me 22 mars 2021. Pas rishikimeve analitike, ZKA-ja ka vërejtur disa gabime në prezantimin e të dhënave në Raport dhe të njëjtat janë diskutuar me zyrtarët e Ministrisë së Financave. Pas diskutimeve të hollësishme, Raporti në pjesë të caktuara, është plotësuar me informata shtesë, sidomos në pjesën e shpalosjeve dhe pas korrigjimeve të sugjeruara nga ekipi i auditimit, me 13 prill 2021 Raporti Financiar Vjetor është ri-aprovuar në Qeveri dhe është ri-dorëzuar tek Auditori i Përgjithshëm me 14 prill 2021. Për shkak të disa korrigjimeve të reja, me 28 korrik 2021, Qeveria ka ri-aprovuar RFV-të e BRK-së të korrigjuara dhe një kopje të tyre i ka dorëzuar Auditorit të Përgjithshëm, me 30 korrik 2021, i cili është marrë për bazë për këtë raport.

Edhe përkundër këtyre korrigjimeve, Raporti Financiar Vjetor final i Buxhetit të Republikës së Kosovës, ende kishte disa gabime të cilat kanë ndikuar në Opinionin e Auditimit. Çështjet e identifikuara kanë të bëjnë me: mbivlerësimin e pranimeve në buxhetin final; transaksionin e regjistruar si pagesë, përderisa nuk kishte dalje të parasë; keqklasifikimet në kategori të ndryshme; mbivlerësimet e pasurive kapitale mbi dhe nën 1,000 € dhe mbivlerësimet e stoqeve; nënvlerësimet e obligimeve të papaguara dhe detyrimeve kontigjente; si dhe nënvlerësimet e gjendjes së llogarive të arkëtueshme.

Sa i përket pasurive kapitale mbi dhe nën 1,000 €, stoqeve, obligimeve të papaguara, detyrimeve kontigjente dhe llogarive të arkëtueshme, procesi i konsolidimit në RFV-të e BRK-së është bërë i saktë dhe i plotë. Pasaktësitë e lartëcekura, janë identifikuar nga auditimi i pasqyrave financiare vjetor të organizatave buxhetore individuale.

Në kapitujt e këtij Raporti, do të flitet më gjerësisht lidhur me procesin e përgatitjes të RFV-së dhe cilësinë e informatave të prezantuara.

- b) **Planifikimi dhe realizimi i buxhetit** - Ndryshimet ndërmjet buxhetit fillestar dhe atij final, vërehen me një rritje si në aspektin e planifikimit të pranimeve, po ashtu edhe të pagesave. Sipas ligjit të buxhetit fillestar, pranimet ishin planifikuar rreth 2,5 miliardë € apo për 21 milionë € (1%) më të ulëta se pagesat. Ndërkaq, sipas buxhetit final në SIMFK, pagesat ishin planifikuar të jenë më të larta se pranimet për 205 milionë €. Dallimet në mes projeksioneve fillestare dhe përfundimtare të buxhetit janë të theksuara, për shkak të ndikimit të pandemisë Covid-19. Qeveria kishte ndërmarrë masa për rishikimin e të hyrave tatimore dhe jotatimore duke i zvogëluar ato, ndërsa projeksionet për financimin nga huamarrja ishin rritur me rishikim të buxhetit. Përmes Vendimeve të Qeverisë, janë bërë lëvizje buxhetore në organizata buxhetore të ndryshme, ku në kategori të caktuara ekonomike dhe projekte ishte rritur buxheti, kurse në disa të tjera ishte zvogëluar. Realizimi i buxhetit edhe këtë vit është përcjellur me mangësi të ndryshme, ku reduktimi i fondeve nga Qeveria ka ndikuar që shumta të konsiderueshme të detyrimeve të mbesin të papaguara dhe shumë projekte të mos realizohen dhe të barten për vitet vijuese. Arsye tjetër për shkallën e ulët të realizimit të buxhetit ishte procesi jo i mirëfilltë i planifikimit, realizimit dhe monitorimit të projekteve kapitale. Kemi identifikuar OB që kishin përqindje të ultë të realizimit të buxhetit në nivel të projekteve kapitale, ndërsa po të njëjtat OB në fund të vitit kanë raportuar vlera të larta për obligimet e papaguara. Pranimet ishin realizuar për 83.5% e buxhetit final, e që krahasuar me vitin e paraprak, ato kanë shënuar rritje simbolike për 0.73%. Sa i përket pagesave, realizimi për vitin 2020 ishte në shkallë prej 82% të buxhetit final. Ndërkaq, nëse krahasojmë me realizimin e vitit paraprak, ka pasur rritje për 8.47%.
- c) **Deficiti buxhetor** - neni 22.A.1 i LMFPP-së, përcakton se asnjë ligj për ndarjet buxhetore nuk duhet të përfshijë një deficit të përgjithshëm që kalon nivelin prej 2% të Bruto Produktit Vendor (BPV) së parashikuar. Megjithatë, me kërkesë të Qeverisë, Kuvendi i Republikës së Kosovës për vitin 2020, ka përcaktuar rritjen e përkohshme të kufirit të deficitit deri në 6.5%, ndërsa kufiri i bilancit të shfrytëzueshëm bankar është zvogëluar përkohësisht deri në 3% të BPV-së. Sipas përlllogaritjeve të MF-së, deficiti i përgjithshëm në bazë të Buxhetit të rishikuar, sipas rritjes së përkohshme të kufirit të lejuar, ishte -451,199,000 €. Ndërkaq, sipas auditimit rezulton të jetë -493,199,000 € (ose 7.09%), ku kemi një tejkalim për 40,734,000 € (ose 0.59% nga përqindja e lejuar). Ekzaminimet tona kanë treguar që një tejkalim i kufirit të lejuar të deficitit buxhetor ekzistonte edhe në Buxhetin fillestar. Përlllogaritjet sipas MF-së, kishin paraqitur deficitin në shumën prej -146,761,000 €. Ndërkaq, sipas auditimit, ky deficit ka rezultuar të jetë -168,761,000 € (ose 2.26%). Nga kjo, vërehet se edhe deficiti i planifikuar në buxhetin fillestar tejkalonte përqindjen e lejuar me rregullën fiskale për 0.26%.
- d) **SIMFK** - Rezultatet e auditimit kanë treguar se Thesari pas identifikimit të disa mangësive në nivelet e kontrollit të Sistemit Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës kishte marrë një sërë veprimesh për të forcuar sigurinë e këtij sistemi, mirëpo, nevojitet të forcohen tutje mekanizmat për siguri të informacionit në mënyrë që sistemet e informacionit të jenë më të mbrojtura. Po ashtu duhet të forcohen kontrollet e vlefshmërisë së të dhënave në SIMFK në atë mënyrë që ky sistem të pranojë të dhëna sipas rregullave të paracaktuara nga institucioni dhe të dhënat dalëse të jenë të sakta dhe të plota.
- e) **Keqklasifikimi i shpenzimeve** - Vazhdon të mbetet fusha më problematike në aspektin e raportimit. Edhe gjatë këtij viti, janë identifikuar shumta të larta të keqklasifikimit të shpenzimeve nëpër kategori të ndryshme ekonomike, që në total janë 17,808,180 €. Pjesa dërmuese e këtyre keqklasifikimeve ndodhë për tri arsye: **e para**, gabimet që bëhen me rastin e planifikimeve përmes procesit buxhetor (9,222,677 €); **e dyta**, ekzekutimi i pagesave të detyrueshme (vendime gjyqësore dhe përmbartimore, pagesa direkte sipas autorizimit të LMFPP neni 39.2 nga ana e Thesarit nga kategoritë jo adekuate dhe kryesisht për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore në kategorinë përkatëse (7,626,198 €); dhe **e treta**, gjatë vitit, OB-të për arsye të ndryshme kryejnë pagesa nga kategoritë joadekuate (959,305 €).

Kategoria më e ndikuar nga keqklasifikimet ishin Investimet Kapitale, nga e cila ishin paguar Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shërbime, si dhe Subvencione dhe Transfere, në shumë prej 9,122,056 €. Pas shumë rekomandimeve të dhëna gjatë auditimeve paraprake, kjo gjendje ka filluar të përmirësohet, por ende nuk është zgjidhur tërësisht. Kjo situatë po vazhdon, për shkak se edhe gjatë shqyrtimeve buxhetore në Kuvend me amandamente të ndryshme ndërhyhet në ndryshimet buxhetore, me ç'rast nuk merren parasysh ndarjet sipas kategorive adekuate dhe si pasojë, keqklasifikimet legjitimohen edhe me ligj të buxhetit dhe si të tilla, procedohen në mënyrë të gabuar gjatë vitit nga organizatat buxhetore. Pagesat nga kategoria e investimeve kapitale për kategori tjera ndikojnë që projektet kapitale mos të kryhen sipas planifikimit, rrjedhimisht të ketë vonesa në vënien e tyre në funksion.

- f) **Borxhi publik** - Buxheti i Kosovës përveç të hyrave të rregullta, financohet edhe nga huamarrjet e brendshme dhe të jashtme, të cilat në fund të vitit 2020 kanë arritur shumën prej 1,487.7 milionë €, duke mos i llogaritur edhe 31.6 milionë € garancione shtetërore. Prej totalit të borxheve, 525.8 milionë € janë borxhe të jashtme dhe 961.9 milionë € borxhe të brendshme. Në fund të vitit 2020 niveli i borxhit publik ishte 21.83% e Bruto Produktit Vendor (6,961 milionë €). Rritja e borxhit të përgjithshëm gjatë vitit 2020 (përfshirë edhe garancionet) ishte 275.6 milionë €. Në këtë rritje ka ndikuar borxhi i marrë për financimin dhe menaxhimin e pandemisë Covid-19, për shkak të nevojave më të mëdha se burimet në dispozicion. Buxheti total për vitin 2020 për financimin e projekteve kapitale nga huamarrja, ishte 153,1 milionë € kurse shpenzimi ishte 37,1 milionë € apo 24.2%.

Problemi kyç lidhur me këto borxhe është mosefikasiteti i shpenzimeve të fondeve të marra si hua të jashtme. Kjo për shkak se Organizatat Buxhetore janë ballafaquar me: problemet me shpronësimet të projektet e infrastrukturës, ndarjeve buxhetore të pa-harmonizuara me dinamikën e projektit, paqartësi me procedurat e prokurimit, konsolidimi i njëjësive zbatuese të projekteve janë ballafaquar me vështirësi në procesin e rekrutimit dhe mbajtjes së stafit, futjes në buxhet të disa projekteve për të cilat kreditë nuk ishin ratifikuar marrëveshjet në Kuvend si dhe efektet që ka shkaktuar pandemia Covid-19. Për rrjedhojë në disa projekte situata pandemike ka ndikuar në ndërprerjen e punimeve, kurse në raste tjera ka shkaktuar vonesa administrative.

- g) **Detyrimet e papaguara dhe ato kontingjente** - Detyrimet e papaguara të organizatave buxhetore ndaj furnizuesve dhe operatorëve tjerë ekonomik në fund të vitit 2020 ishin rreth 363 milionë € (329 milionë € të nivelit qendror dhe 34 milionë € në nivel të komunave).

Përveç këtyre detyrimeve financiare, ekzistojnë edhe disa detyrime potenciale apo kontingjente, të cilat janë rezultat i padive gjyqësore ndaj organizatave buxhetore dhe pritet të marrin epilogun gjyqësor në një të ardhme. Shuma e këtyre detyrimeve të mundshme është rreth 217 milionë € (126 milionë € në nivel qendror dhe 91 milionë € në nivel lokal), me një rritje prej 10.25% në krahasim me vitin paraprak duke treguar një përkeqësim të kësaj kategorie.

- h) **LLogaritë e arkëtueshme** - Shuma e borxheve të qytetarëve dhe bizneseve ndaj Qeverisë është rreth 692 milionë € apo 57 milionë € me të larta se vitin paraprak. Pjesa dërmuese e këtyre borxheve të pambledhura (478 milionë € në nivel qendror dhe 214 milionë € në atë lokal) ka të bëjë të me ATK-në dhe Doganën e Kosovës, të cilat së bashku kanë 408 milionë € apo rreth 59% të shumës totale.

Ndikimi i këtyre dy llogarive (të pagueshme dhe të arkëtueshme) në planifikimet buxhetore ka një rëndësi kritike, si për të hyrat, ashtu edhe për shpenzimet buxhetore, me ndikimin përfundimtar në qëndrueshmërinë makro-fiskale. Qeveria duhet të zhvilloj një strategji të veçantë se si t'i qaset mbledhjes së borxheve si dhe pagesës së detyrimeve, në mënyrë që të evitohen çrregullimet në ekuilibrin buxhetor në vitet vijuese.

- i) **Pasuritë** - Regjistrimi i pasurive në kontabilitetin qeveritar mbetet një proces i papërfunduar. Sipas zyrtarëve, njëra ndër arsye kryesore për këtë është mosgjidhja e çështjeve pronësore, kryesisht për shkak të mungesës së dokumentacionit mbi pronësinë. Totali i pasurive neto në fund të vitit ishte afër nëntë miliardë €. Si rezultat i regjistrimeve të reja gjatë vitit, saldo e pasurive kapitale (me vlerë mbi 1.000 €) në krahasim me vitin paraprak është rritur për rreth 94 milionë €. Pasuritë me vlerë nën 1,000 € në krahasim me vitin paraprak janë rritur për katër milionë €.

Problem tjetër i evidentuar gjatë auditimit tek një numër i madh i organizatave buxhetore është inventarizimi i pasurive dhe stoqeve në fund të vitit. Komisionet e inventarizimit themelohen me vonesë dhe për këtë arsye, ose i bëjnë me vonesë raportet e inventarizimit ose nuk bëjnë fare barazimet e gjendjes së regjistrimit me gjendjen kontabël. Mungesa e regjistrimeve të fundvitit pamundëson pasqyrën e plotë të ekzistencës së pasurive dhe krijon mundësinë e keqmenaxhimit, keqpërdorimit apo edhe vjedhjes së pasurive. Mos prezantimi i vlerave të sakta të pasurive ka ndikuar Opinionin e Auditimit në Raportin Vjetor të Auditimit dhe në disa opinione të raporteve të organizatave buxhetore.

- j) **Likuiditeti i organizatave buxhetore** - Mos disiplinimi financiar bën që OB-të përveç detyrimeve të shumta të papaguara, t'iu nënshtrohen edhe procedurave gjyqësore dhe/apo procedurave të ekzekutimit të pagesave direkte nga Thesari. Gjatë vitit 2020 Thesari ka ekzekutuar afër 30 milionë € pagesa në bazë të vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore apo mbi katër milionë € më shumë se vitin paraprak. Ndërsa, pagesat direkte sipas autorizimeve të Nenit 39.2 të LMFPP këtë vit kishin një rënie domethënëse krahasuar me vitin e kaluar. Gjatë vitit ishin paguar 190,698 €, ndërsa vitin paraprak këto pagesa ishin në vlerë mbi 1.5 milionë €. Arsye kryesore për këto pagesa ishin: mos kompensimi i punëtorëve për paga jubilarë, ankesa për shpronësime, vonesa në pagesat e faturave, etj.
- k) **Ndërmarrjet Publike** - Rezultatet e auditimit shpalosin se raportimi financiar i 12 ndërmarrjeve të audituara ka mangësi dhe është i pasaktë. Për këtë arsye për 10 nga 12 ndërmarrjet e audituara është dhënë opinion i modifikuar dhe vetëm dy prej tyre kanë opinion të pamodifikuar. Edhe këtë vit ndërmarrjet publike janë përcjellë me mangësi të njëjta sikurse vitet e kaluara. Mangësitë më të shpeshta ishin: mangësitë në qeverisjen korporatave (përfshirë ndarjen jo adekuate të detyrave), mos efektiviteti i auditimit të brendshëm, gabimet në PFV-të (mbivlerësimi/nënvlerësimi), etj, tregojnë për domosdoshmërinë e reformave dhe ristrukturimeve në ndërmarrjet publike të audituara.
- l) **Zbatimi i rekomandimeve** – Ndonëse janë zbatuar plotësisht ose pjesërisht mbi gjysma e rekomandimeve të dhëna në vitin paraprak në raportet individuale të auditimit, niveli i rekomandimeve të pazbatuara apo i atyre që nuk ka filluar zbatimi mbetet ende i lartë. Ndërsa nivel më i ulët i rekomandimeve të zbatuara plotësisht mbetet për ato në Raportin Financiar Vjetor të Qeverisë për vitin 2019. Vetëm tetë nga 43 janë zbatuar plotësisht, ndërsa 20 ishin në proces të zbatimit.

Pjesa e parë: Pasqyrat Financiare Vjetore

1. Auditimi i Raportit Financiar Vjetor 2020

Roli i Auditorit të Përgjithshëm është që të ofrojë një bazë për mbylljen e procesit të llogaridhënies në mes të Kuvendit dhe Qeverisë për ekzekutimin e buxhetit shtetëror gjatë vitit. Kjo arrihet duke zbatuar parimet e llogaridhënies menaxheriale në të gjitha nivelet e qeverisë, përfshirë ministritë, komunat, institucionet e pavarura dhe ndërmarrjet publike.

Auditori i Përgjithshëm, bazuar në mandatin e tij kushtetues dhe ligjor, një herë në vit kryen auditimin e Raportit Financiar Vjetor të Qeverisë për ekzekutimin e buxhetit dhe raporteve shoqëruese.

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Qeverisë 2020 bazohet në dokumentet në vijim:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës (neni 137 dhe 138);
- Ligji nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (neni 19);
- Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar (neni 47 dhe 48);
- Plani Vjetor i Auditimit për sezonin auditues 2020/2021;
- Doracaku për Auditime Financiare dhe të Pajtuëshmërisë;
- Doracaku për kontrollin e cilësisë;
- Rregullorja e MF. nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore; dhe
- Korniza e INTOSAI-t për Deklaratat Profesionale, përkatësisht, Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është planifikuar dhe është kryer duke u bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, në mënyrë që të arrihet siguri e arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime financiare dhe se aktivitetet qeveritare, transaksionet financiare dhe informatat e prezantuara janë në pajtim me ligjet, rregulloret dhe aktet tjera. Në fazën përgatitore janë identifikuar dhe vlerësuar rreziqet, mjedisi i kontrollit, si dhe kontrollet e brendshme. Në fazën e planifikimit të auditimit është përcaktuar edhe niveli i materialitetit prej 1% i shumës totale të pranimeve buxhetore, përkatësisht shkalla deri në të cilën tolerohen gabimet në prezantimin e të dhënave në PFV, e që nuk konsiderohen me ndikim domethënës për kredibilitetin e pasqyrave.

Sistemi kontabël dhe raportimi i buxhetit të Kosovës është i bazuar në para të gatshme apo në bazë të modifikuar të parasë së gatshme, ku të gjitha të hyrat dhe të dalat procesohen përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit, ndërsa regjistrohen në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK). Përkundër kësaj, organizatat buxhetore janë të obliguara të mbajnë edhe regjistra kontabël të veçantë dhe sipas Rregullores MF Nr. 01/2017 janë të detyruara që në bazë të këtyre regjistrave të përgatisin pasqyrat e tyre financiare dhe t'i raportojnë Ministrisë së Financave.

Raporti Vjetor i Auditimit i dorëzohet Qeverisë dhe Kuvendit. Ndërsa, rezultatet e auditimeve individuale i'u dërgohen Kuvendit të Kosovës, kuvendeve komunale, bordeve të drejtorëve dhe menaxhmentit të subjekteve të audituara.

Rishikimet tona analitike kanë rezultuar se asnjë nga 90² organizata buxhetore nuk kishin mospërputhje me kërkesat e Rregullores Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, sa i përket formatit, strukturës dhe afateve të raportimit.

Të gjitha OB-të kanë dorëzuar pasqyrat financiare brenda afatit ligjor, deri më 31 janar 2020. Por, deri në hartimin e Pasqyrave financiare të konsoliduara të Qeverisë (31 mars 2020), 80 OB kanë bërë korrigjime në pasqyrat e tyre, ndërsa 12 OB nuk kanë pasur nevojë për korrigjime. Mirëpo, gjatë auditimit kemi vërejtur se të një numër i konsiderueshëm i organizatave buxhetore janë identifikuar gabime të pakorrigjuara.

Nga rishikimi rezulton se gabimet e pakorrigjuara më të shpeshta në raportet individuale kanë të bëjnë me:

- diferencën në mes të shënimeve të prezantuara në Sistemin e Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK) dhe në Pasqyrat Financiare Vjetore;
- keqklasifikimin e shpenzimeve apo regjistrimin në kategori ekonomike joadekuate; dhe
- mosprezantimin e plotë të pasurive në Pasqyrat Financiare Vjetore.

Çështjet e ngritura më lartë, do të shqyrtohen në hollësi në kapitujt vijues të raportit.

1.1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Ministria e Financave është përgjegjëse që në emër të Qeverisë të përgatis dhe të prezantojë në mënyrë të drejtë Pasqyrat Financiare Vjetore sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme, si dhe është përgjegjëse për aplikimin e kontrolleve të brendshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara nga gabimet dhe mashtrimet.

Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit, i ka dorëzuar Qeverisë për aprovim, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2021 sipas afatit dhe në formatin e kërkuar me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP me ndryshime dhe plotësime) si dhe në pajtim me SNKSP-të. Më 2 prill 2021, të njëjtat janë aprovuar nga Qeveria, ndërsa me 14 prill 2021 një kopje e tyre i është dorëzuar Auditorit të Përgjithshëm. Me 28 korrik 2021, Qeveria ka riaprovuar PFV-të e BRK-së të korrigjuara dhe një kopje të tyre i'a ka dorëzuar Auditorit të Përgjithshëm, me 30 korrik 2021.

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë (financiar dhe të pajtueshmërisë) që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e PFV-ve të Qeverisë. Auditimi është fokusuar në tri pasqyrat kryesore dhe në shënimet shpjeguese/shpalosjet:

- Pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme;
- Pasqyrën e konsoliduar të krahasimit të buxhetit me ekzekutimin;
- Pasqyrën e konsoliduar të pasurive në para të gatshme dhe bilancet e fondeve; dhe
- Plotësinë dhe cilësinë e informatave në shënimet shpjeguese/shpalosjet e pasqyrave financiare.

² Në këtë numër nuk janë përfshirë, Zyra Kombëtare e Auditimit dhe Agjencia e Kosovës për Intelejencë.

Objektiv i auditimit ishte që të ofrojmë një siguri të arsyeshme:

- Nëse këto pasqyra financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, një pamje të drejtë dhe të vërtetë të gjendjes financiare për periudhën raportuese;
- Nëse pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe transaksioneve financiare për periudhën raportuese;
- Për efektivitetin e kontrolleve të brendshme të aplikuara gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare; dhe
- Nëse Qeveria ka ndërmarrë masat e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit për vitin e kaluar dhe vitet e mëhershme.

Ekzaminimi i PFV-ve të BRK-së për vitin 2020 është ndërmarrë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorin Publik (SNISA) dhe udhëzuesit e brendshëm të ZKA-së. Qasja jonë është bazuar në një kuptim të plotë të procesit përmes të cilit janë hartuar PFV-të. Ky kuptim ka të bëjë me zhvillimin e një strategjie të auditimit, e cila përqendrohet në adresimin e rreziqeve specifike për një opinion të pamodifikuar, ndërkohë që ofron një nivel të pranueshëm të sigurisë për pasqyrat e marra si tërësi.

Qasja e përzgjedhur reflekton edhe vlerësimin e rezultateve të dala nga auditimet e OB-ve të cilat janë konsoliduar në PFV-të. Vlen të theksohet se disa zëra të paqyrave të konsoliduara merren nga pasqyrat individuale, si: pasuritë, detyrimet, llogaritë e arkëtueshme, gjendja e borxheve publike, dhe më pas konsolidohen. Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim analitik të pasqyrave, vlerësimin e procesit të përgatitjes së pasqyrave, verifikimin e vlerës së llogarive në librin kryesor dhe përputhjen me vlerat e prezantuara në pasqyra financiare, vlerësimin e efektit të keqdeklarimeve të pakorrigjuara, nëse bilancet e llogarive janë materialisht të sakta dhe aty ku janë identifikuar gabime, janë bërë rregullime në pasqyrat financiare, konfirmimin se të gjitha pohimet e auditimit janë adresuar në mënyrë adekuate, rishikimin e kontrolleve të brendshme menaxheriale, sistemeve të kontabilitetit dhe një numër të konsiderueshëm testesh e procedurash, të cilat janë konsideruar si të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit.

Seksionet e mëposhtme të Raportit ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve të auditimit, si rezultat i vëzhgimeve në çdo fushë të rishikimit. Gjetjet e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha gabimeve dhe dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat qeveritare që e kanë karakterizuar vitin 2020, por gjithsesi ofrojnë një nivel të pranueshëm të sigurisë.

1.2 Opinioni i auditimit

ZKA-ja ka audituar RFV-të e BRK-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020, i cili përfshinë Pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, Pasqyrën e konsoliduar të krahasimit të buxhetit me realizimin, Pasqyrën e konsoliduar në para të gatshme dhe bilancin e fondeve dhe shënimet shpjeguese/shpalosjet e pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të kualifikuar, Raporti Financiar Vjetor i Buxhetit të Republikës së Kosovës paraqet pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme) dhe Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me ndryshime dhe plotësime).

Baza për Opinion të Kualifikuar

Gjatë analizimit të RFV-ve të BRK-së kemi identifikuar këto çështje:

- Në pasqyrën e konsoliduar të krahasimit të buxhetit me realizimin, në rrjedhën hyrëse të parasë së gatshme, tek buxheti final, kemi identifikuar se në pozicionin e të hyrave tjera në shumën prej 244,609,000 €, janë përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura në shumën prej 42,000,000 €. Kjo vlerë ishte pjesë e tabelës 1. Parashikimet fiskale të hyrat dhe shpenzimet në ligjin e buxhetit, tek pjesa C – financimi i brendshëm si pranime, ku ishin përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura nga komunat. Rrjedhimisht, kjo shumë kishte mbivlerësuar pranimet totale të prezantuara në buxhetin final. Ndërsa, sipas ligjit të buxhetit fillestar, mbivlerësimi për këto të hyra vetanake të bartura ishte në shumën prej 22,000,000 €;
- Gjatë vitit 2020 kemi identifikuar se janë klasifikuar nëpër kategori ekonomike joadekuate shpenzime në shumën prej 17,808,180 €. Kjo ka ndodhur pasi me buxhet ishin planifikuar dhe klasifikuar shpenzimet nëpër kategori ekonomike joadekuate qysh në fazën e aprovimit të Buxhetit vjetor 2020, të cilat më pas, gjatë vitit edhe janë shpenzuar dhe regjistruar në kodet e gabuara ekonomike. Përveç kësaj, keqklasifikime ishin bërë edhe përmes pagesave tjera në bazë të vendimeve gjyqësore për kompensimin e pagave jubilarë, pagave përcjellëse, shujtave dhe shpenzimeve tjera të procedurave gjyqësore, duke nënvlerësuar kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve;
- Pagesat totale të prezantuara në RFV-të e BRK-së në shumë prej 2,334,943,000 € përfshijnë edhe një pagesë në shumë prej 270,000 €, për të cilën nuk kishte dalje të mjeteve. Ministria e Arsimit, Teknologjisë, Shkencës dhe Inovacionit, kishte certifikuar pagesën e lartë cekur për bursat e programit Fullbright dhe ky transaksion ishte regjistruar në SIMFK si pagesë e kryer. Por, gjatë testimeve të pagesave, ne kemi konfirmuar se për këtë pagesë nuk kishte dalje të parasë;
- Në pasqyrën e shpalosjeve, shtojca nr.7 në RFV-të e BRK-së për vitin 2020 pasuria kapitale mbi 1,000 €, është prezantuar në vlerë prej 9,041,518,666 €, ndërsa sipas auditimeve kjo pasuri ka rezultuar të jetë 8,943,588,684 €, Pra, kemi një mbivlerësim prej 97,929,982 €. Kjo diferencë mbetet pas thyerjeve të saldoeve, për shkak se disa organizata kanë pasuri më shumë sesa i kanë paraqitur në pasqyra dhe të tjerat kanë prezantuar të dhëna të mangëta mbi gjendjen e pasurive;
- Në pasqyrën e shpalosjeve, shtojca nr.8 në RFV-të e BRK-së për vitin 2020 pasuria nën 1,000 € në pasqyrën e shpalosjeve është në vlerë 46,778,503 €, ndërsa sipas auditimeve individuale, vlera e pasurive është 44,927,697 €, me një mbivlerësim prej 1,850,806 €;
- Në pasqyrën e shpalosjeve, shtojca nr.9 në RFV-të e BRK-së stoqet ishin prezantuar në vlerë 33,529,602 €, ndërsa sipas auditimeve individuale kjo vlerë rezulton 33,364,454 €, me një mbivlerësim prej 165,148 €;
- Në pasqyrën e shpalosjeve, shtojca nr.12 në RFV-të e BRK-së për vitin 2020 obligimet e papaguara në nivel vendi janë prezantuar në vlerë prej 361,418,958 €, kurse sipas auditimit vlera e obligimeve të papaguara ishte 362,982,078 €. Pra, kemi një nënvlerësim të obligimeve prej 1,563,120 €;
- Në pasqyrën e shpalosjeve, shtojca nr.13 në RFV-të e BRK-së për vitin 2020 gjendja e detyrimeve kontingjente është paraqitur në vlerë 211,972,679 €, ndërsa vlera e këtyre detyrimeve sipas auditimit ishte 217,358,083 €, apo me një nënvlerësim prej 5,385,404 €; dhe
- Në pasqyrën e shpalosjeve, shtojca nr.10 në RFV-të e BRK-së për vitin 2020 Llogaritë e arkëtueshme janë prezantuar në vlerë prej 691,914,269 €, kurse sipas raporteve individuale të auditimit, vlera e këtyre llogarive ishte 692,228,120 €, e nënvlerësuar për 313,851 €.

Përshkrim më i detajuar i çështjeve të përmendura te Baza për Opinion gjenden në kapitujt përkatës të këtij raporti.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar tek pjesa “Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”. Besojmë se dëshmitë e marra gjatë auditimit, janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i Çështjes

Për shkak të rëndësisë që ka kjo çështje, ne duam të tërheqim vëmendjen tuaj se, nga llogaritë e projekteve kapitale të Ministrisë së Infrastrukturës, përmes katër pagesave të realizuara në llogarinë e një OE me datë 09.10.2020, ishte tërhequr shuma 2,077,960 €. Sipas pasqyrës së shpalosjes nr. 11 në RFV-të e BRK-së, ky ishte shpenzim i palejuar dhe i paautorizuar dhe rasti është në procedurë të organeve të drejtësisë. Informata në lidhje me këtë rast është shpalosur në RFV-të e BRK-së dhe në RFV-të e Ministrisë së Infrastrukturës. Deri në përfundimin e auditimit, kjo shumë nuk i është kthyer Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Rekomandimet për Pasqyrat Financiare

Rekomandimet për Kuvendin e Kosovës

T’i forcojë kontrollet mbikëqyrëse kundrejt Qeverisë, para se të miratojë Ligjin vjetor të ndarjeve buxhetore për vitin vijues, në mënyrë që të sigurohet se të gjitha shpenzimet janë planifikuar në kategoritë ekonomike adekuate, sipas kërkesave të raportimit financiar.

Rekomandimet për Ministrinë e Financave, Punës dhe Tranfereve

- Të siguroj se janë përmbushur kërkesat për raportim të saktë dhe të vërtetë edhe në pasqyrat e shpalosjeve;
- Të vazhdojë forcimin e kontrolleve buxhetore, në mënyrë që të pamundësoj keqklasifikimet buxhetore; dhe
- Thesari të kërkojë nga komunat që ta dërgojnë planin e rrjedhës së parasë edhe për të hyrat vetjake të bartura, ashtu që të ketë një financim të balancuar të buxhetit, gjithnjë duke respektuar të drejtën që komunat e kanë për të destinuar këto mjete në kohën dhe projektet e caktuara.

2. Deklarata mbi kufirin e lejuar të deficitit buxhetor

Sipas Ligjit nr. 04/L-194 për ndryshim plotësimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP), neni 46, Ministri duhet t'i dorëzojë Qeverisë raportin përfundimtar mbi buxhetin, të ardhurat dhe shpenzimet, në të cilin duhet të paraqiten të dhëna krahasimore mes viteve lidhur me respektimin e kufirit të deficitit, përfshirë: shkaqet e devijimeve dhe financimin e deficiteve, nëse ka të tillë, apo shkaqet e suficiteve buxhetore dhe investimin e atyre suficiteve, nëse ka të tillë.

Financimi i deficiteve buxhetore sipas rregullave fiskale, financohet nga fondet e huamarrjeve, të hyrave të njehershme të AKP-së dhe bilancit bankar të pashfrytëzueshëm nga vitet paraprake. Qeveria ka respektuar kërkesat e mësipërme dhe për qëllime të njëjta kishte planifikuar huamarrje prej 596,200,000 €. Kjo shumë ishte planifikuar për të mbuluar pagesat/shpenzimet të cilat ishin më të larta se pranimet/ të hyrat. Shuma e deficitit të përgjithshëm sipas rregullës fiskale në fund të vitit ishte 364,111,000 € apo rreth 5.3% e BPV-së aktuale.

Sa i përket shpalosjes së të dhënave në tabelën e deficitit buxhetor për vitin 2020, me rastin e përllogaritjes së tij, ne kemi identifikuar mospërputhje në prezantimin e të hyrave apo shpenzimeve të planifikuara, të cilat janë prezantuar në mënyrë kumulative si në vijim.

Tabela 1 - Diferencat në përllogaritjen e deficitit buxhetor

(në '000 €)

Zërat Buxhetor	Deficiti sipas buxhetit fillestar-RFV	Deficiti i përllogaritur sipas auditimit	Ligji i buxhetit me rishikim	Deficiti i përllogaritur sipas auditimit	Realizimi në RFV	Realizimi sipas auditimit
Të hyrat buxhetore	2,020,394	2,020,394	1,788,494	1,788,494	1,722,214	1,722,214
Shpenzimet buxhetore	2,357,000	2,357,000	2,620,203	2,620,203	2,234,942	2,234,942
Shpenzimet e përjashtuara sipas rregullës fiskale	189,845	167,845	380,510	338,510	148,617	148,617
Deficiti i përgjithshëm sipas rregullës fiskale	-146,761	-168,761	-451,199	-493,199	-364,111	-364,111
Deficiti si % e BPV-së	-1.97%	-2.26%	-6.48%	-7.09%	-5.30%	-5.30%

Siç vërehet nga të dhënat më sipër, deficiti i përllogaritur i përgjithshëm me buxhetin fillestar sipas Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve ishte -146,761,000 €, ndërsa sipas vlerësimeve tona kjo shumë duhet të jetë -168,761,000 €, me një diferencë prej 22,000,000 € më e lartë se sa ishte përllogaritja. Kurse deficiti i përllogaritur konform Ligjit të Buxhetit me rishikim, sipas Ministrisë së Financave ishte -451,199,000 €, ndërkaq sipas vlerësimeve tona kjo shumë do të duhej të ishte -493,199,000 €, me një diferencë prej 42,000,000 € më e lartë se sa ishte përllogaritja (këto dy shuma i takojnë të hyrave vetanake të bartura nga vitet e kaluara. Meqenëse është regjistruar si planifikim në Ligjin e Buxhetit, do të duhej si i tillë të regjistrohej edhe gjatë përllogaritjes së deficitit buxhetor. Kjo kishte ndodhur si pasojë se kjo vlerë ishte pjesë e tabelës 1. Parashikimet fiskale të hyrat dhe shpenzimet në ligjin e buxhetit, tek pjesa C – financimi i brendshëm si pranime, ku ishin përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura nga komunat.

Tabela 2 - Përlllogaritja e deficitit buxhetor për vitin 2020

(në '000 €)

Nr.	Të hyrat/Shpenzimet buxhetore	Ligji i Buxhetit Fillestar	Ligji i Buxhetit me Rishikim	Realizimi RFV
1.	Pranimet/Totali të hyrat buxhetore (1.1-1.6)	2,020,394	1,788,494	1,722,214
1.1	Të hyrat tatimore	1,832,917	1,604,802	1,539,982
1.1a	Tatimet direkte	311,917	282,000	267,247
1.1b	Tatimet indirekte	1,521,000	1,322,802	1,272,735
1.2	Kthimet	-49,510	-39,631	-32,999
1.3	Të hyrat jo tatimore	226,487	188,913	181,201
1.4	Grantet për mbështetje buxhetore	10,500	34,410	34,030
2.	Pagesat/Shpenzimet e tërësishme (2.1-2.6)	2,357,000	2,620,203	2,234,942
2.1	Shpenzimet e pagave	619,000	634,263	660,768
2.2	Shpenzimet mallra, shërbime dhe komunal	357,000	328,805	299,162
2.3	Shpenzimet e subvencioneve	633,000	863,135	867,794
2.4	Shpenzimet e investimeve kapitale	672,000	730,000	379,713
2.5	Rezerva	44,000	34,000	0
2.6	Pagesat e interesit	32,000	30,000	27,505
3.	Deficiti i përgjithshëm	(336,606)	(831,709)	(512,728)
4.	Shpenzimet e përjashtuara sipas rregullës fiskale (4.1-4.4)	189,845	380,510	148,617
4.1	Pagesat nga të hyrat vetanake	22,000	42,000	30,101
4.2	Shpenzimet e AKP-së	6,000	6,000	
4.3	Klauzola e investimeve	76,845	147,510	47,065
4.4	E hyra e njëhershme nga AKP	85,000	185,000	71,451
5.	Deficiti i përgjithshëm sipas rregullës fiskale	(146,761)	(451,199)	(364,111)
6.	BPV	7,464,000	6,961,000	6,820,683
7.	Deficiti si % e BPV (definicioni sipas rregullës fiskale)	1.97%	6.48%	-5.30%

Në bazë të nenit 22.A.1 të LMFP-së, përcaktohet se asnjë ligj për ndarjet buxhetore nuk duhet të përfshijë një deficit të përgjithshëm që kalon nivelin prej 2% të BPV-së së parashikuar, në këtë rast sipas buxhetit fillestar prej 7,464,000,000 €.

Në vazhdim të të njëjtit ligj, neni 22.A.3, me qëllim të mbajtjes së borxhit total në masë të konsiderueshme nën kufirin e borxhit të përcaktuar në Ligjin për Borxhin Publik, për çdo vit të pestë fiskal, Kuvendi shqyrton dhe sipas nevojës mund të bëjë përshtatje në:

- kufirin e deficitit në përputhje me kufirin e borxhit dhe me rritjen afatmesme të BPV-së së parashikuar në versionin e fundit të KASH-it, dhe
- procedurat e zbatimit dhe parametrat kyç që shërbejnë si bazë për kufirin e deficitit.

Sipas Vendimit të Qeverisë nr.03/02 i datës 05.06.2020-pika 1, kërkohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës të bëjë ndryshimin dhe tejkalimin e përkohshëm të rregullave fiskale të deficitit dhe kufizimit të bilancit bankar të përdorshëm, të përcaktuar sipas nenit 22B të LMFP-së nr.03/048, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr.04/L-116 me Ligjin Nr.04/L-194 me Ligjin Nr.05/L-063 dhe me Ligjin Nr.05/L-007.

Komform këtij Vendimi, në pikën 2 është përcaktuar rritje e përkohshme kufirit të deficitit deri në gjashtë pikë pesë për qind (6.5%), ndërsa kufiri i bilancit të shfrytëzueshëm bankar është zvogëluar përkohësisht deri në tre për qind (3%) e BPV-së.

Arsyet e lëvizjes së normave për deficitin buxhetor dhe bilancin bankar, sipas Qeverisë

Meqë disa parametra makro-fiskal të paraqitur në Tabelën Nr.1 të Ligjit Nr.07/L-001 për Ndarjet Buxhetore për vitin 2020 janë ndikuar nga situata e pandemisë globale Covid-19, është vlerësuar e nevojshme të ndryshohen përkohësisht disa nga rregullat fiskale të përcaktuara me Ligjin Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i plotësuar dhe i ndryshuar), përkatësisht neni 22B - rritja e përkohshme e deficitit.

Për mbulimin e rritjes së deficitit sipas propozimit, MF-ja ka identifikuar burime shtesë të financimit të deficitit, ku është planifikuar të financohen nga burimet e brendshme dhe të jashtme të financimit, përmes letrave me vlerë, kredive ndërkombëtare dhe të hyrave të njëhershme të AKP-së.

Sipas nenit 22A.4, i po të njëjtit ligj, kufiri i deficitit mund të përshtatet edhe më herët nëse një hap i tillë synon stabilizimin e nivelit të parashikuar të borxhit total, në masë të konsiderueshme nën kufirin e borxhit, vetëm në rastet e parapara në vazhdim:

- LMFPP-ja nr. 03/L-048 (me plotësime dhe ndryshime), përfshinë një vlerësim të pajtueshmërisë për kufirin e deficitit buxhetor i cili nuk duhet të tejkalojë nivelin prej 2% të Bruto Produktit Vendor (BPV)³. Sipas Ligjit të Buxhetit nr.07/L-001 për Ndarjet Buxhetore për vitin 2020, BPV ishte parashikuar në vlerë prej 7,464,000,000 €, ndërkaq sipas Ligjit të Buxhetit nr.07/L-014 me rishikim, ishte parashikuar në vlerë prej 6,961,000,000 €. Kurse BPV-ja aktual në fund të vitit kishte rezultuar me vlerën prej 6,820,683,000 €.
- Neni 7 i Ligjit nr.05/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e LMFPP-së nr. 03/L-048, përcakton se: “Për qëllime të përputhshmërisë me kufirin e deficitit, shpenzimet për projektet kapitale të financuara nga klauzola e investimeve nuk do të merren parasysh” (nga institucionet financiare ndërkombëtare, Bashkimi Evropian apo institucionet e saj, qeveritë e huaja apo agjencitë e tyre të zhvillimit). Pra, në totalin e shpenzimeve të përjashtuara nga rregulla fiskale, kërkohet të përfshihen shpenzimet nga klauzola e investimeve, e të hyrave vetanake të bartura, shpenzimet nga të hyrat e dedikuara nga AKP-ja, shpenzimet e njëhershme të AKP-së, kthimi i kredive qeveritare të dhëna më herët dhe pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve.

Ne kemi vlerësuar proceset në kuadër të MF-së për të siguruar zbatimin e këtyre kërkesave nga ligjet përkatëse lidhur me kufijtë e deficitit buxhetor dhe kufirin aktual në fund të vitit 2020. Ligji i Buxhetit për vitin 2020 i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës është aprovuar me një deficit buxhetor -1.97% të BPV-së. Ndërkaq Ligji i Buxhetit me rishikim nr.07/L-014 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për BRK-së, është aprovuar me një deficit prej -6.48%, kurse deficitin aktual në fund të vitit ishte -5.30%.

³ Sipas Ligjit të buxhetit Nr. 07/L-001 për BRK-në viti 2020, tabela Nr.1 parashikimet fiskale 2020-2022, shënime shtesë BPV-ja i parashikuar ishte 7,464,000,000€, Sipas Ligjit Buxhetit me Rishikim Nr.07/L-014 për Plotësim ndryshim të Ligjit Nr.01/L-014 për Ndarjet Buxhetore për vitin 2020, BPV-ja e planifikuar ishte 6,961,000,000€ ndërsa BPV-ja aktual sipas shënimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës ishte 6,820,683,000€.

Ne kemi bërë analizën e shifrave të prezantuara në Tabelën 1 - parashikimet fiskale 2020-2022 të Ligjit nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2020 dhe analizën e shifrave të prezantuara në Tabelën 1 - parashikimet fiskale 2020-2022 të Ligjit nr.07/L-014, si dhe Shtojcën 1 të Raportit Financiar Vjetor të BRK-së, tabela e deficitit buxhetor për vitin 2020.

Në Tabelën nr.1- parashikimet fiskale të hyrat/shpenzimet 2020-2022 të Ligjit të Buxhetit nr.07/-L001 për Ndarjet Buxhetore për vitin 2020 dhe në shtojcën nr.1 të Raportit Vjetor Financiar të BRK-së, në pjesën e deficitit buxhetor, shpenzimet e përjashtuara nga rregulla fiskale ishin prezantuar në vlerë totale prej 189,845,000 €. Sipas vlerësimit tonë, këto shpenzime do të duhej të përlllogariten në vlerë totale prej 167,845,000 €. Në shumën e shpenzimeve të përjashtuara sipas rregullës fiskale nuk do të duhej të përfshiheshin të hyrat vetanake të nivelit qendror dhe komunal të bartura nga viti paraprak në vlerë prej 22,000,000 €;

Deficiti i përgjithshëm në bazë të Buxhetit fillestar, sipas rregullës fiskale i përlllogaritur nga MF ishte - 146,761,000 €. Sipas auditimit rezulton të jetë -168,761,000 €. Nga kjo, vërehet se edhe deficiti i planifikuar në buxhetin fillestar tejkalonte përqindjen e lejuar me rregullën fiskale për 0.26%.

Në këto shpenzime, ishin përjashtuar shpenzimet nga të hyrat e njëhershme nga AKP-ja në vlerë prej 85,000,000 €, shpenzimet e financuara nga klauzola e investimeve prej 76,845,000 €, shpenzimet nga të hyrat vetanake të bartura në vlerë 22,000,000 € (të cilat do të duhej të përfshiheshin, meqenëse janë llogaritur në tabelat e buxhetit), si dhe shpenzimet nga pranimet e dedikuara për AKP-në 6,000,000 €.

Në tabelën e Ligjit Buxhetit nr. 07/L-014, parashikimet fiskale 2020-2022 dhe në shtojcën nr.1 të RFV të BRK-së, në pjesën e deficitit buxhetor, shpenzimet e përjashtuara nga rregulla fiskale ishin prezantuar në vlerë totale prej 380,510,000 €. Sipas vlerësimit tonë, këto shpenzime do të duhej të përlllogariten në vlerë totale prej 338,510,000 €. Pra, në shumën e planifikuar të shpenzimeve të përjashtuara nuk do të duhej të përfshiheshin të hyrat vetanake të nivelit komunal të bartura nga viti paraprak në vlerë prej 42,000,000 €.

Sipas përlllogaritjeve të MF-së, deficiti i përgjithshëm në bazë të Buxhetit të rishikuar, sipas rregullës fiskale të ndryshuar me të cilën është përcaktuar një rritje e përkohshme e kufirit të lejuar nga 2.0% në 6.5% të BPV-së, ishte - 451,199,000 €. Ndërkaq, sipas auditimit rezulton të jetë -493,199,000 € (ose 7.09%), ku kemi një tejkalim për 40,734,000 € (ose 0.59% nga përqindja e lejuar).

Vlen të theksohet se Qeveria me rastin e përgatitjes së projekt Ligjit Nr.07/L-001 për Ndarjet Buxhetore për vitin 2020 dhe Ligjit të Buxhetit Nr.07/L-014 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.07/L-001, nuk kishte siguruar që deficiti i planifikuar të jetë brenda kufirit të lejuar me LMFPP-në dhe me Vendimin e Qeverisë, të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Sipas vlerësimit të auditimit, ligji për ndarjet buxhetore ishte proceduar për aprovim në Kuvend duke mos respektuar kufirin e lejuar për deficitin buxhetor.

Konkluzion

Sipas nenit 46 të LMFPP-së, Ministri duhet t'i dorëzojë Qeverisë një raport përfundimtar mbi buxhetin, të ardhurat dhe shpenzimet, në të cilin duhet të paraqiten të dhëna krahasimore mes viteve, lidhur me diskutimin për respektimin e kufirit të deficitit, përfshirë: shkaqet e devijimeve dhe financimin e deficiteve, nëse ka të tillë, apo shkaqet e suficiteve buxhetore dhe investimin e atyre suficiteve, nëse ka të tillë.

Thesari në raportin financiar vjetor për vitin 2020 kishte shpalosur pasqyrën e kalkulimit të deficitit buxhetor sipas të dhënave të prezantuara në pasqyrën e deficitit buxhetor. Vërehet se Qeveria nuk kishte respektuar kufirin e deficit buxhetor sipas Ligjit të Buxhetit fillestar, që ishte -1.97%, kurse sipas auditimit do të duhej të

ishte -2.26%. Rrjedhimisht me Ligjin e Buxhetit me rishikim ishte -6.48%, ndërsa do të duhej të ishte 7.09%. Kurse sipas realizimit aktual është respektuar kufiri i ri i deficitit me -5.30%.

Rekomandimi për Kuvendin e Kosovës

Të siguroj se Qeveria respekton kufirin e deficit buxhetor gjatë përgatitjes së ligjit të buxhetit.

3. Siguria e informacionit në SIMFK

Thesari i Kosovës (Thesari) ka në funksion dhe menaxhon sistemin elektronik ‘Sistemin Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës (SIMFK)’. Ky sistem pasqyron një plan kontabël të detajuar për financat publike në Republikën e Kosovës, që mundëson kodifikimin dhe kontrollin e të gjitha transaksioneve financiare. SIMFK është i centralizuar për të gjitha proceset e financave publike të Qeverisë së Kosovës dhe përdoret nga të gjitha organizatat buxhetore në të gjitha nivelet si qendrore, ashtu edhe lokale.

Duke marrë parasysh që ky sistem ka rol kyç në menaxhimin e financave publike, Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e Teknologjisë së Informacionit në Thesar për të vlerësuar nëse ky institucion ka krijuar ambient të sigurt në mënyrë që Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës ruan disponueshmërinë, konfidencialitetin dhe integritetin e tij. Ky auditim ka mbuluar periudhën 2020 për regjistrimet që kanë ndodhur në bazën e të dhënave si dhe konfigurimet aktuale të sigurisë së sistemeve në përgjithësi. Ky auditim nuk ka vlerësuar zhvillimet që kanë ndodhur para vitit 2020.

Thesari, në fund të vitit 2020 ka shtuar nivelet e kontrollit për realizimin e transaksioneve si dhe ka realizuar disa konfigurime në aplikacion dhe infrastrukturën e TI-së të cilat kanë ndikuar në rritjen e sigurisë së SIMFK-së. Pavarësisht këtyre konfigurimeve, është identifikuar që ka nevojë të krijojë mekanizma shtesë që mundësojnë menaxhimin e rreziqeve të lidhura me sigurinë e informacionit si dhe të realizoj konfigurime shtesë në modulet e SIMFK-së për të përmbushur të gjitha kërkesat rregullative si dhe për të rritur efikasitetin e punës për përdoruesit të tij.

3.1 Kontrollat e sigurisë së informacionit

Siguria e informacionit është një nga aspektet themelore të qeverisjes së TI-së për të siguruar gatishmërinë, konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave. Për menaxhim më të mirë të sigurisë së informacionit, institucioni, duhet të krijoj mekanizma që të mundësojnë menaxhimin e rreziqeve të lidhura me sigurinë, marrjen e masave të duhura dhe garancinë se informacioni është i disponueshëm, i përdorshëm, i plotë dhe i pa komprometuar.

Më poshtë kemi paraqitur gjetjet si pasojë e mungesës së kontrolleve të sigurisë së informacionit.

Struktura dhe organizimi i detyrave dhe përgjegjësi në Thesar ka nevojë të harmonizohen në rregulloret dhe procedurat e saj

Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të TI-së duhet të jenë të harmonizuara dhe në përputhje me rregulloren e brendshme për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Thesar.

Thesari nuk ka harmonizuar rolet dhe përgjegjësitë e zyrtarëve të Divizionit të TI-së në Thesar dhe Divizionit të SIMFK-së në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me rregulloren për organizimin e brendshëm:

- Sipas Rregullores 06/2014, Divizioni i TI-së duhet të bëjë administrimin e SIMFK-së. Mirëpo, administrimi i SIMFK-së bëhet nga i Divizioni i menaxhimit të SIMFK-së, i cili sipas kësaj rregullore ka për detyrë të menaxhojë kontrollet e sistemit dhe strukturën e klasave funksionale në SIMFK. Kjo ndodhë për shkak që me procedurën për menaxhimin e qasjeve në SIMFK kjo detyrë i është caktuar Divizionit për menaxhimin e SIMFK-së.

- Sipas Rregullores 06/2014, Divizioni i TI-së duhet të bëjë menaxhimin e klientëve të SIMFK-së dhe të tavolinës ndihmëse, mirëpo tavolina ndihmëse për SIMFK-në është e organizuar në Divizionin e menaxhimit të SIMFK-së. Detyrat e kësaj tavoline janë caktuar sipas procedurës për menaxhimin e qasjeve në SIMFK.
- Divizioni i TI-së nuk e bën administrimin e bazave të të dhënave, mirëpo në mungesë të administratorit për bazën e të dhënave e bëjnë konsulentët nga kompania e kontraktuar edhe pse nuk e kanë pjesë të kontratës administrimin e bazës së të dhënave.

Kjo është si shkak i rregullores së vjetër e cila nuk është rishikuar për t'u harmonizuar me nevojat e institucionit që prej vitit 2014 dhe mungesës së kapaciteteve të burimeve njerëzore për realizimin e detyrave, sepse në rregullore është paraparë më pak staf për Divizionin e TI-së.

Si rezultat, i janë dhënë detyra dhe përgjegjësi zyrtarëve në mos përputhje me rregulloren dhe është krijuar procedura pa u harmonizuar me këtë rregullore, gjithashtu edhe konsulentëve të kompanisë i është dhënë detyra dhe përgjegjësi pa përfshirjen e kryerjes së atyre detyrave në kontratë.

MF dhe Thesari nuk kanë arritur të krijojnë strukturën për sigurinë e informacionit

Institucioni duhet të siguroj nëse aktivitetet e sigurisë së informacionit dhe TI-së koordinohen nga struktura adekuate e organizatës, me role dhe përgjegjësi përkatëse. Duhet të jetë i përcaktuar dhe të zbatohet procesi i autorizimit nga menaxhmenti për sistemet e informacionit, kur proceset e biznesit përfshijnë palë të jashtme, duhet të identifikohen dhe zbatohen kontrollet paraprake përpara se të lejohet qasja.⁴

Në strukturën organizative të Ministrisë së Financave, dhe të Thesarit nuk është përcaktuar organizimi i sigurisë së informacionit, kanë mungesë të zyrtarit për sigurinë e informacionit, politikës dhe procedurave standarde për sigurinë e informacionit.

Kjo ka ndodhur për shkak se MF dhe Thesari kanë rregulloret e vjetra dhe nuk kanë arritur të realizojnë rishikimin e tyre. Mirëpo, tani janë në proces të hartimit të rregulloreve të reja, politikave dhe procedurave të sigurisë, këto institucione kanë krijuar një grup punues për hartimin e rregulloreve, politikave dhe procedurave të reja të TI-së, ku do të parashihet edhe struktura e sigurisë së informacionit. Gjithashtu, në vitin 2019, është realizuar vetëm njëherë, një test i depërtueshmërisë për mbrojtje nga ndërhyrjet e paautorizuara, për sistemet e vendosura në rrjetin e MF-së.

Mungesa e stafit për siguri të informacionit dhe mungesa e strukturës së sigurisë së informacionit në organogramin e Thesarit dhe MFPT-së, zvogëlon aftësinë për të mbrojtur burimet e TI-së, si dhe informacionin e përfshirë në sistemet e TI-së.

Thesari kishte disa mangësi në organizimin e sigurisë së brendshme të rrjetit

Rrjetet duhet të menaxhohen dhe kontrollohen në mënyrë që të mbrohen nga kërcënimet dhe të ruajnë sigurinë për sistemet dhe aplikacionet që përdorin rrjetin e brendshëm duke përfshirë edhe informacionin në tranzit, pavarësisht nëse këto ofrohen si shërbime të brendshme ose të jashtme.⁵ Standardet dhe protokollet e

4 ISO 27001: Kontrollat dhe objektivat: Politika e Sigurisë së Informacionit & Organizimi i Sigurisë së Informacionit.; Rregullore nr.17/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

5 ISO 27001: Kontrollat dhe objektivat: Politika e Sigurisë së Informacionit & Organizimi i Sigurisë së Informacionit.

funksionimit të rrjetit duhet të dokumentohen dhe të vihen në dispozicion dhe gjithashtu, duhet të rishikohen periodikisht për të siguruar pajtueshmërinë.⁶

Thesari nuk kishte arritur të zbatoj konfigurimet e nevojshme në të gjitha pajisjet e tyre të fundme për implementimin e sigurisë së brendshme të rrjetit që ka realizuar Ministria e Financave, duke zbatuar platformën për menaxhimin e politikave “Clearpass” për Kontrollin e Qasjes në Rrjet (NAC) përmes e SWITCH7-ve. Nga 80 përdoruesit e Thesarit vetëm 10 pajisje të fundme nga Thesari ishin konfiguar, ndërsa të tjerat ende funksiononin jashtë “NAC”. Vlen të cekët se pas rekomandimeve të ekipit të auditimit është bërë konfigurimi i të gjitha pajisjeve të fundme të Thesarit në “NAC”.

Nga një listë prej 16 përdoruesve të Thesarit që kanë qasje përmes VPN (nga distanca), 7 prej tyre nuk kishin formularë të kërkesës së miratuar. Mirëpo, Divizioni i TI-së në Thesar, kishte krijuar një listë për kontrollin e këtyre qasjeve, edhe pse nuk kishin një kërkesë formale.

Qasja e përdoruesve nga distanca në disa raste është realizuar përmes plotësimit të formularit për qasje nga distanca pas miratimit të menaxhmentit dhe stafit të TI-së, por kemi raste kur i është dhënë qasje pa ndonjë procedurë, kjo për shkak se formulari për qasje në distancë ka filluar të përdoret nga muaji gusht 2020, prandaj për zyrtarët që kanë pasur qasje në VPN para kësaj date nuk kanë plotësuar formularë.

Mos zbatimi i plotë i procedurës për qasje nga distanca mund të rris mundësinë për qasje të paautorizuar nga distanca.

Nuk është realizuar dokumentimi i rrjetit të MF-së

Standardet dhe protokollet e funksionimit të rrjetit duhet të dokumentohen dhe të vihen në dispozicion dhe gjithashtu, duhet të rishikohen periodikisht për të siguruar pajtueshmërinë.⁸

Departamenti i TI-së në MF nuk ka arritur të bëjë dokumentimin e rrjetit. Ata kanë filluar të bëjnë dokumentimin dhe janë në proces të krijimit të dokumentimit, deri më tani kanë arritur të bëjnë një dokumentim fillestar.

Si shkak i mungesës së kapaciteteve të burimeve njerëzore, të infrastrukturës rregullative dhe veglave softuerike për menaxhimin e rrjetit, realizimi i proceseve të tilla është më i ngadalshëm.

Mungesa e dokumentimit të rrjetit rrezikon funksionimin e qëndrueshëm dhe efektiv të sistemeve për stafin e ri ose ndryshimin e burimeve dhe mund të jetë kritike për rikthimin e sistemeve në rast të ndonjë katastrofe natyrore apo faktorë të tjerë të jashtëm për vazhdimësinë e biznesit.

Nuk është bërë mjaftueshëm ndërgjegjësimi ndaj sigurisë së informacionit për përdoruesit në MF dhe Thesar dhe as nuk është zbatuar politika e kompleksitetit të fjalëkalimeve në Active Directory

Personeli duhet të kuptojë dhe ruajë sigurinë e informacionit. Të gjithë punonjësit e organizatës dhe kur është e nevojshme, kontraktorët dhe përdoruesit e palëve të treta duhet të marrin trajnimin e duhur të ndërgjegjësimit dhe azhurnimet e rregullta të politikave dhe procedurave organizative, të rëndësishme për funksionin e tyre të punës.⁹ Sistemet për menaxhimin e fjalëkalimeve duhet të jenë interaktive dhe të sigurojnë

⁶ ISACA: Manuali i CISA Edicioni i 27-të: Siguria e Infrastrukturës së rrjetit.

⁷ SWITCH-at koordinojnë kanalet e komunikimit në mes të shfrytëzuesit dhe shërbimit që ata kërkojnë.

⁸ ISACA Manuali i CISA Edicioni i 27-të: Siguria e Infrastrukturës së rrjetit

⁹ ISO 27001: Siguria e burimeve njerëzore – Ndërgjegjësimi, vetëdijësimi dhe trajnimet për sigurinë e informacionit

*fjalëkalime cilësore. Gjithashtu, aplikacioni dhe pajisjet duhet të mbyllet pas një periudhe të caktuar të pasivitetit.*¹⁰

Thesari nuk ka organizuar për punonjësit e vet dhe përdoruesit e SIMFK-së trajnime dhe fushata për rëndësinë dhe ndërgjegjësimin ndaj sigurisë së informacionit. Sipas tyre kjo ka ndodhur sepse nuk kanë pasur të përcaktuar zyrtarin e sigurisë dhe organizimin e strukturës së sigurisë së informacionit. Mirëpo, me riorganizimin e ri është planifikuar kjo pozitë. Gjithashtu nuk janë mbajtur fushata për sigurinë e informacionit, mirëpo gjatë trajnimit të përdoruesve për përdorimin e SIMFK-së, ata janë këshilluar se si të mbrojnë dhe trajtojnë fjalëkalimin.

Gjithashtu, MFTP-ja nuk ka organizuar trajnime apo fushata vetëdijësuese për sigurinë e informacionit për të gjithë përdoruesit. Mirëpo, nëse përdoruesit kanë ndonjë problem apo e-mail të dyshimtë, i trajtojnë si raste të veçanta. Poashtu, nuk ka arritur të zbatoj politikën e kompleksitetit të fjalëkalimeve për llogaritë e përdoruesve (të MFTP-së dhe Thesarit) në Active Directory¹¹, që MFTP-ja e menaxhon.

Sipas tyre, ka qenë sfidë implementimi i kompleksitetit të fjalëkalimeve të përdoruesit për shkak të përdoruesve jo të gatshëm, prandaj edhe nuk kanë arritur të bëjnë një fjalëkalim kompleks. Me zhvillimin e një sistemi “moodle12” për të mbajtur trajnime, do të përfshihej edhe realizimi i trajnimeve për sigurinë e informacionit. Ndërsa sa i përket stafit të TI-së, njëri nga ta ka ndjekur trajnim për sigurinë kibernetike, që është organizuar nga MPB në nivel të qeverisë (ARC-CERT).

Mungesa e trajnimeve për ndërgjegjësimin për sigurinë e informacionit dhe mos zbatimimi i politikës për kompleksitetin e fjalëkalimeve (Active Directory) mund të zvogëlojë aftësinë për të mbrojtur informacionin e përfshirë në sistemet e TI-së.

Për qasjet administrative në sistemet e informacionit përdoren llogaritë e përgjithshme

*Të gjithë përdoruesit e sistemeve të informacionit duhet të kenë llogari (ID të përdoruesit) unike dhe të personalizuar, të cilat shfrytëzohen vetëm për përdorimin individual. Fjalëkalimi i llogarisë së administratorit duhet të dihet vetëm nga një individ, të ruhet në ambiente të sigurta dhe të jetë në gjendje të përdorë sistemin kur administratori nuk është i disponueshëm. Llogaritë me qasje të plota duhet të monitorohen në vazhdimësi.*¹³

Për qasje në bazën e të dhënave përdoren vetëm llogaritë me qasje të plota/të administratorit, të cilat nuk janë të personalizuar. Poashtu, kredencialet e llogarive të administratorëve për sistemin e SIMFK-së nuk janë të ruajtura në ambiente të sigurta. Këto shfrytëzohen nga më shumë se një përdorues përfshirë këtu edhe konsulentët e jashtëm të cilët janë përgjegjës për mirëmbajtjen e aplikacionit. Sidoqoftë, personat e autorizuar që shfrytëzojnë llogarinë e administratorin kanë IP të rezervuar dhe lënë gjurmë për aktivitetet e tyre. Për më tepër këto llogari nuk monitorohen. Poashtu, zyrtarët që kanë qasje të plota në bazën e të dhënave, kanë qasje të plota edhe në të dhënat/tabelat e gjurmëve të auditimit.

Meqenëse llogaritë me qasje të plota hapen gjatë instalimit të bazës së të dhënave nuk ishte marrë iniciativë që këto llogari të pasivizohen dhe të hapen llogari të personalizuar. Poashtu, mungesa e përcaktimit të një

¹⁰ ISO 27001: Kontrollat e qasjeve në sistemet operative – Sistemi për menaxhimin e fjalëkalimit

¹¹ Active Directory, është shërbim i Microsoft, për autorizimin dhe autentifikimin e përdoruesve dhe pajisjeve të TI-së në domenin e rrjetit të organizatës.

¹² Moodle është një platformë mësimore e krijuar për të i'u ofruar përdoruesve një sistem të vetëm, të sigurt dhe të integruar për të krijuar mjedise të personalizuar të të mësuarit.

¹³ ISO 27001: Kontrollat e qasjeve - Menaxhimi i qasjeve të përdoruesve /Kontrolli i qasjes në aplikacione

zyrtari për monitorimin e aktiviteteve të përdoruesve si dhe mungesa e një vegle për monitorimin e gjurmëve të auditimit kishte ndikuar që monitorimi i tyre të mos bëhet deri më tani.

Për më tepër, edhe Departamenti i TI-së në MF për qasje në ndërfaqet e pajisjeve të rrjetit përdor llogari të përgjithshme. Kjo për shkak se nuk e kanë parë të nevojshme përdorimin e llogarive të personalizuar, pasi që të shumtën e kohës i qaset vetëm një administrator i rrjetit.

Përdorimi i një llogarie nga më shumë se një zyrtar ndikon në mungesën e llogaridhënies në rast të dëmtimit eventual të të dhënave. Përdorimi i llogarive të përgjithshme në sistem mund të ekspozoj sistemin e informacionit ndaj rreziqeve të qëllimshme apo aksidentale.

Mangësi në menaxhimin e qasjeve në aplikacionin SIMFK

Politika dhe procedurat e sigurisë së informacionit duhet të rishikohet dhe të aprovohen në intervalet e planifikuara (të paktën çdo vit) ose kur ndodhin ndryshime të rëndësishme në organizatë, operacionet e saj të biznesit ose në rast rreziku të qenësishëm lidhur me sigurinë, për të siguruar përshtatshmërinë e vazhdueshme të saj. Gjithashtu duhet të ekzistojnë mekanizma që sigurojnë që këto politika dhe procedura janë duke u ndjekur.¹⁴

Thesari, kishte identifikuar disa mangësi në kontrollin e llogarive të përdoruesve dhe si masë preventive në nëntor të vitit 2020 kishte marrë vendim dhe kishte ndërmarrë veprime për rritjen e sigurisë së qasjeve dhe transaksioneve në SIMFK. Po ashtu, kishte ndryshuar procedurën për Menaxhimin e qasjes së përdoruesve në SIMFK e cila deri në përfundim të ekzekutimit të auditimit nuk ishte aprovuar. Kjo procedure me disa ndryshime ishte aprovuar në gusht të vitit 2021.

Të gjithë përdoruesit e sistemeve të informacionit duhet të kenë llogari unike (ID të përdoruesit). Thesari për shkak të sigurisë kishte praktikuar që të hap nga dy llogari për një përdorues në rastet kur Organizata Buxhetore ka agjenci apo njësi vartëse, poashtu kishte hapur edhe dy llogari për një përdorues edhe pse sipas procedurës mund të hapen dy klasa funksionale për organizata buxhetore të cilat kanë numër të caktuar të punëtorëve dhe në pamundësi të caktojnë një zyrtar për secilën klasë funksionale. Nga analiza e llogarive të përdoruesve në aplikacionin SIMFK duke përfshirë edhe llogaritë e konsulentëve të jashtëm, ishin të regjistruar gjithsej 3,425, prej tyre ishin 1,994 llogari pasive dhe 1,431 llogari aktive me gjithsej 1259 përdorues, pra janë 172 përdorues me më shumë se një llogari aktive.

Përveç kësaj, llogaritë e përdoruesve nuk kishin një standard të caktuar për emërtimin e tyre. Kjo mund të ndikoj në vështirësi në identifikimin dhe monitorimin e tyre.

Sipas Vendimit nr. 34-2020 përcaktohet që përdoruesi që nuk është kyçur në SIMFK për mbi 45 ditë, do të bëhet pasiv. Nga llogaritë aktive, ne kemi identifikuar 139 llogari të cilat datën e fundit të qasjes e kishin më tepër se 45 ditë, prej tyre ishin 12 llogari aktive të cilat që nga data e hapjes së tyre nuk ishin qasur asnjëherë, mirëpo këto llogari nuk mund të përdoren pa bërë kërkesë zyrtare për ndryshim të fjalëkalimit.

Hapja e më shumë se një llogarie për një përdorues vështirëson monitorimin e përdoruesve duke rritur rrezikun e mos identifikimit me kohë të ndonjë ngjarje të dëmshme për organizatën.

¹⁴ ISACA: Manuali i CISA Edicioni i 27-të: 2.3 Standardet e TI-së, Politikat dhe Procedurat

3.2 Kontrollet e aplikacioneve të teknologjisë së informacionit

Kontrollet e aplikacioneve janë kontrolle specifike të veçanta për çdo aplikacion kompjuterik. Kur proceset e institucionit janë të automatizuara në aplikacione të TI-së, rregullat e tij ndërtohen gjithashtu në aplikacione. Ato aplikohen në segmente të aplikacioneve dhe lidhen me transaksionet dhe të dhënat e qëndrueshme. Kontrollet e aplikacioneve janë ndërtuar për të siguruar dhe mbrojtur saktësinë, integritetin, realizueshmërinë dhe konfidencialitetin e informacionit. Ato sigurojnë iniciimin e transaksioneve të autorizuara në mënyrën e duhur, procedimin e të dhënave të vlefshme, regjistrimin e plotë dhe raportimin e saktë.

Më poshtë kemi paraqitur gjetjet si pasojë e mungesës së kontrolleve në aplikacione të teknologjisë së informacionit.

Në disa module të aplikacionit SIMFK ka fusha në të cilat nuk janë të zbatuara rregullat e vlefshmërisë.

Aplikacioni duhet të ketë të zbatuara rregullat e vlefshmërisë në ndërveprimin e të dhënave në hyrje. Të dhëna jo të vlefshme duhet të identifikohen dhe të refuzohen në mënyrën e duhur nga aplikacioni.¹⁵

Gjatë testimeve në aplikacionin SIMFK është identifikuar që në fushat ku vendoset numri personal i identifikimit, numri unik identifikues i biznesit (NUI) dhe numri i llogarisë bankare nuk kishte kontroll për vlefshmërinë e të dhënave hyrëse. Në këto fusha kishte mundësi të shënohet numri me më shumë apo më pak karaktere/numra se sa është i përcaktuar te numri personal (10 karaktere), NUI (9 karaktere), llogaria bankare (16 karaktere) dhe sistemi pranonte llogarinë bankare e cila nuk i takonte bankës përkatëse. Poashtu, në ndërfaqet e saj fushat e dedikuara për informata të caktuara, përdorëshin për informata të tjera që nuk korrespondonin me atë fushë.

Mos vlefshmëria e këtyre fushave në SIMFK ishte për shkak që në këtë sistem nuk ishin të zbatuara algoritmet përkatëse për vlefshmërinë e të dhënave si dhe nuk ishte i ndërlidhur me sistemet e informacionit të ARC-së, ARBK-së dhe BQK-së të cilat do të mundësonin që në sistem të regjistrohen vetëm të dhëna të sakta.

Thesari ka filluar me iniciimin e projektit për ndërlidhjen e SIMFK-së me sistemet qendrore të informacionit me qëllim të rritjes së cilësisë së të dhënave.

Mungesa e zbatimit të algoritmeve përkatëse për vlefshmërinë e të dhënave në SIMFK si dhe ndërlidhja me sistemet qendrore të informacionit nëpërmjet të cilave do të pranonte të dhëna të sakta ka ndikuar në hapjen e shumë kodeve për personin fizik dhe biznesin e njëjtë dhe si pasojë mund të ndikon në cilësi jo të mirë të të dhënave.

Në SIMFK një furnitor është i regjistruar më shumë se njëherë

Bazuar në procedurën për regjistrimin e furnitorëve në SIMFK, një furnitor duhet të regjistrohet vetëm njëherë dhe do të konsiderohet për çfarëdo pagesë që duhet kryer nga cilado organizatë buxhetore.¹⁶

Në listën e furnitorëve aktiv të regjistruar në SIMFK kemi identifikuar që ka raste kur i njëjti furnitor është i regjistruar në sistem më shumë se një herë, por me llogari të ndryshme bankare.

Thesari bënë regjistrimin e furnitorëve në SIMFK me kërkesë të organizatës buxhetore. Por, sipas procedurës për regjistrimin e furnitorit në rastet kur një furnitor ka më shumë se një llogari bankare atëherë për çdo llogari

¹⁵ Manuali i auditimit të teknologjisë së informacionit – Matrica e auditimit mbi kontrollet e aplikacionit

¹⁶ Procedura për regjistrimin e furnitorëve në SIMFK, mars 2018.

të re bankare është hapur një furnitor i ri me kodin e njëjtë të furnitorit duke e dalluar atë nga llogaria tjetër me një shkronje (A, B, etj).

Gjatë testimit në SIMFK për regjistrimin e furnitorit, kemi vërejtur që sistemi ka të zbatuar fushën për rastet kur një furnitor ka më shumë se një llogari bankare, pra mund të regjistrohen më shumë se një llogari bankare në të njëjtin kod të furnitorit.

Mirëpo, kjo mundësi nuk është shfrytëzuar nga Thesari, meqë versioni i vjetër i SIMFK-së nuk kishte mundësinë e shtimit të llogarive të reja bankare në kodin e njëjtë të furnitorit. Edhe pas zhvillimit të versionit të ri të SIMFK-së kanë vazhduar me praktikën e njëjtë për regjistrimin e furnitorëve, edhe pse kanë pasur mundësinë të shtojnë më shumë llogari bankare për një furnitor.

Krijimi i furnitorit të ri për çdo llogari të re bankare i cili është i regjistruar në SIMFK krijon vështirësi për verifikimin e saktë të transaksioneve të realizuara për atë furnitor. Po ashtu mund të shkaktojë vonesa në realizimin e regjistrimit të furnitorit dhe mund të shkaktojë vonesa në verifikimin e kodit të furnitorit për përcaktimin se më cilën llogari bankare është i lidhur ai kod.

Në SIMFK përmirësimet e pasurisë ekzistuese jo financiare regjistrohen si pasuri e re kapitale

Përmirësimet e pasurisë jo financiare kapitale në SIMFK duhet të regjistrohen në regjistrat përkatës si rritje e vlerës së pasurive.¹⁷

Organizatave buxhetore regjistrojnë në SIMFK, si pasuri të re jo financiare, shpenzimin që bëhet për përmirësimin e një pasurie kapitale me qëllim të ndryshimit ose modernizimit të saj, të cilat zgjasin ndjeshëm periudhën e përdorimit të artikullit ose e përmirësojnë funksionalitetin e tij. Pra, në SIMFK nuk mundësohet zbatimi i Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare, që ky shpenzim të regjistrohet në regjistrat përkatës si rritje e vlerës së pasurisë kapitale, por regjistrohet si pasuri e re.

Thesari ka praktikuar këtë metodologji të regjistrimit të shpenzimit për përmirësimin e një pasurie në SIMFK si pasuri kapitale të re, si dhe nuk ka bërë përpjekje për të ndryshuar metodologjinë e regjistrimit për këto shpenzime në mënyrë që të jenë në harmoni me zbatimin e Rregullores.

Regjistrimi i shpenzimit që bëhet për përmirësimin e pasurisë kapitale si pasuri e re ndikon në prezantimin jo të saktë të të dhënave të pasurisë jo financiare, si dhe në raportimin jo të saktë të pasqyrave financiare.

Në SIMFK nuk janë të regjistruara të gjitha kodet e klasave të pasurisë

Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël.¹⁸

Ministria e Financave, publikon në ueb faqen e saj listën e kodeve ekonomike të cilat duhet të përdoren nga OB-të për regjistrimin e pasurisë kapitale (jo financiare). Mirëpo, Thesari i cili është përgjegjës për menaxhimin e SIMFK-së nuk ka regjistruar të gjitha kodet e klasave të pasurisë në sistem sipas listës së publikuar në ueb faqe. Si rezultat, OB-të gjatë regjistrimit të pasurisë jo financiare në SIMFK, në rastet kur kodi adekuat i klasës së pasurisë nuk është në listë, atëherë zyrtarët për regjistrimin e pasurisë detyrohen që atë pasuri ta klasifikojnë në kodin me emërtim më të përshtatshëm apo në klasën e pasurisë “Kapitale Tjera”.

¹⁷ Rregullore MF – Nr. 02/2013 – Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, neni 15.

¹⁸ Rregullore MF – Nr. 02/2013 – Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, neni 6.

Thesari nuk kishte bërë përpjekje për regjistrimin e të gjitha kodeve të klasave të pasurisë në SIMFK që të jetë në harmoni me listën e kodeve të klasave të planit kontabël të publikuar.

Regjistrimi i pasurisë jo financiare në kod të klasës jo adekuate ndikon në pasqyrim jo të qartë të klasifikimit të pasurisë si dhe ekziston rreziku që ajo pasuri të mos të zhvlerësohet në harmoni me normën e përcaktuar për atë pasuri sipas klasës.

SIMFK-ja nuk parandalon regjistrimin e transaksioneve me të dhëna identike

Sistemi i informacionit duhet të ketë kontrollet e nevojshme për identifikimin dhe refuzimin e transaksioneve me të dhëna identike.¹⁹

Në SIMFK një kupon i shpenzimit mund të krijohet manualisht për të regjistruar shpenzimet dhe automatikisht përmes funksioneve të importimit. Gjatë testimeve të realizuara në SIMFK për regjistrimin e shpenzimeve është gjetur që sistemi nuk bënë verifikime për të identifikuar dhe refuzuar të dhënat e identike gjatë regjistrimit në kupona të ndryshëm të shpenzimeve nga organizatat buxhetore. Pra, sistemi pranon shpenzimin me të dhënat e njëjta (kodi i furnitorit, numri i faturës, data e lëshimit të faturës, emri i OB, shuma e faturës së lëshuar, etj). Për më tepër, në rastet kur ka regjistrim të shpenzimeve masive (mbi 50 pagesa) dhe mundësia për gabime ekziston gjatë shënimit manual të të dhënave, sistemi nuk identifikon pagesën e cila është importuar më herët apo nëse dokumenti për importim ka rreshta me të dhëna identike.

Moszbatimi i funksionit në SIMFK të identifikimit të shpenzimit/faturës së njëjtë sipas zyrtarëve të Thesarit ishte që OB-të kanë shpenzime të llojeve të ndryshme pa faturë.

Si pasojë e moszbatimit të funksionit të kontrollit për identifikimin dhe refuzimin e transaksioneve me të dhëna identike është identifikuar që OB-të kishin realizuar transaksione të tilla dhe në momentin e identifikimit të tyre ishin detyruar të bënin kthimin e këtyre mjeteve. Kjo mangësi e sistemit mund të ndikon edhe në performancën e punës së zyrtarëve të OB-ve.

Thesari nuk përdor të gjitha mundësitë që ofron SIMFK-ja

Strukturat përgjegjëse për menaxhimin e sistemeve të TI-së, sigurojnë se kapaciteti i sistemit dhe performanca e tij arrin nevojat aktuale dhe të ardhshme të organizatës. Organizata analizon, prioritarizon dhe menaxhon kërkesat për t'u siguruar se nevojat e përdoruesve janë plotësuar në mënyrë optimale për të rritur efikasitetin e punës së tyre.²⁰

SIMFK-ja ofron mundësi për regjistrimin e shumë të dhënave të cilat do të ishin përfituese për përdoruesit dhe do të rritnin efektivitetin në punë, e në veçanti do të ndikonin në prezantimin më të plotë në paraqitjen e statistikave dhe monitorimin më efikas të transaksioneve. Mirëpo shumë nga mundësitë që ofron sistemi nuk janë paraparë të jenë obligative për regjistrim. Mundësitë që ofron sistemi, por që nuk janë përshtatur sipas nevojave, ndër të tjera veçojmë:

- Çdo shpenzim që bëhet me prokurim ka numër unik të kontratës, ky numër në shumicën e rasteve nuk shënohet në sistem, për shkak që në sistem kjo fushë nuk është obligative të plotësohet. Vendosija e numrit të kontratës, mund të parandalojë mbi pagesa për atë kontratë e po ashtu rrit efektivitetin në menaxhimin e performancës së saj.

¹⁹ Manuali i auditimit të teknologjisë së informacioni - Kontrollet e aplikacionit- Përpunimi

²⁰ Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit 3.1. Menaxhimi i shërbimit & 3.2 Menaxhimi i kapaciteteve

- Në rastet kur pagesa për një kontratë duhet të bëhet në më shumë se një pjesë, sistemi për çdo urdhër blerje kërkon që e njëjta kontratë të bashkëngjitet për çdo pagesë. Meqenëse sistemi ka mundësinë e lidhjes së këtyre urdhërpagesave në bazë të numrit të kontratës, bashkëngjitja e dokumentit të njëjtë shkakton punë shtesë për përdoruesit si dhe ndikon në performancën e bazës së të dhënave.
- Kontrata dhe fatura duhet të bashkëngjiten për çdo urdhër blerje, por edhe nëse nuk bashkëngjiten sistemi lejon procedimin e mëtutjeshëm edhe pa të. Pas procedimit të saj, më nuk ka mundësi të kthehet edhe t'iu bashkëngjiten dokumentet e nevojshme. Si rrjedhojë, transaksioni ekzekutohet pa qenë i kompletuar në sistem.

Disa nga këto ndryshime nuk ishin paraparë të bëhen fillimisht në sistem, ndaj sipas zyrtarëve secili ndryshim i tanishëm kërkon kosto shtesë.

Raporte jo të plota për analiza të mëtejme

Organizata duhet të ketë procedura të hartuara për të siguruar që plotësia dhe saktësia e të dhënave dalëse/raporteve të aplikacionit të jenë të vlefshme përpara se rezultatet të përdoren për përpunimin pasues, përfshirë përpunimin e përdoruesit fundor.

SIMFK-ja ka një numër të madh të raporteve që përdoruesit fundorë mund t'i përdorin për qëllime statistikore, verifikimin e punës së tyre si dhe nëse sistemi është duke i bërë kalkulimet sipas rregullave në fuqi. Mirëpo, nga raportet e marra si mostra është vërejtur që ka mangësi të disa informatave që do ta kompletinin informacionin e kërkuar.

Te raportet për vlerësimin e pasurisë mungon data e fillimit të zhvlerësimit të pasurive. Në mungesë të saj përdoruesit nuk kanë mundësi të verifikojnë nëse regjistrimi i pasurisë është bërë si duhet apo gjatë regjistrimit ka pasur gabime të cilat mund të ndikojnë në vlerën e kalkuluar për zhvlerësim. Gjithashtu, raportet që përmbajnë numrin e kontratës të një procedure me prokurim, edhe pse në rastet kur në obligime/urdhër blerje regjistrohet numri i kontratës, ky numër nuk paraqitet në raporte.

Po ashtu eksportimi në formatin Excel nuk e bënë ndarjen e kolonave në shtylla, që ndikon në punë shtese për secilin raport që përdoret për kalkulime të mëtejme.

Nëse në SIMFK zgjidhet gjuha Shqipe/Serbe për përdorim, ka raste që kolonat e raporteve si dhe fushat në modulet e aplikacionit nuk janë të gjitha në gjuhën Shqipe/Serbe, por ka kolona dhe fusha që emërtimi ende vazhdon të jenë në gjuhën Angleze.

Këto mangësi në raporte janë si pasojë e mos vlerësimit periodik të raporteve të publikuara, të cilat mund të ndikojnë në kontrole minimale mbi të dhënat e regjistruara. Po ashtu, nëse raportet pas shkarkimit duhet të përpunohen në mënyrë manuale shkakton humbje kohe dhe angazhim shtesë dhe kjo e bën përdoruesin joefikasë. Përkthimi në gjuhët përkatëse, sipas zyrtarëve nuk ishte bërë për shkak të kalimit në version të ri të SIMFK-së si dhe vëllimit të madh të punëve, mirëpo ata kanë deklaruar që përkthimi është në proces.

Konkluzionet

Kontrollet e sigurisë së informacionit

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Thesari, në vazhdimësi kishin bërë konfigurime për mbrojtje ndaj ndërhyrjeve të brendshme dhe të jashtme në sistemet e informacionit. Mirëpo, ende nuk kishin arritur të

krijojnë një strukturë që ofron siguri të plotë të informacionit, nuk kishin përcaktuar personat përgjegjës për siguri të informacionit, kishte mangësi në procedura, mangësi në menaxhimin e qasjeve të përdoruesve si dhe nuk kishte mjaftueshëm ndërgjegjësime mbi sigurinë e informacionit.

Këto mangësi mund të ndikojnë në sigurinë e operimit të pajisjeve përpunuese të TI-së dhe mund të zvogëlojnë aftësinë për të mbrojtur informacionin e përfshirë në sistemet e TI-së që e përdorë Thesari dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Kontrollet e aplikacioneve

Përkundër përmirësimeve të ndërmarra, SIMFK-ja ka ende disa mangësi të kontrolleve të aplikacionit. Në mungesë të ndërlidhjes së SIMFK-së me sistemet tjera qendrore, nuk kishte zbatuar kontrolle të vlefshmërisë së të dhënave për numrin personal identifikues, numrin e biznesit dhe të llogarisë bankare, si dhe nuk kishte kontrolle për të identifikuar dhe refuzuar të dhënat e dyfishta. Si rezultat, është lejuar që të krijohen kode të shumta të furnitorëve me më shumë llogari bankare dhe kupona të shpenzimeve me të dhëna të njëjta.

Gjithashtu, Thesari nuk i ka përmbushur të gjitha kërkesat rregullative në SIMFK, duke ndikuar në regjistrim të shpenzimit për përmirësime të pasurisë si pasuri e re, si dhe në mungesë të kodeve të plota të klasës së pasurisë, OB-të ishin detyruar të klasifikojnë pasuritë në kode me emërtime më të përshtatshme.

Disa nga mundësitë që ofron sistemi nuk janë paraparë të jenë të domosdoshme për regjistrim nga përdoruesit, të cilat do të sjellin përfitime për përdoruesit dhe do të rritnin efektivitetin në punë, e në veçanti do të ndikojnë në prezantimin më të plotë në paraqitjen e statistikave dhe monitorimin më efikas të transaksioneve.

Rekomandojmë Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve:

1. Të harmonizoj pozitat e TI-së dhe Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në raport me privilegjet dhe qasjet e tyre në sistemet e TI-së dhe procedurave duke bërë rishikimin e kësaj Rregullore dhe organizimin e departamentit të TI-së në Thesar. Po ashtu të siguroj administrimin e bazave të të dhënave vetëm përmes administratorëve që kanë detyrë dhe përgjegjësi administrimin e bazës së të dhënave përmes obligimit kontraktual;
2. Që në strukturën organizative të MFPT-së dhe Thesarit të parashikojnë dhe të përcaktojnë zyrtarin për sigurinë e informacionit duke rishikuar dhe miratuar rregulloret e brendshme, politikat e TI-së dhe sigurisë së informacionit, në mënyrë që të përcaktojnë edhe privilegjet dhe qasjet e tyre përkatësisht me përgjegjësitë e pozitës që i takon. Përmes politikës dhe procedurave të TI-së të parashohin realizimin e testit të depërtueshmërisë për mbrojtje nga ndërhyrjet për sistemet e vendosura në rrjetin e MFPT-së në baza të rregullta kohore;
3. Që krahas konfigurimeve në rrjet, të realizoj edhe dokumentimin e rrjetit për të siguruar vazhdimësinë e sistemeve (Departamenti i TI-së në MFPT);
4. Të organizoj në vazhdimësi trajnime dhe fushata për punonjësit e tyre për rëndësinë dhe ndërgjegjësimin ndaj sigurisë së informacionit. Poashtu të zbatoj politikën e kompleksitetit të fjalëkalimeve për llogaritë e përdoruesve (të MFPT-së dhe të Thesarit) në Active Directory (Departamenti i TI-së në MFPT);
5. Të siguroj që qasjet administrative në sistemet e informacionit të bëhen përmes llogarive që identifikojnë përdoruesin dhe çdo ndryshim që ai bën. Të ruaj fjalëkalimin e administratorit në ambiente të sigurta dhe të krijoj mekanizmat e nevojshëm për monitorimin e vazhdueshëm të gjurmëve të auditimit (MFPT dhe Thesari);
6. Të krijoj mekanizmat e nevojshëm për zbatimin e procedurës për menaxhimin e qasjeve të përdoruesve të SIMFK-së. Të sigurohet që përdoruesit të kenë vetëm një llogari në SIMFK, llogaritë e dyfishta duhet të

mbyllen. Poashtu, të sigurohet se sistemi është duke i çaktivizuar përdoruesit të cilët nuk e përdorin SIMFK-në; Të zbatohet në vazhdimësi procedurën për qasjen e përdoruesve në rrjet për punë nga distanca (Thesari);

7. Në SIMFK të bëjë kontrolle për vlefshmërinë e fushës së numrit personal identifikues, numrit unik identifikues dhe llogarisë bankare, si dhe të bëhet ndërlidhja e sistemit me sistemet e informacionit të ARC-së, ARBK-së dhe BQK-së (Thesari);
8. Të rishikoj procedurën për regjistrimin e furnitorëve në SIMFK për rastin kur furnitorit të regjistruar duhet t'i shtohet llogaria e re bankare, si dhe në aplikacionin e SIMFK-së një furnitor të regjistrohet vetëm njëherë dhe çdo llogari e re bankare e furnitorit të shtohet në kodin ekzistues të tij (Thesari);
9. Të krijoj mundësinë në SIMFK që shpenzimet e përmirësimit të pasurisë jo financiare kapitale të regjistrohen në regjistrat përkatës si rritje e vlerës së pasurisë (Thesari);
10. Të regjistrojë në SIMFK të gjitha kodet e klasave të pasurisë të publikuara, që t'i mundësojë organizatave buxhetore klasifikimin e saktë të pasurisë gjatë regjistrimit sipas planit kontabël (Thesari);
11. Të zbatohet në SIMFK funksionin e kontrollit për identifikimin dhe refuzimin e transaksioneve me të dhëna identike (Thesari);
12. Të rishikoj mundësitë që ofron SIMFK-ja dhe të shfrytëzoj përparësitë e tij në mënyrë që të rris edhe më tej efikasitetin e punës së përdoruesve (Thesari);
13. Të bëjë një vlerësim të nevojave të përdoruesve për raporte dhe të sigurohet që të ofroj raporte të ndryshme sipas nevojave të tyre. Mangësitë e identifikuara në raporte/module të korrigjohen (Thesari).

4. Analiza e Buxhetit Shtetëror

Të dhënat e prezantuara në RFV-të e BRK-së janë reflektim i projeksioneve fillestare dhe përfundimtare të buxhetit për vitin 2020, si dhe rrjedhojë e pranimeve dhe pagesave reale kundrejt ndarjeve përkatëse buxhetore. Gjatë vitit 2020 është bërë rivlerësimi Buxhetit të Republikës së Kosovës, kjo për arsye se Qeveria e kishte parë të nevojshme rishikimin planifikimit të të hyrave dhe shpenzimeve.

Ministria e Financave, ka rishikuar Ligjin e Buxhetit Nr.07/L-001 për ndarjet buxhetore për vitin 2020 (në korrik), i cili u karakterizua me shkurtimin e projeksioneve për të hyrat tatimore dhe jo tatimore, rritjen e financimit nga huamarrja dhe rritjet në disa kategori të shpenzimeve. Kjo për të adaptuar masat e kërkuara si pjesë e Pakos Fiskale Emergjente dhe Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike (PRE) në rrethanat e të hyrave shumë më të ulëta se sa ishin planifikuar në buxhetin fillestar.

Në vitin 2020 Qeveria për shkak të ndikimit të pandemisë Covid -19 në ekonomi, kishte ndërmarrë masa që parashikimet fiskale për këtë vit të ndryshojnë në krahasim me projeksionet fillestare të buxhetit. Të hyrat tatimore bruto me Ligjin e Buxhetit Nr. 07/L-001 për Ndarjet Buxhetore për vitin 2020 ishin planifikuar në shumën prej 1,833,000,000 €. Kurse, me rishikim të buxhetit, të njëjtat ishin planifikuar në shumën prej 1,604,802,000 €, me një shkurtim prej 228,198,000 € apo 12.45%.

Financimi nga huamarrja sipas Ligjit Buxhetit Nr. 07/L-001 për Ndarjet Buxhetore për vitin 2020 ishin planifikuar në shumën prej 323,474,000 €. Me rishikimin e tij, planifikimi për financimin nga huamarrja ishte 596,200,000 €, me një rritje për 272,726,000 € apo 84.3% e planit fillestar.

Meqë disa parametra makro-fiskal (të hyrat tatimore dhe jo tatimore) të paraqitura në Tabelën Nr.1 të Ligjit Nr.07/L-001 për Ndarjet Buxhetore për vitin 2020 ndikohen nga situata e pandemisë globale Covid-19, është paraqitur nevoja të ndryshohen përkohësisht disa nga rregullat fiskale të përcaktuara me Ligjin Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit i plotësuar dhe i ndryshuar, neni 22 B- rritja e përkohshme e deficitit.

Sipas Vendimit të Qeverisë Nr.03/02 i datës 05.06.2020, pika 1, është kërkuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që të bëjë ndryshimin dhe tejkalimin e përkohshëm të rregullave fiskale të deficitit buxhetor si dhe kufizimin e bilancit bankar të shfrytëzueshëm, i cili është i përcaktuar në nenin 22 B, Ligji Nr.03/048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin Nr.04/L-116, Ligjin Nr.04/L-194, Ligjin Nr.05/L-063 dhe me Ligjin Nr.05/L-007.

Për mbulimin e rritjes së deficitit, Ministria e Financave, ka identifikuar burimet shtesë të financimit të deficitit. Kjo është planifikuar të financohet nga burimet e brendshme dhe të jashtme të financimit, përmes letrave me vlerë, kredive ndërkombëtare si dhe granteve.

Konform këtij Vendimi (Nr.03/02), në pikën 2, është aprovuar tejkalimi i kufirit të deficitit, i cili është rritur përkohësisht deri në 6.5%, nga 2% sa ishte. Ndërsa kufiri i bilancit të shfrytëzueshëm bankar është zvogëluar përkohësisht deri në 3% e BPV-së, nga 4.5% sa ishte.

Kuvendi ka miratuar zbutjen e përkohshme të këtyre rregullave fiskale dhe ka lejuar zgjerimin e hapësirës fiskale në nivelin e paraparë nga Qeveria. Më konkretisht, deficitit fiskal është lejuar të arrijë 6.5% të BPV-së (nga 2% e BPV-së sa ishte). Ndërkaq bilanci bankar është lejuar të arrijë 3% të BPV-së (ku ishte 4.5% e BPV-së).

Lëvizjet buxhetore përmes Vendimeve të Qeverisë, kishin ndikuar në disa Organizata Buxhetore, ku në kategori të caktuara ekonomike dhe projekte kishte rritur buxhetin, kurse në disa të tjera e kishte zvogëluar atë. Realizimi i buxhetit edhe këtë vit është përcjellur me mangësi të ndryshme, ku reduktimi i fondeve nga Qeveria ka ndikuar që shuma të konsiderueshme të detyrimeve të mbesin të papaguara dhe shumë projekte të mos realizohen dhe të barten për vitet vijuese.

Në aspektin e planifikimit dhe realizimit të pranimeve dhe pagesave, është vërejtur një trend i rënies në krahasim me vitet paraprake. Pranimet/të hyrat e planifikuara janë realizuar në shumën prej 2,206,647,000 € apo 83.5% në raport me buxhetin final, me një rënie të lehtë krahasuar me vitin 2019, ku realizimi i buxhetit për pranimet ishte 89.9%.

Pagesat e planifikuara janë realizuar në shumë prej 2,334,943,000 € apo 82% në raport me buxhetin final. Nëse e krahasojmë me vitin 2019, edhe te pjesa e pagesave vërehet një rënie e lehtë, ku realizimi i buxhetit ishte 85.5%. Në nivelin e fondeve burimore shkalla më e ulët e shënuar në realizimin e pagesave ishte nga fondi burimor klauzola investive me 47,065,267 € apo 32% e buxhetit; të hyrat e njëhershme të AKP-së me 71,451,044 € apo 39%; të hyrat vetanake me 75,393,688 € apo 51%, dhe financimi nga huamarrja me 68,575,947 apo 74%.

Informata më të plota mbi planifikimet fillestare dhe buxhetin përfundimtar, janë prezantuar në tabelën në vijim.

Tabela 3 -Pasqyra e konsoliduar e krahasimit të buxhetit me realizimin për Qeverinë e Përgjithshme (në ‘000 €)

Nr.	Zërat Buxhetor	Realizimi	RFV Sipas Ligjit të Buxhetit Final	RF Sipas Ligjit të Buxhetit Nr. 07/L-001 viti 2020
1	Të hyrat tatimore	1,539,982	1,604,802	1,833,000
2	Të hyrat jo tatimore	181,201	188,913	226,487
3	Kthimet	-32,999	-39,631	-50,000
4	Pranimet nga donacionet	43,078	46,410	22,500
5	Financimi nga huamarrja	389,031	596,200	323,474
6	Të hyrat tjera	86,354	244,609	124,609
Gjithsej pranimet		2,206,647	2,641,303	2,480,070
1	Paga dhe mëditje	661,343	665,782	619,204
2	Mallra dhe shërbime	280,007	327,244	326,424
3	Shpenzime komunale	22,168	24,773	30,545
4	Subvencione dhe transfere	868,480	923,701	632,753
5	Shpenzimet kapitale	384,471	720,416	671,808
6	Rezerva	0	1,896	44,000
7	Pagesa e borxhit	115,713	183,000	177,000
8	Kthimi nga fondi i depozitave	2,761	0,00	0,00
Gjithsej Pagesat		2,334,943	2,846,812	2,501,734
Rritja/zvogëlimi i bilancit bankar		-128,296	-205,510	-21,664

Qeveria kishte dërguar në Kuvend për miratim Ligjin e Buxhetit fillestar, ku kishte parashikuar pranime/të hyra në total prej 2,480,070,000 € dhe pagesa/shpenzime në total prej 2,501,734,000 €, me një zvogëlim në bilancin bankar minus 21,664,000 €. Stoku i bilancit bankar i pashpërndarë është 323,000,000 €, kurse bilanci bankar i shfrytëzueshëm si përqindje e BPV-së së parashikuar është 7,464,000,000 € apo 4.32%.

Sipas buxhetit final, pranimet/të hyrat totale kishin vlerën e njejtë me atë të planifikuar me buxhetin e rishikuar, kurse pagesat/shpenzimet në total ishin 2,846,813,812 €, me një rritje prej 73,254,000 € apo 2.65%. Këto rritje kanë qenë në nivelin e kategorive ekonomike të shpenzimeve, duke paraprirë me Subvencionet dhe Transferet me 60,566,000 € apo 7%, pastaj Pagat dhe Mëditjet me 31,251,000 € apo 4.9%; Mallrat dhe Shërbimet me 23,248,000 € apo 7.65%, përderisa Investimet Kapitale ishin shkurtuar për 9,475,000 € apo 1%; Shpenzimet komunale për 232,000 €; dhe Kategoria e Rezervës për 32,104,000 € (ishte transferuar për shpenzime në kategori ekonomike).

Sqarime më të hollësishme rreth lëvizjeve të buxhetit, rritjet/shkurtime në nivelin e kategorive ekonomike kemi prezantuar në kapitullin më poshtë.

Ne kemi analizuar tabelat e Ligjit të Buxhetit nr.07/L-001 dhe Ligjit të Buxhetit me rishikim mbi ndarjet buxhetore për BRK-në për vitin 2020 dhe kemi identifikuar mospërputhje ndërmjet tabelave buxhetore në prezantimin e të hyrave të planifikuara për tatimin në pronë dhe të hyrave jo tatimore për taksa dhe ngarkesa tjera në nivelin lokal.

Pasaktësitë e identifikuar në këto tabela janë:

- Në tabelën nr.1 të Ligjit të Buxhetit nr.07/L-001, parashikimet fiskale 2020/2022 - të hyrat tatimore - tatimi në pronë dhe tokë, ishin planifikuar në shumë prej 31,000,000 €. Ndërkaq në tabelën nr.4.3 - planifikimi afatmesëm i të hyrave totale - buxheti komunal, të hyrat e planifikuara për tatimin në pronë dhe tokë janë 33,144,016 €, me një mospërputhje për 2,144,016 €.
- Në tabelën nr.1 e Ligjit të Buxhetit me rishikim nr. 07/L-014, parashikimet fiskale 2020/2022- të hyrat tatimore- tatimi në pronë dhe tokë, ishin planifikuar në shumë prej 29,000,000 €. Përderisa në tabelën nr.4.3- planifikimi afatmesëm i të hyrave totale- buxheti komunal, të hyrat e planifikuara për tatimin në pronë dhe tokë janë 33,144,016 €, me një mospërputhje për 4,144,016 €.
- Në tabelën nr.1 e Ligjit të Buxhetit me rishikim nr. 07/L-014, parashikimet fiskale 2020/2022 - të hyrat tatimore - taksa dhe ngarkesa tjera në nivelin lokal, ishin planifikuar në shumë prej 47,000,000 €. Kurse sipas tabelës nr.4.3 - planifikimi afatmesëm i të hyrave totale- buxheti komunal, të hyrat e planifikuara jo tatimore për taksa dhe ngarkesa tjera janë 49,972,562 €, me një mospërputhje për 2,972,562 €.

Megjithatë ne kemi analizuar edhe tabelat e Ligjit të Buxhetit nr.07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për BRK-në për vitin 2021 dhe nuk kemi identifikuar mospërputhje të tilla ndërmjet tabelave buxhetore në prezantimin e të hyrave të planifikuara për tatimin në pronë dhe të hyrave jo tatimore për taksa dhe ngarkesa tjera në nivelin lokal. Me këtë rast kemi vërejtur që kjo çështje është rregulluar për këtë vit.

Analiza e shpenzimeve sipas kategorive

Pasaktësitë e identifikuar në Pasqyrën e konsoliduar të krahasimit të buxhetit me realizimin janë prezentuar te baza për opinion.

Ne vlerësojmë se të hyrat vetanake të bartura nga vitet paraprake nuk do të duhej të përfshiheshin si pranime - burim i financimit të shpenzimeve në Ligjin e Buxhetit. Kjo sepse janë fonde të bartura për qëllime specifike të cilat në llogarinë e vetme të thesarit janë pranuar nga vitet paraprake.

LMFPP-ja si dhe Ligji i Buxhetit përcakton mënyrën e bartjes së bilancit të fondeve të pashpenzuara të të hyrave vetanake. Ato alokohen fillimisht duke rritur buxhetin e organizatave buxhetore dhe pas kësaj ato mund të shpenzohen. Për këtë qëllim ato nuk duhet të planifikohen si pranime dhe shpenzime në tabelat e Ligjit

Buxhetit edhe nuk janë të përfshira si burim i shpenzimeve në buxhetin e Organizatave Buxhetore kur të dërgohen si projekt buxhet për aprovim në Kuvend.

Vlenë të theksohet se Qeveria e kishte dërguar për aprovim në Kuvend Ligjin e Buxhetit Nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, ku në Tabelën Nr.1- Parashikimet Fiskale (të hyrat dhe shpenzimet) në pjesën C - Financimi i brendshëm, alokimet për shpenzim nga të hyrat vetanake të bartura (niveli lokal), ishin prezantuar me vlerën zero. Nga kjo vlerësojmë se për vitin 2021 është adresuar kjo çështje, e cila gjatë auditimit të RFV të BRK-së, nga Zyra Kombëtare e Auditimit është ngritur dhe trajtuar si çështje që duhet të adresohet nga MF.

4.1 Analiza e të hyrave të përgjithshme buxhetore dhe e shpenzimeve

Pagesat sipas Ligjit të Buxhetit nr.07/L-001 janë planifikuar më të mëdha se pranimet e rregullta për 22,000,000 €. Kjo shumë është planifikuar të financohet nga zvoglimi i bilancit bankar i grumbulluar nga vitet paraprake.

Të dhënat e prezantuara në PFV-të e BRK-së janë reflektim i pranimeve dhe pagesave reale, si dhe ndarjeve buxhetore përkatëse. Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2020 nga Qeveria ishte dërguar në Kuvend për rishikim, ku janë bërë rregullime të ndryshme në ndarjet fillestare buxhetore. Këto rregullime janë bazuar në autorizimet ligjore që mundësohen përmes Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Pranimet/ të hyrat sipas buxhetit fillestar ishin planifikuar në shumën prej 2,480,070,000 €, ndërsa sipas buxhetit final ishin 2,641,303,000 €, ku vërejmë një rritje prej 161,233,000 €. Rritja është planifikuar nga këto burime të financimit: huamarrja prej 272,726,000 €; pranimet tjera prej 120,000,000 €; grantet dhe ndihmat prej 23,910,000 €; kthimet me 10,000,000 €, si dhe shkurtimi i të hyrave tatimore në vlerë prej 228,198,000 € dhe të hyrave jo tatimore prej 37,205,000 €.

Pagesat/ shpenzimet sipas buxhetit fillestar ishin në shumën prej 2,501,734,000 €, kurse sipas buxhetit final në SIMFK, totali i planifikuar i pagesave ishte 2,846,813,000 €, me një rritje prej 345,079,000 €. Mbulesa e kësaj rritje ishte planifikuar nga rishikimi buxhetit për 274,268,000 €, rritja e të hyrave vetanake të bartura për 53,317,000 €, si dhe nga Grantet e Përcaktuara të Donatorëve për 17,494,000 €.

Pranimet për vitin 2020

Gjithsej pranimet apo të hyrat e realizuara në vitin 2020, kapin vlerën prej 2,206,647,000 €. Krahasuar me realizimin e vitit 2019, pranimet janë zvogëluar për 16,275,000 € apo 0.73%, kurse me vitin 2018 janë rritur për 196,974,000 € apo 9.8%

Tabela 4 -Pranimet dhe Pagesat sipas RFV-së së BRK-së (‘000 në €)

Përshkrimi	Realizimi 2020	Buxheti final	Buxheti fillestar	Realizimi 2019	Realizimi 2018
Pranimet	2,206,647	2,641,303	2,480,070	2,222,922	2,009,673
Pagesat	2,334,943	2,846,813	2,501,734	2,152,546	1,979,559
Deficiti/Suficiti	(128,295)	(205,510)	(21,664)	70,376	30,115

Çështjet kryesore të identifikuara gjatë analizave tona janë si në vijim:

Ndryshimet ndërmjet buxhetit fillestar dhe atij final, vërehen me një rritje si në aspektin e planifikimit të pranimeve, po ashtu edhe të pagesave. Sipas ligjit të buxhetit fillestar, pranimet ishin planifikuar në vlerën prej 2,480,070,000 € apo për 21,664,000 € ose 1% më të ulëta se pagesat (zvogëlimi i bilancit bankar). Ndërkaq, sipas buxhetit final në SIMFK, pagesat ishin planifikuar të jenë më të larta se pranimet për 205,510,000 €. Dallimet në mes projeksioneve fillestare dhe përfundimtare të buxhetit janë të theksuara, për shkak të ndikimit të pandemisë Covid -19. Qeveria kishte ndërmarr masa për rishikimin e të hyrave tatimore dhe jotatimore duke i zvogëluar, ndërsa projeksionet për financimin nga huamarrja ishin rritur me rishikimin e buxhetit.

Pranimet ishin realizuar në shumën prej 2,206,647,000 € apo 83.5% e buxhetit final. Krahasuar me dy vitet e fundit, pranimet janë rritur për 16,275,000 € apo 0.73% për vitin 2019, ndërsa për 196,974,000 € apo 9.8% për vitin 2018.

Sa i përket pagesave, realizimi për vitin 2020 ishte në vlerë prej 2,334,943,000 € apo 82% e buxhetit final. Ndërkaq, nëse krahasojmë me pagesat e dy viteve të fundit, ka pasur rritje nga viti 2019 për 182,397,000 € apo 8.47%, kurse për 355,384,000 € apo 17.9% nga viti 2018.

Ndryshimi në mes totalit të pranimeve dhe totalit të pagesave është -128,295,000 €. Kjo shumë paraqet fondet shpenzuara nga rezerva e bilancit bankar dhe reflekton në zvogëlimin e parasë së gatshme në llogarinë bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës, e cila në datën 31 dhjetor 2020 ka një saldo përfundimtare prej 329,955,000 €, duke përfshirë edhe fondet për qëllime specifike.

Nëse analizojmë trendin historik të tri viteve të fundit vërehet se pranimet dhe pagesat kanë shënuar rritje të vazhdueshme.

4.2.1 Analiza e të hyrave buxhetore sipas kategorive ekonomike

Nga analiza e pranimeve/të hyrave sipas burimeve, shihet se burimet kryesore për financimin e buxhetit janë: të hyrat tatimore (direkte dhe indirekte) në vlerë neto prej 1,506,983,000 € apo me 68.30%; financimi nga huamarrja 389,031,000 € apo me 17.63%; të hyrat jo tatimore 181,201,000 € apo me 8.20%; të hyrat tjera 86,355,000 € apo me 3.90%, si dhe grantet e ndihmat 43,078,000 € apo me 1.9%. Pasqyra më poshtë ofron informata më të plota për buxhetin fillestar, final dhe trendet buxhetore gjatë tri viteve të fundit.

Tabela 5 - Pranimet sipas burimit sipas RFV-ve të BRK-së
(‘000 në €)

Pranimet	Realizimi 2020	Buxheti final	Buxheti fillestar	Realizimi 2019	Realizimi 2018
Tatimet direkte	267,247	282,410	312,000	292,259	267,504
Tatimet indirekte	1,272,735	1,322,392	1,521,000	1,415,291	1,344,130
Kthimet	-32,999	-39,361	-50,000	-45,507	-47,880
Të hyrat jo tatimore	181,201	188,913	226,487	214,614	192,865
Financimi nga huamarrja	389,031	596,200	323,474	158,264	122,018
Grantet dhe ndihmat	43,078	46,410	22,500	19,487	8,319
Pranimet tjera	86,355	244,609	124,609	168,514	122,717
Gjithsej	2,206,647	2,641,303	2,480,070	2,222,922	2,009,673

4.2.2 Analiza e të hyrave buxhetore (struktura)

Tatimet direkte

Tatimet direkte përbëhen prej katër kategorive: tatimi në të ardhura të korporatave; tatimi në të ardhura personale; tatimi në pronë, si dhe tatime tjera (gjobat e ATK-së). Realizimi i tatimeve direkte ishte në vlerë prej 267,247,000 € apo 94.6% e shumës së planifikuar me buxhetin vjetor.

Burim kryesor i këtyre tatimeve direkte është: tatimi në të ardhura personale me 157,966 € (59%) e realizimit të përgjithshëm; tatimi në të ardhura të korporatave me 85,235,000 € (32%); tatimi në pronë me 22,707,000 € (8%), dhe tatimet tjera me 1,294,000 € apo rreth 1%. Prej tyre, tatimi në të ardhura personale dhe tatimi në të ardhura nga korporatat ishte grumbulluar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), ndërsa tatimi në pronë nga komunat. Krahasuar me vitin 2019, tatimet direkte në përgjithësi kanë shënuar rënie për 25,012,000 € apo 8.6%, dhe 257,000 € apo 0,10% krahasuar me vitin 2018.

Tatimet indirekte

Burimet kryesore të tatimeve indirekte janë: tatimi në vlerën e shtuar (TVSH); detyrimi doganor; akcizat dhe tatimet tjera indirekte. Realizimi total për këtë kategori të të hyrave ishte 1,272,735,000 € apo 96.2% nga shumata e planifikuar me buxhetin vjetor. Tatimi i mbledhur në vlerën e shtuar ishte 770,145,000 € ose 60.5% e realizimit total; akcizat 398,072,000 € ose 31.3%; taksat doganore 101,618,000 € ose rreth 7.98% dhe pjesa e mbetur prej 2,900,000 € ose 0.23% i takon tatimeve tjera indirekte. Krahasuar me vitin 2019, tatimet indirekte kanë shënuar rënie për 142,556,000 € apo 10%, si dhe 71,395,000 € apo 5.3% krahasuar me vitin 2018.

Kthimet tatimore

Kthimet tatimore ndodhin për shkak të shumave të paguara nga tatimpaguesit mbi shumën e detyrimit tatimor. Me rastin e barazimit të gjendjes së tatimeve me ATK-në dhe Doganat e Kosovës, përllogariten diferencat, dhe si të tilla u kthehen subjekteve të ndryshme pas shqyrtimit të kërkesave për rimbursim.

Sipas buxhetit shumata e kthimeve ishte planifikuar në vlerën prej 39,631,000 €, ndërkaq shumata e kthyera deri në përfundim të vitit ishin për 32,999,000 € ose 83.3% e planit dhe 2.1% e totalit të përgjithshëm të tatimeve të inkasuara. Prej tyre, vlera e kthimeve nga ATK-ja ishte 31,344,000 €, kurse 1,655,000 € janë kthimet nga DK.

Shumata e kthyer e tatimeve direkte dhe indirekte ka të bëjë me kthimin e TVSH-së së brendshme prej 30,325,000 €; kthimin e TVSH-së kufitare prej 792,838 €; kthimin e tatimit në korporata prej 514,000 €; kthimin e akcizës prej 464,253 €; kthimin e taksës doganore prej 362,884 €; kthimin e tatimit për pagat e mbajtura në burim prej 349,000 €, si dhe llojet tjera të tatimeve prej 191,025 €.

Në krahasim me vitin 2019, kthimet e tatimeve ishin për 12,508,000 € më të ulëta ose për 27%.

Performanca buxhetore e Doganës dhe Administratës Tatimore të Kosovës

Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës janë dy agjencitë kryesore qeveritare për mbledhjen e tatimeve direkte dhe indirekte, si: TVSh-ja, taksat doganore, akcizat, tatimi në të ardhura të korporatave, tatimi në të ardhura personale dhe të tjera.

Të hyrat doganore të planifikuara nga Qeveria e Kosovës me Ligjin Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2020 ishin 1,244,000,000 €. Ndërkaq, me Ligjin e rishikuar të Buxhetit nr.07/L-014, vlera e parashikuar e të hyrave doganore ishte reduktuar në 1,084,000,000 €. Nga kjo vlerë, DK-ja kishte arritur të realizonte 1,052,525,263 €, ndërsa në vlerën neto realizimi ishte 1,050,869,892 € apo 97% e planifikimit.

Në krahasim me vitin 2019 të hyrat totale kanë pësuar rënie për 127,060,769 € apo 10.80%. Nëse analizojmë sipas llojeve të tatimit, të hyrat në kufi nga tatimi në vlerën e shtuar (TVSh) ishin 547,646,000 € apo 9.6% më të ulëta, të hyrat nga akciza në kufi ishin 398,072,000 € apo 8.60% më të ulëta dhe të hyrat e mbledhura nga taksa doganore ishin 101,618,000 € apo 22% më të ulëta. Siç është sqaruar më lartë, kjo kishte ndodhur kryesisht për shkak të situatës së krijuar me pandeminë Covid 19, e cila ka ndikuar drejtpërdrejtë në rënien e mbledhjes së të hyrave. Efekt në të hyra kanë pasur edhe politikat fiskale shtetërore apo lirimet nga taksat në import për prodhuesit kosovar për lëndën e parë dhe të gjitha inputet që përdoren në procesin e prodhimit, ndikimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe i Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë me Turqinë.

Administrata Tatimore e Kosovës për vitin 2020 kishte planifikuar të inkasojë të hyra në shumën prej 557,000,000 €. Me rishikimin e buxhetit, vlera e parashikuar e të hyrave tatimore ishte reduktuar në 492,000,000 €. Nga kjo vlerë, ATK-ja kishte arritur të realizonte 467,039,833 € apo 95% të planit. Kurse, në vlerën neto, realizimi ishte 435,695,779 €. Në raport me vitin e kaluar, të hyrat totale kanë pësuar rënie. Në vitin 2020, realizimi në të hyrat bruto ishte zvogëluar për 37,242,071 € apo 7.4% në krahasim me vitin e kaluar. Kjo rënie kishte ndodhur kryesisht për shkak të situatës së krijuar me pandeminë Covid 19, e cila ka ndikuar si në aktivitetet e reduktuara të ATK-së për mbledhjen e të hyrave, ashtu edhe nga rënia e aktivitetit ekonomik të bizneseve.

Menaxhimi i të hyrave doganore nga ana e DK-së kishte funksionuar mirë, përderisa procesi i mbledhjes dhe menaxhimit të të hyrave të ATK-së është përcjellë me disa mangësi të cilat lidhen me procesin e papërfunduar të fiskalizimit.

Edhe më tutje, po vazhdon të mbetet sfida për ATK-në fiskalizimi i plotë i të gjitha bizneseve që i plotësojnë kriteret për fiskalizim. Numri i bizneseve që nuk janë të fiskalizuara, mirëpo sipas legjislacionit në fuqi kërkohet të pajisen me arka fiskale në fund të vitit 2020 ishte 13,802.

Të hyrat jo tatimore

Në kategorinë e të hyrave jo tatimore bëjnë pjesë të gjitha llojet e taksave administrative dhe taksave tjera, llojet e ndryshme të gjobave, të hyrat nga inspeksioni, shfrytëzimi i pronës publike, tarifatat e shërbimeve, licencat, qiratë për pronat publike, taksat koncesionare, rentat minerare, etj.

Të hyra jo tatimore mbledhen nga niveli qendror, agjencitë e pavarura buxhetore dhe niveli lokal.

Te hyrat jo tatimore për vitin 2020 sipas Ligjit të Buxhetit fillestar ishin planifikuar në vlerë prej 226,487,000 €, përderisa me rishikim të buxhetit ishin planifikuar 189,000,000 €. Prej tyre në nivelin qendror ishin planifikuar 105,000,000 €, në nivelin lokal 47,000,000 €, renta minerare 30,000,000 €, të hyrat nga interesi 4,000,000 € dhe taksa koncesionare 3,000,000 €.

Shuma totale e realizimit të të hyrave jo tatimore gjatë vitit 2020 ishte 181,201,000 € apo 96% e planit. Prej tyre, 103,486,000 € ishte shuma e mbledhur nga subjektet e Qeverisjes Qendrore, 42,716,000 € nga Qeverisja Lokale, 29,362,000 € janë inkasuar nga rentat minerare, 2,986,000 € të hyrat nga interesi i kredive nga KEK-u dhe 2,651,000 € nga taksat koncesionare.

Nëse krahasojmë realizimin e këtyre të hyrave në relacion me buxhetin, atëherë në nivelin qendror është realizuar 98.5% e planit, kurse në nivelin lokal me 91%. Ndërkaq nëse analizojmë trendin e tri viteve të fundit, shihet se të hyrat jo tatimore kanë shënuar rënie për 33,413,000 € apo 16% krahasuar me vitin 2019 dhe për 11,664,000 € apo 6% në raport me vitin 2018.

Mangësitë apo parregullsitë e identifikuara nga raporteve individuale të auditimit në kategorinë e të hyrave jo tatimore janë:

- Mos-harmonizimi i të hyrave me Thesarin;
- Mbikëqyrja e dobët e shfrytëzuesve të ujit;
- Shqyrtimi i vonuar i kërkesave për pajisje me leje të ndërtimit dhe leje mjedisore;
- Shfrytëzimi i pronave publike pa kompensim dhe me kontrata të skaduara;
- Parregullsi në faturimin e tatimit në pronë;
- Menaxhimi jo adekuat i pronave komunale të dhëna me qira;
- Mangësi në bazën e të dhënave për tatimin në pronë;
- Mos verifikimi (inspektimi) i pronave të regjistruara;
- Mos pagesa e taksës për ushtrimin e veprimtarisë;
- Mos verifikimi i gjendjes aktuale të pronave;
- Faturimi jo sipas zonës reale;
- Regjistrimi i të hyrave në kode ekonomike jo përkatëse; dhe
- Llogaritja e gabuar e tarifave për leje ndërtimore.

Huamarrja e jashtme dhe e brendshme

Si burim për financimin e pagesave buxhetore, me Ligjin e Buxhetit Nr.07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2020, Qeveria kishte planifikuar që një pjesë të pagesave ta financojë nga huamarrjet.

Pranimet nga huamarrja me Ligjin Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2020 ishin planifikuar 323,474,000 €. Ndërkaq, pas rishikimit të buxhetit shuma e financimit nga huamarrja ishte rritur në 596,200,000 € apo 84.3% e planit fillestar. Kjo për arsye se disa parametra makro-fiskal (të hyrat tatimore dhe jo tatimore) janë ndikuar nga situata e pandemisë globale Covid-19.

Huamarrja e brendshme ishte planifikuar në vlerë prej 170,000,000 €, ku janë realizuar 169,955,000 € pothuajse 100% e planit.

Huamarrja e jashtme ishte planifikuar në vlerë prej 426,200,000 €, ndërsa janë realizuar 219,077,000 € apo 51% e planit. Kjo kishte ndodhur pasi që njësitë implementuese nuk kishin marrë parasysh të gjithë faktorët dhe nuk kishin bërë përgatitjet e duhura me rastin e planifikimit të projekteve, pas kërkesave për iniciimin e procesit të huamarrjes. Aranzhimet për huamarrje kanë ndodhur para se të krijohen kushtet për shfrytëzimin e këtyre fondeve.

Shënim: Në seksionin vijues të raportit, financimi nga huamarrja do të prezantohet më hollësisht.

Grantet e përcaktuara të donatorëve

Grantet e Përcaktuara të Donatorëve janë fonde të cilat duhet të shfrytëzohen në pajtim me kushtet e marrëveshjeve në mes të Qeverisë dhe dhuruesve. Këto fonde planifikohen me buxhet vjetor dhe janë pjesë e të hyrave të përgjithshme buxhetore për financimin e projekteve të ndryshme.

Sipas Ligjit të Buxhetit fillestar nr.07/L-001 për Ndarjet Buxhetore për vitin 2020, grantet ishin planifikuar në shumë prej 23,000,000 €, ndërsa me buxhet final duke i përfshirë edhe grantet për mbështetje buxhetore, ishin planifikuar 46,410,000 €, kurse ishin pranuar 43,078,000 € apo 93%. Shuma e këtyre granteve në vitin 2019 ishte realizuar me 19,487,000 €, përderisa në vitin 2018 ishte 8,497,000 €.

Në fund të vitit 2020 fondet e pashpenzuara nga donatorët arrijnë shumën prej 9,752,000 €. Mos efikasiteti i shfrytëzimit të fondeve nga donatorët sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshje, rritë rrezikun që grantet në të ardhmen të zvogëlohen.

Pranimet tjera

Pranimet tjera përbëhen nga financimi i njëhershëm nga AKP-ja, kthimi i kredive nga ndërmarrjet publike, taksat koncesionare, të hyrat e dedikuara dhe fondi i depozitave. Për vitin 2020 sipas Ligjit të Buxhetit Nr.07/L-001, pranimet tjera ishin planifikuar në vlerë prej 124,609,000 €, kurse me rishikimin e buxhetit ishin rritur në 244,609,000 €. Buxheti ishte: të hyrat e njëhershme nga AKP-ja në vlerë prej 185,000,000 €, të hyrat vetanake të bartura 42,000,000 €, kthimi i kredive nga ndërmarrjet publike 11,000,000 € dhe të hyrat e dedikuara për 6,609,000 €.

Ndërsa realizimi ishte si në vijim: të hyrat e njëhershme nga AKP-ja në shumën prej 71,476,000 € apo 38% e planit, kthimi i kredive nga ndërmarrjet publike 11,387,000 € (kemi tejkalim të planit për 387,000 € apo 3.5%) dhe të hyrat e dedikuara në shumën prej 2,473,000 € apo 37.4%.

4.2.3 Analiza e shpenzimeve sipas kategorive

Shpenzimet e përgjithshme për vitin 2020 të planifikuara sipas buxhetit final ishin 2,846,812,000 €, ndërsa realizimi i tyre ishte 2,334,943,000 € apo 82% e shumës së planifikuar. Shpenzimet për vitin 2020 ishin më të larta për 182,396,000 € apo 8.47% krahasuar me vitin 2019 dhe 355,386,000 € apo 17.95% me vitin 2018.

Sipas Ligjit të Buxhetit nr.07/L-001 për vitin 2020 ishin planifikuar pagesa në vlerë prej 2,501,734,000 €, ndërsa me buxhetin final ishte 2,846,812,813 €, me një rritje për 345,079,000 € apo 15.8%.

Kjo rritje ka ardhur si rezultat i çështjeve në vijim:

- Ndryshimit me rishikim sipas LMFPP-së në vlerë prej 274,268,000 €;
- Të hyrave vetanake të bartura në vlerë prej 53,317,000 €; dhe
- Grantet e përcaktuara të donatorëve në vlerë prej 17,494,000 €.

Tabela 6 - Lëvizjet ndërmjet buxhetit fillestar dhe atij final

(*000 në €)

Përshkrimi	Ndarja fillestare sipas Ligjit të Buxhetit	Ndryshimet sipas LMFPP-së	Ndryshimet për të hyrat vetanake	Ndryshimet për grantet e përcaktuara	Ndarjet finale të buxhetit (SIMFK)	Ndryshimet e buxhetit fillestar
Paga dhe Shtesa	619,204	42,756	2,711	1,110	665,782	7.50%
Mallra dhe Shërbime	326,424	-13,410	6,528	7,702	327,244	0.25%
Shpenzime Komunale	30,545	-6,214	435	7	24,773	-19%
Subvencione dhe Transfere	632,753	285,198	4,605	1,145	923,701	46%
Shpenzime Kapitale	671,808	2,041	39,038	7,529	720,416	7.20%
Rezerva	44,127	-42,230	0	0	1,896	-95.70%
Tjera	176,873	6,127	0	0	183,000	3.50%
Gjithsej	2,501,734	274,268	53,317	17,493	2,846,812	13.80%

Lëvizjet buxhetore për kategori ekonomike ndërmjet ligjit të buxhetit dhe buxhetit final

- Buxheti fillestar për Paga dhe Shtesa ishte 619,204,000 €, ndërsaq buxheti final ishte 665,782,000 €, me një rritje prej 46,578,000 € apo 8%. Kjo kishte ndodhur për pagesën e shtesave për kategori të caktuara të punonjësve publik të angazhuar në menaxhimin e pandemisë bazuar në vendimet e Qeverisë;
- Buxheti fillestar për Mallra dhe Shërbime nga 326,424,000 € sa ishte, është rritur në 327,244,000 € apo 0.3%. Kjo për shkak të nevojës për të mbuluar kërkesat nga OB-të, sa i përket disa shpenzimeve lidhur me pandeminë Covid-19;
- Buxheti fillestar për Subvencione dhe Transfere ishte 632,753,000 €, ndërsa buxheti final është rritur për 290,948,000 € apo 46%. Kjo kishte ndodhur për arsye të shpenzimeve të pandemisë nga pakoja emergjente dhe pakoja për rimëkëmbje ekonomike – Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike;
- Buxheti për Investime Kapitale nga 671,808,000 € sa ka qenë i paraparë me ligjin e buxhetit, është rritur për 48,608,000 € apo 7.2%. Kjo kryesisht për arsye të rritjes së të hyrave vetanake të bartura në nivel lokal; dhe
- Financimi i kryegjësë, nën-huazimi dhe interesi nga 177,000,000 € është rritur për 6,000,000 € apo 3.40%.

Krahas rritjes së buxhetit prej vitit në vit, rritje të shpenzimeve vërehen pothuajse edhe në të gjitha kategoritë, me përjashtim të investimeve kapitale ku kemi një rënie prej 149,302,000 € apo 28% në raport me vitin e kaluar.

Sikurse edhe gjatë viteve të kaluara, shihet se shkalla më e ulët e ekzekutimit të buxhetit është tek investimet kapitale. Në vitin 2020 janë shpenzuar 384,471,000 € apo 53.40% e buxhetit, krahasuar me vitin e kaluar ku shkalla e ekzekutimit ishte 533,773,000 € apo 67.20%.

Në kategoritë tjera të shpenzimeve, kishte teprica buxhetore, të cilat për arsye të ndryshme nuk janë shfrytëzuar nga organizatat buxhetore. Si rrjedhojë, Mallrat dhe Shërbimet nuk janë shpenzuar për 47,237,000 € apo 14.4%

e buxhetit, shpenzime komunale 2,605,000 apo 10.5%, pagat dhe shtesat mbi 4,439,000 € apo 0.67% e buxhetit, si dhe subvencionet dhe transferet mbi 55,221,000 € apo 6% e buxhetit.

Të dhënat e prezantuara në RFV-të e BRK-së janë reflektim i pranimeve dhe pagesave reale dhe ndarjeve buxhetore përkatëse. Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2020 i është nënshtruar rishikimit dhe vendimeve të Qeverisë për ndryshime buxhetore dhe si rezultat, kishte lëvizje buxhetore brenda kategorive ekonomike në kuadër të OB-ve.

Tabela 7 - në vijim prezanton një pasqyrë të pagesave të përgjithshme krahasuar me dy vitet e fundit:
(‘000 në €)

Përshkrimi	Realizimi 2020	Buxheti final (SIMFK)	Buxheti fillestar	Realizimi 2019	Realizimi 2018
Paga dhe Shtesat	661,343	665,782	619,204	616,921	592,587
Mallrat dhe Shërbimet	280,007	327,244	326,424	273,313	229,057
Shërbimet Komunale	22,168	24,773	30,545	24,866	23,441
Subvencionet dhe Transferet	868,480	923,701	632,753	627,959	558,779
Investime kapitale	384,471	720,416	671,808	533,773	533,066
Shpenzimet e interesit	27,505	30,000	32,000	23,450	18,718
Kthimi i kryegjësë-nënuazimit	88,208	153,000	144,873	51,182	22,023
Kthimi i depozitave	2,761	0,00	0,00	1,082	1,890
Rezervat	0,00	1,896	44,127		0
Gjithsej	2,334,943	2,846,812	2,501,734	2,152,546	1,979,559

4.2.4 Realizimi i shpenzimeve buxhetore (struktura e shpenzimeve)

Siç është prezantuar në tabelën më lartë, gjithsej pagesat e realizuara për vitin 2020 janë 2,334,943,000 €. Krahasuar me vitin 2019, pagesat janë rritur për 182,397,000 € apo 8.5%.

Pagat dhe Shtesat - Në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore marrin pjesë me 30% dhe prezanton kategoritë me përqindjen më të lartë të shpenzimeve²¹. Buxheti për vitin 2020 ishte 665,782,000 €, ndërsa shpenzimet në fund të vitit ishin në vlerë prej 661,343,000 € apo mbi 99% e buxhetit. Shpenzimet për Pagat dhe Shtesat janë rritur për 44,422,000 € apo 7.2% në krahasim me vitin 2019. Kjo për shkak të zbatimit të vendimit të Qeverisë për rritjen e pagave për disa sektorë qeveritar si në shëndetësi, polici dhe OB-të tjera për menaxhimin e pandemisë Covid-19.

Me rastin e testimit të pagave, respektivisht vijueshmërisë në punë të të punësuarve, është identifikuar se 211 punonjës të sistemuar në shtatë ministri, janë paguar gjatë tërë vitit në një shumë totale prej 1,014,005 €, pa vijuar fare në punë. Pagesat si të tilla trajtohen pagesa të parregullta. Ky staf ishte shpërndarë nëpër këto ministri si rezultat i Marrëveshjes së Brukselit të vitit 2016, në mes Kosovës dhe Serbisë, por që futja e tyre në listën e pagave ishte bërë para se të krijoheshin kushtet normale për punë.

Ky problem është i pranishëm për vite me radhë dhe ne kemi dhënë rekomandime për këtë çështje, por i njëjti nuk është adresuar as në vitin 2020. Çështja ka mbetur e pa zgjidhur dhe po përcillet nga viti në vit.

²¹ Në përlllogaritjen e përqindjes si pjesëmarrjes në totalin e shpenzimeve për kategori ekonomike janë përjashtuar pagesat për kryegjësë, nënuazimet, interesin dhe kthimin e depozitave

Të dhënat në detaje për këto pagesa mund t'i shihni në tabelën në vazhdim:

Tabela 8 - Pagesat e kryera sipas Marrëveshjes së Brukselit

Nr.	Organizata Buxhetore	Numri i stafit të paguar	Pagesat gjatë vitit 2020
1	MEA	52	264,995
2	MI	32	162,555
3	MKRS	30	158,989
4	MTI	25	122,738
5	MKK	20	103,562
6	MASHT	32	100,583
7	MPB	20	100,583
	Gjithsej	211	1,014,005

Mangësitë apo parregullsitë e identifikuar ndhe të prezantuara në raportet individuale të auditimit në kategorinë e Pagave dhe Shtesave janë:

- Pagesa e zyrtarëve të komunitetit serb, ish pjesëtarë të "Mbrotjtjes Civile", në mungesë të evidencave për vajtje-ardhje në punë;
- Ushtrimi i pozitave të punës në mos përputhje me gradat e fituara;
- Dobësi në menaxhimin e personelit;
- Mangësi në mbajtjen e evidencave të kujdestarive dhe vijueshmërisë në punë;
- Kompensimi i komisioneve të brendshme me rastin e angazhimit për punë shtesë në kundërshtim me kërkesat ligjore;
- Kompensimi i parregullt i pagave;
- Pagesa e pagave me koeficient më të ulët së sa në Akt Emërime;
- Angazhimi për shërbime të veçanta, pa kryer procedurat ligjore; dhe
- Pagesa e zyrtarëve të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave, në mungesë të informatave për dosjen e tyre.

Mallrat dhe Shërbimet – Në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore marrin pjesë me 12.6%. Buxheti për Mallra dhe Shërbime ishte 327,244,000 €, përderisa janë shpenzuar 280,007,000 € apo 86% e buxhetit. Rritja e shpenzimeve në këtë kategori në krahasim me vitin e kaluar ishte për 6,694,000 € apo mbi 2.45%. Kjo rritje kishte reflektuar më shumë në furnizimet mjekësore, shërbimet kontraktuese tjera dhe pagesa me vendime të gjykatave.

Shpenzimet e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit, mëditjet, akomodimi dhe të tjera për vitin 2020 ishin 3,281,000 €, kurse në vitin 2019 ishin 11,912,000 €; shpenzimet e karburanteve për vetura ishin 6,613,000 €, ndërsa në vitin 2019 ishin 8,522,000 €; si dhe shpenzimet për dreka zyrtare ishin 1,985,000 €, në vitin 2019 ishin 3,773,000 €.

Zërat kryesor në këtë kategori, të cilat përfshijnë pjesën më të madhe me 164,046,000 € apo 59% e totalit, janë: shërbimet kontraktuese tjera me 58,277,000 €, furnizime mjekësore me 56,983,000 €, pagesa me vendime të gjykatave me 12,227,000 €, furnizim me ushqim dhe pije me 11,060,000 €, qiraja për ndërtesa me 10,271,000 €, mirëmbajtja e auto-rrugëve 8,916,000 €, si dhe blerja e librave dhe veprave artistike me 6,312,000 €.

Mangësitë apo parregullsitë e identifikuar nga raportet individuale të auditimit në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve janë:

- Mosinformimi i KRPP-së për refuzimin e tenderit me çmim jo normalisht të ulët;
- Pranimi i shërbimeve pa procedura të prokurimit
- Tejkalimi i vlerës së kontratave kornizë;
- Blerja e oksigjenit pa procedura të prokurimit;
- Vonesa në njoftim për nënshkrimin e kontratës;
- Ndarja e tenderëve përmes përdorimit të procedurave minimale;
- Mosemërimi i menaxherëve të kontratave;
- Tejkalimi i limiteve bankare dhe vonesa në raportimin e shpenzimeve nga Misionet Diplomatike të Kosovës;
- Mosmbyllja e avanceve brenda afateve kohore;
- Dobësi në procedimin e pagesave;
- Parregullësi në menaxhimin e shpenzimeve dhe të kontratave publike;
- Mangësi në zhvillimin e procedurës së prokurimit;
- Vonesa në zotimin, lëshimin e urdhërblereve dhe pamjaftueshmëria e mjeteve financiare;
- Mos-respektimi i hapave për procedimin e pagesave sipas Rregullave Financiare;
- Shpërblimi me kontratë pa i plotësuar kërkesat administrative të dosjes së tenderëve;
- Sigurimi i ekzekutimit të kontratës jo i plotë;
- Vonesa në njoftimin për nënshkrim të kontratës;
- Pagesa për shërbime të telefonisë mobile bazuar në kontratën me afat të skaduar;
- Pranimi i barnave pa komision;
- Tejkalimi i pozicioneve të peshuara të kontratës dhe parregullsi në pagesë;
- Çertifikim për pagesë për lëndë jo të kompletuara; dhe
- Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve dhe regjistrimi jo adekuat në kode ekonomike.

Subvencionet dhe Transferet - Në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme marrin pjesë me rreth 39.20%, si kategoria me përqindjen më të lartë të shpenzimeve. Buxheti për vitin 2020 ishte 923,701,000 €, kurse shpenzimet ishin 868,480,000 € apo 94% e buxhetit. Rritja e shpenzimeve në këtë kategori në krahasim me vitin e kaluar ishte për 240,521,000 € apo 38%. Kjo rritje ka reflektuar në këto kode ekonomike: pagesat për përfituesit individual; subvencionimi për entitete publike dhe jo publike; pensionet bazë; pagesa për personat me nevoja të veçanta dhe pagesat për kultura bujqësore.

Zërat kryesor që kanë karakterizuar këtë kategori me vlerë 731,441,000 € apo 84.2% të totalit të shpenzimeve janë: pensionet bazë me 165,777,000 €; pensionet bazë kontributdhënës 129,310,000 €; subvencionet për entitete publike 97,063,000 €; pagesat për përfituesit individual 97,659,000 €; subvencionet për entitete jo publike 94,561,000 €; pensionet për veteranët e luftës 76,793,000 €; pensionet - kategoria e I-rë 43,271,000 € dhe pagesat për kulturat bujqësore 27,007,000 €.

Pagesat për menaxhimin e pandemisë Covid-19, në total ishin 285,547,016 €. Prej tyre, pakoja emergjente ishte 168,037,902 €, ndërsa pakoja për Rimëkëmbje Ekonomike ishte 117,509,114 €. Shpenzimet e pandemisë do të trajtohen në një paragraf të veçantë.

Mangësitë apo parregullsitë e identifikuar nga raportet individuale të auditimit në kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve janë:

- Vlerësimi i mangët i aplikacioneve për mbështetje financiare nga komisionet e vlerësimit;
- Subvencionimi i dyfishtë i OJQ-ve për të njëjtin projekt;
- Mangësi në menaxhimin e subvencioneve;
- Mos arsyetimi i mjeteve për trajtimet mjekësore të subvencionuara;
- Përfitimi i pensioneve pas vdekjes;
- Përfitimi i pensioneve nga përfituesit që realizojnë të ardhura edhe nga burimet tjera;
- Parregullësi në menaxhimin e subvencioneve për Federatat Sportive;
- Vonesa në arsyetimin dhe raportin e shpenzimeve për subvencione;
- Mangësi në hartimin e programit pagesa direkte në sektorin e Bujqësisë;
- Mos përgatitja e planit vjetor për mbështetje financiare/subvencionim;
- Thirrja publike, vlerësimi, mos respektimi i kriterëve dhe monitorimi i subvencioneve në kundërshtim me rregulloren nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve;
- Subvencionimi i projekteve në mungesë të propozim-buxhetit të detajuar;
- Mungesa e planit vjetor për financimin publik të OJQ-ve; dhe
- Mungesa e dëshmive për arsyetimin e shpenzimeve nga përfituesit.

Investimet Kapitale - Në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme marrin pjesë me rreth 17.35%. Fondet buxhetore për Investime Kapitale janë të destinuar për financimin e projekteve në infrastrukturë, ndërtimin e autoudhëve, rrugëve lokale, në fushën e arsimit, shëndetësisë, objekteve kulturore dhe sportive, si dhe shërbimeve tjera publike.

Menaxhimi i projekteve kapitale bëhet përmes Programit për Investime Publike (PIP). Planifikimi i projekteve në PIP duhet të bëhet në mënyrë të detajuar dhe të aprovet nga krerët e organizatave, bazuar në analizat dhe arsyeshmërinë e tyre. Në anën tjetër, MF-ja aprovon këto kërkesa të OB-ve duke u bazuar në dokumentet e paraqitura në PIP në lidhje me arsyeshmërinë dhe duke siguruar se janë në përgjegjësi dhe kompetencë të tyre.

Buxheti final për këtë kategori ishte 720,416,000 €, ndërsa shpenzimet deri në fund të vitit ishin 384,471,000 € apo 53% e shumës së buxhetit final. Krahasuar me vitin e kaluar, vërehet një performancë më e ulët e shpenzimeve, e cila në vitin 2019 ishte 533,773,000 € apo 67.2% e buxhetit.

Gjatë përgatitjes së buxhetit vjetor, vërehet një tendencë e vazhdueshme e Qeverisë që shpenzimet buxhetore në kategorinë e investimeve të rriten nga viti në vit, për arsye se investimet kapitale ndikojnë direkt në rritjen ekonomike kombëtare. Por, për shkak të efekteve të pandemisë Covid-19, procedurave të stërzgjatura të prokurimit, ankesave të operatorëve në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) dhe çështjeve të pazgjadhura pronësore, shkalla e ekzekutimit të buxhetit në këtë kategori vazhdon të mbetet më e ultë për vite me radhë.

Buxheti i investimeve kapitale për nivelin qendror ishte 492,092,391 €, ndërsa realizimi ishte 228,897,451 € apo 46.5%. Këtë nivel të ulët e ka ndikuar mosrealizimi i projekteve sipas klauzolës së investimeve, ku buxheti ishte 125,835,238 €, përderisa shpenzimi ishte vetëm 25,655,267 € apo 20.40%. Ndikim kishte edhe realizimi i dobët i projekteve me financim nga huamarrja, ku vlera e planifikuar ishte 27,273,537 €, ndërsa realizimi ishte 11,451,746 € apo 42%. Ky realizim i ulët vërehet te këto organizata buxhetore: Ministria e Financave Punës dhe Transfereve me 6%, Kuvendi i Republikës së Kosovës me 18.50%, Ministria e Shëndetësisë me

33%, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me 38%, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me 41%, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me 43%, si dhe Ministria e Infrastrukturës me 55%.

Buxheti i Investimeve Kapitale për nivelin lokal ishte 228,323,822 €, ndërsa realizimi ishte 155,573,333 € apo 68%. Kjo shkallë e ulët e realizimit të buxhetit vërehet te burimi i financimit- të hyrat vetanake, ku buxheti ishte 91,678,213 €, ndërsa realizimi 42,477,314 apo 46.3%. Kjo vërehet tek Komuna e Prishtinës me 33%, Mitrovica Veriore me 33%, Kllokoti me 49%, Komuna e Fushë Kosovës me 50%, si dhe Komuna e Ranillugut me 53%.

Financimi i projekteve kapitale nga huamarrja

Buxheti total për vitin 2020 për financimin e projekteve kapitale nga huamarrja, ishte 153,108,775 €, kurse shpenzimi 37,107,013 € apo 24.2%. Fondet buxhetore për investime kapitale janë të destinuara për financimin e projekteve në infrastrukturë, rehabilitimin e rrugëve, mbështetjen e projekteve nga programi për rimëkëmbje ekonomike, uji dhe hedhurinat, infrastrukturë publike dhe shëndetësi.

Në vijim shpallim projektet për të cilat nuk ka pasur performancë të mirë buxhetore:

- Ministria e Shëndetësisë - Programi i Administratës Qendrore, buxheti ishte në vlerë prej 31,600,000 €, kurse realizimi 8,720,000 € apo 27.6%;
- Ministria e Infrastrukturës - projekti 'Rehabilitimi i rrugëve rajonale', buxheti i ndarë për vitin 2020 ishte 24,500,000 €, kurse realizimi ishte 2,172,952 € apo 8.90% ;
- Ministria e Infrastrukturës - projekti 'Rehabilitimi i linjës hekurudhore Fushë Kosovë- Hani Elezit', buxheti i ndarë për vitin 2020 ishte 12,630,000 €, kurse realizimi ishte 3,108,925 € apo 24.6%;
- Programi për Rimëkëmbje Ekonomike - ishin buxhetuar fonde në vlerë prej 16,890,000 € për vitin 2020, ndërkaq nuk kishte realizim fare;
- Ministria e Infrastrukturës - projekti 'Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrugës magjistrale M9 Prishtinë-Pejë', buxheti i ndarë për 2020 ishte 17,000,000 €, ndërsa nuk kishte realizim;
- Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit - Programi Uji dhe Hedhurinat', buxheti i ndarë për vitin 2020 ishte në vlerë prej 10,250,000 €, po ashtu nuk kishte realizim (projektet 'Impianti për ujëra të zeza në komunat e Prishtinës dhe Ferizajit', 'Kanalizimet fekale në gjashtë fshatra të Deçanit', 'Ujëmbledhësi për ujë të pijes në fshatin Verboc – Drenas' dhe projekti 'Ndërtimi i gypave të azbestit- çimentos në qytetin e Gjakovës'.

Sfidat me të cilat janë ballafaquar OB-të me rastin e realizimit të projekteve janë: problemet me shpronësimet te projektet e infrastrukturës, ndarjeve buxhetore të pa harmonizuara me dinamikën e projektit, paqartësi me procedurat e prokurimit, konsolidimi i njëjësive zbatuese të projekteve janë ballafaquar me vështirësi në procesin e rekrutimit dhe mbajtjes së stafit, futjes në buxhet të disa projekteve për të cilat kreditë nuk ishin ratifikuar marrëveshjet në Kuvend si dhe efektet që ka shkaktuar pandemia Covid-19. Për rrjedhojë në disa projekte situata pandemike ka ndikuar në ndërprerjen e punimeve, kurse në raste tjera ka shkaktuar vonesa administrative.

Sipas Rregullores nr.03/2017 për plotësim ndryshimin e Rregullores nr. 01/2016 për Administrimin e Fondeve nga Huamarrja, nenit 10 A- Raportimi Organizatave Buxhetore Zbatuese, Zyrtarët Kryesor Administrativ të OB-ve zbatuese kërkohet të raportojnë në Thesar mbi nivelin e ekzekutimit të projekteve me financim nga huamarrja ndërkombëtare, jo më vonë se data pesë e muajit pasues, nga secili tremujor.

Në vijim janë paraqitur OB-të të cilat nuk kishin raportuar në pajtueshmëri me kërkesat e rregullores:

- Projekti për Autostradën Kijevë–Zahaq, vlera e projektit 71,000,000 € dhe Projekti i Rrugës 6 nga Kijeva në Pejë 80,000,000 € (Organizata Buxhetore implementuese Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës);
- Ndërtimi i Sistemit të Ujësjellësit në Ferizaj, vlera e projektit 5,130,000 € (OB implementuese komuna e Ferizajt);
- Projekti për Trajtimin e Ujërave të Zeza në Prishtinë, vlera e projektit 66,000,000 € (OB implementuese Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit);
- Modernizimi i Sistemit të Edukimit në Kosovë përmes e-Edukimit, vlera e projektit 4,930,000 € (OB Implementuese Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit); dhe
- Zbatimi i Masave të Efiçencës së Energjisë në Ndërtesat Publike në MEA dhe tri komuna, vlera e projektit 2,500,000 € (OB implementuese janë komunat: Prishtina, Gjakova, Gjilani).

Mangësitë apo parregullsitë e identifikuara nga raportet individuale të auditimit në kategorinë e Investimeve Kapitale janë:

- Mos realizimi i projekteve brenda afatit kohor/planeve dinamike;
- Klasifikimi i gabuar i shpenzimeve;
- Dobësi në menaxhimin e bashkëfinancimeve nga ministria;
- Përdorimi i procedurës së negociuar pa publikim dhe shpallja e tenderit për projekt kapital në kundërshtim me Ligjin e Buxhetit;
- Mos respektimi i kushteve të kontratave me rastin e ekzekutimit të pagesave;
- Mos respektimi i afateve kohore për procedura të prokurimit, hapja dhe përmbyllja e procesit të vlerësimit të ofertave;
- Përzgjedhja e fituesve të tenderëve, në mungesë të plotësimit të kriterëve të vendosura në dosjen e tenderit.
- Mos nënshkrimi i kontratës me kohë dhe mosporositja e pajisjes;
- Nënshkrimi i kontratës me fituesin e tenderit, në mungesë të vërtetimit të ATK-së dhe Gjykatës;
- Lidhja e kontratave në mungesë të zotimit të mjaftueshëm;
- Ndryshimet në sasi të paramasës së kontraktuar për kontratat për punë, jo përmes departamentit të prokurimit dhe në mungesë të aprovimit të Zyrtarit Kryesor Administrativ (ZKA) dhe projektuesit;
- Vazhdimi i kryerjes së punëve/projekteve, përtej afatit të kontratës dhe në mungesë të aprovimeve për zgjatje të ekzekutimit të kontratës, si dhe mungesa e programeve të kryerjes së punimeve;
- Tejkalimi i pozicioneve të caktuara;
- Periudha jo valide e garancionit dhe nënshkrimi i paautorizuar i raportit pranues;
- Ndarja jo e duhur e detyrave në procesin e prokurimit;
- Mungesa e projekteve ekzekutive të ndërtimit;
- Tejkalimi i sasive të kontraktuara;
- Vonesa në procesin e vlerësimit të procedurave të prokurimit;
- Dobësi në realizimin dhe menaxhimin e kontratave;
- Mungesa e garancionit për punët e realizuara/përfunduara;

- Nënshkrimi i kontratave përtej vlerës së parashikuar të buxhetit;
- Investime publike në parcelat e pashpronësuar;
- Zhvillimi i procedurave të prokurimit jashtë planit të prokurimit dhe pa njoftim paraprak të AQP-së;
- Paradhënia (pagesa në avans) jo në pajtim me ligjin e buxhetit;
- Mungesa e projekteve ekzekutive me rastin e lëshimit të dosjes së tenderit;
- Specifikimi teknik jo i qartë;
- Pranimi i punëve/furnizimeve të porealizuara apo jo sipas kontratës; dhe
- Përzgjedhja e përfituesve pa kritere formale.

Pagesat tjera

Sipas buxhetit final, ndarjet buxhetore për këtë kategori ishin parashikuar në vlerë prej 183,000,000 €. Gjatë vitit janë kryer këto lloje pagesash: pagesat për kthimin e borxhit, nënhuazimeve dhe shpenzimet e interesit me vlerë totale prej 115,713,000 € apo 63.20% dhe pagesa nga fondi kthimi i depozitave prej 2,761,000 €.

Keqklasifikimi i shpenzimeve

Gjatë vitit, në 47 OB janë identifikuar keqklasifikime të shpenzimeve në një shumë totale prej 17,808,180 €. Prej tyre, 5,866,165 € apo 33% te 35 organizata të nivelit Qendror dhe 11,942,015 € apo 67% te 12 OB të nivelit lokal.

Tabela në vijim tregon keqklasifikimin e bërë nëpër kategori ekonomike. Kategoria më e ndikuar nga keqklasifikimi është kategoria e Investimeve Kapitale me 9,122,056 € apo 52% në raport me keqklasifikimin në tërësi, pastaj kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve me 7,914,799 € apo 44% dhe kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve me 766,975 € apo 4%.

Tabela 9 - Keqklasifikimi për kategori ekonomike

(në €)

Kategoria e gabuar	Kategoria e duhur	E ndikuar nga OB	E planifikuar gabimisht	Me vendime gjyqësore	Gjithsej
Pagat dhe mëditjet	Subvencionet dhe transferet	0	4,350	0	4,350
Gjithsej Pagat dhe mëditjet		0	4,350	0	4,350
Mallrat dhe shërbimet	Pagat dhe mëditjet	149,482	70,753	5,230,222	5,450,457
	Subvencionet dhe transferet	232,465	955,380	467,102	1,654,947
	Investimet kapitale	178,686	428,489	202,220	809,395
Gjithsej Mallrat dhe shërbimet		560,633	1,454,622	5,899,544	7,914,799
Subvencionet dhe transferet	Investimet kapitale	19,753	52,213	0	71,966
	Mallrat dhe shërbimet	5,603	687,646	0	693,249
	Pagat dhe mëditjet	1,760	0	0	1,760
Gjithsej Subvencionet dhe transferet		27,116	739,859	0	766,975
Investimet kapitale	Pagat dhe mëditjet	0	0	1,259,231	1,259,231
	Mallrat dhe shërbimet	321,556	6,358,807	329,090	7,009,453
	Subvencionet dhe transferet	50,000	665,039	138,333	853,372
Gjithsej Investimet kapitale		371,556	7,023,846	1,726,654	9,122,056
Gjithsej keqklasifikimi për vitin 2020		959,305	9,222,677	7,626,198	17,808,180

Nga totali i pagesave nga kategoritë e gabuara prej 17,808,180 €, vlera më e madhe prej 9,122,056 € ishte nga kategoria e Investimeve Kapitale, këto ishin bërë për shpenzimet për Mallra dhe Shërbime, Ppaga dhe Mëditje dhe Subvencione.

Nga kategoria e gabuar prej Mallrave dhe Shërbimeve në vlerë prej 7,914,799 €, ishin paguar për Investime Kapitale, Paga dhe Mëditje dhe Subvencione dhe Transfere.

Nga kategoria e gabuar e Subvencioneve dhe Transfereve në vlerë prej 766,975 €, ishin paguar Investime Kapitale, Mallra dhe Shërbime dhe Paga dhe Mëditje.

Si dhe nga kategoria e gabuar e Pagave dhe Mëditjeve, 4,350 € ishin paguar për kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve.

Ndikimi në keqklasifikimin e shpenzimeve Nga tabela e mësipërme shihet se keqklasifikimi i shpenzimeve është i ndikuar nga planifikimi jo në kategorinë e duhur ekonomike, përmes procesit buxhetor, nga shpenzimet në kategori të gabuara nga vetë Organizata Buxhetore, si dhe shpenzimet janë keq klasifikuar si pasojë e pagesave të ekzekutuara nga Thesari për vendimet gjyqësore.

Nga ky aspekt pjesën më të madhe të keqklasifikimit e përbën planifikimi jo në kategorinë e duhur ekonomike në vlerë prej 9,222,677 € apo 52% e shpenzimeve të keq klasifikuara.

Vlera e keqklasifikimeve të ekzekutuara nga Thesari përmes vendimeve gjyqësore është 7,626,198 €, apo 43% e shpenzimeve të keq klasifikuara. Prej tyre 6,489,453 € janë pagesa për paga jubilarë.

Vlera 959,305 € apo 5% e shpenzimeve të keq klasifikuara ishin nga shpenzimet e bëra nëpër kategori të ndryshme ekonomike nga vetë Organizatat Buxhetore, përkundër që planifikimi buxhetor ishte në rregull.

Nëse analizohen keqklasifikimet nga aspekti i mbi/nëndeklarimit nëpër kategori ekonomike atëherë kemi si në vijim:

Tabela 10 - Mbi/nënvlerësimi i kategorive ekonomike (në €)

Kategoria ekonomike	Paga dhe Mëditje	Mallra dhe Shërbime	Subvencione dhe transfere	Investimet Kapitale
Mbivlerësimi	4,350	7,914,799	766,975	9,122,056
Nënvlerësimi	(6,711,448)	(7,702,702)	(2,512,669)	(881,361)
Mbi/nënvlerësimi	(6,707,098)	212,097	(1,745,695)	8,240,696

Sa i përket kategorive ekonomike të cilat janë mbivlerësuar apo nënvlerësuar kur këto zbriten (thyhen) mes vete, atëherë sipas tabelës kemi se: kategoria më e mbivlerësuar është ajo e Investimeve Kapitale me 8,240,696 €, pastaj kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve me 212,097 €, ndërsa kategoria ekonomike më e nënvlerësuar është ajo e Pagave dhe Mëditjeve me 6,707,098 € dhe kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve me 1,745,695 €.

Në Tabelë janë identifikuar 10 Organizata Buxhetore ku kryesisht nga kategoria e investimeve kapitale dhe e mallrave dhe shërbimeve kanë paguar shpenzime që i përkasin kategorive të ndryshme.

Tabela 11 - Keqklasifikimet me planifikim të buxhetit dhe vendime gjyqësore

Entiteti	Kategoria e Gabuar	Kategoria e Duhur	Vlera financiare	Natyra e shpenzimit
----------	--------------------	-------------------	------------------	---------------------

Komuna e Prishtinës	Investime Kapitale	Mallra dhe shërbime	3,520,117 €	Pagesat për mirëmbajtjen e sipërfaqeve publike, deratizimin e podrumëve, dezinfektimin hapësinor, organizimin e festivaleve të ndryshme kulturore, etj.
Ministria e Infrastrukturës	Investime Kapitale	Mallra dhe shërbime	1,527,692 €	Pagesa për mirëmbajtjen e rrugëve
Shërbimi Spitalor Universitar i Kosovës	Mallra dhe shërbime	Paga dhe mëditje	809,439 €	Pagesat për kompensimin e pagave jubilarë, pagave përcjellëse dhe shpenzimeve tjera të procedurave gjyqësore.
Komuna e Vushtrrisë	Mallra dhe shërbime	Paga dhe mëditje	717,648 €	Pagesat për kompensimin e pagave jubilarë, pagave përcjellëse, shujtave dhe shpenzimet tjera të procedurave gjyqësore.
Ministria e Shëndetësisë	Mallra dhe shërbime	Subvencione dhe transfere	580,000 €	Pagesa në bazë të Vendimit të Qeverisë për shtesat e punëtorëve të kontraktorëve në Institucione Shëndetësore të cilët i plotësojnë kushtet e rrezikshmërisë.
Komuna e Mitrovicës	Mallra dhe shërbime	Paga dhe mëditje	425,033 €	Pagesat për pagat jubilarë bazuar në Vendime Gjyqësore.
Komuna e Skënderajt	Mallra dhe shërbime	Paga dhe Mëditje	406,973 €	Pagesat për kompensimin pagave jubilarë, pagave përcjellëse, shujtave dhe shpenzimet tjera të procedurave gjyqësore.
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	Investime Kapitale	Mallra dhe shërbime	393,952 €	Pages për furnizime me paisje sportive, dhe pako për mirëmbajtjen e shkollave.
Ministria e Financave	Mallra dhe shërbime	Subvencione dhe transfere	378,624 €	Pagesat në bazë të Vendime Gjyqësore, për kompensimi dëmit të fermerëve (grurë dhe misër) i shkaktuar nga vërshimet.
Komuna e Fushë Kosovës	Mallra dhe shërbime	Paga dhe mëditje	269,377 €	Pagesat për kompensimin e pagave jubilarë, pagave përcjellëse dhe shpenzimet tjera të procedurave gjyqësore.

Qeveria, sipas procesit të rregullt buxhetor, i kishte dorëzuar Komisionit për Buxhet dhe Financa Projektligjin e Buxhetit për vitin 2019, dhe ky Komision më pas i kishte dorëzuar Kuvendit këtë projektligj për miratim me një numër të madh amendamentesh të Komisioneve parlamentare, grupeve parlamentare dhe deputetëve, të cilat në masë të madhe edhe ishin aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në ligjin përfundimtar. Kjo edhe kishte ndikuar që shumë nga këto shpenzime të planifikuara me ndarje buxhetore, të mos klasifikohen drejtë.

Rekomandimet për Qeverinë

- Të siguroj se janë krijuar të gjitha kushtet që stafi i punësuar në bazë të Marrëveshjes së Brukselit të vijoj normalisht procesin e punës. Punonjësit të cilët nuk kryejnë asnjë detyrë pune në interes të punëdhënësit, nuk duhet të kompensohen; dhe

- T'i shqyrtoj raportet periodike të MFPT-së për borxhet publike dhe të analizojë ngecjet e identifikuar. Gjithashtu, në baza periodike të analizoj kushtet dhe kriteret për përzgjedhjen e projekteve për financim, buxhetim dhe monitorimin e shfrytëzimit të fondeve të huamarrjes, si dhe të shqyrtoj vonesat eventuale në tërheqjen e këtyre fondeve.

Rekomandimet për Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve

- Me rastin e përgatitjes së buxhetit fillestar të sqarojë të gjithë zërat buxhetor në mënyrë që bartja e të dhënave nga Tabela 1 në Pasqyra Financiare të jetë e qartë, konsistente dhe e drejtë;
- Të sigurojë që planifikimi i projekteve kapitale i nënshtrohet një analize të kapaciteteve të organizatës për menaxhimin e projekteve në përputhje me planet fillestare. Kontrollat në planifikimin e projekteve dhe realizimin e buxhetit duhet të forcohen me qëllim të realizimit të projekteve me kohë dhe arritjes së objektivave. Një harmonizim i rrjedhës së parasë me planifikimin e projekteve është i domosdoshëm për të adresuar nivelet e ulëta të realizimit financiar të projekteve kapitale; dhe
- Në koordinim me Ministrat të instalojnë mekanizma mbikëqyrës për të siguruar zbatimin e projekteve dhe raportimin në MFPT konform kërkesave ligjore në lidhje me ecurinë e realizimit të projekteve me financim nga huamarrja.

4.2 Pasqyra e pasurive në para të gatshme dhe bilanceve të fondeve

Bilanci i parasë së gatshme në fund të vitit, përfshinë shumat e pashpenzuara të fondeve nga paratë në llogarinë kryesore, fondi zhvillimor i mirëbesimit, paraja e gatshme në transit, kuota në IFN, llogaritë e Ambasadave të RK-së, paratë e gatshme (arka), si dhe avancet e hapura.

Këto fonde në para të gatshme ndahen në fonde të pashpërndara që ishin në vlerë 235,530,000 € (rezerva bankare) dhe fonde të destinuar për qëllime specifike që ishin në vlerë 94,425,000 €.

Fondet për qëllime specifike përbëhen nga: grantet e përcaktuara të donatorëve, të hyrat vetanake të bartura, fondi në mirëbesim për zhvillim, të hyrat e dedikuara, fonde tjera (kryesisht lloje të ndryshme të depozitave) dhe fondet e pashpenzuara nga huamarrja gjatë vitit 2020 dhe të bartura në vitin 2021.

Qeveria i menaxhon fondet përmes përdorimit të Llogarisë së Vetme të Thesarit (LIVTh). Pjesa më madhe e llogarive mbahen në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK). Shuma totale e parasë së gatshme në llogarinë e buxhetit të Republikës së Kosovës më 31 dhjetor 2020 ishte 329,955,000 €. Në vazhdim paraqiten të dhënat në detaje.

Tabela 12 - Pasqyra e parasë së gatshme dhe bilanci i fondeve (*000 në €)

Llogaritë bankare të Buxhetit shtetëror	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018
Banka Qendrore e Kosovës	316,897	444,301	374,663
Kuotat në Institucionet Financiare Ndërkombëtare	1,741	1,741	1,741
Fondi Zhvillimor i Mirëbesimit	1,971	4,754	4,514
Paraja në transit	4,851	4,632	4,031
Para në llogaritë e Misioneve Diplomatike	1,751	1,135	1,074
Para të gatshme (arka)	2,744	1,687	1,851
Gjithsej: pasuritë financiare në para të gatshme	329,955	458,251	387,874
Bilanci i fondeve	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018

Grantet e përcaktuara të donatorëve	9,752	8,866	7,803
Të hyrat vetjake të bartura në NQ	1,765	5,741	3,932
Të hyrat vetjake të bartura në NL	55,994	49,477	44,308
Fondi Zhvillimor në Mirëbesim	7,078	6,837	7,514
Të hyrat e dedikuara	52	803	1,706
Të hyrat tjera	15,894	17,504	16,432
Fondet e pashpenzuara nga huamarrja	3,891	7,000	0
Fonde për qëllime specifike	94,425	96,227	81,695
Të pashpërndara	235,530	362,023	306,179
Gjithsej: bilanci i fondeve	329,955	458,251	387,874

Bilanci i llogarive rrjedhëse të mbajtura në BQK është zvogëluar në krahasim me dy vitet paraprake. Paraja e gatshme në fund të vitit 2020 është zvogëluar për 128,296 € apo 28% në krahasim me bilancin e vitit 2019. Ky zvogëlim është rezultat i financimit të shpenzimeve dhe pagesave të rregullta buxhetore.

Nga tabela më lart shihet se bartja e të hyrave vetanake si të hyra të pashpenzuara ndër vite, saldo e tyre po rritet nga viti në vit. Fondet e bartura nga të hyrat vetanake në vitin 2020 janë rritur për 2,541,000 € apo 4.6% në krahasim me shumatat e bartura nga viti 2019.

Me rastin e rishikimeve tona analitike të Pasqyrave të Konsoliduara të pasurive financiare dhe bilanceve të fondeve, ne nuk kemi gjetur ndonjë mospërputhje në mes të të dhënave të prezantuara në pasqyrën e mësipërme me të dhënat në Librin e Përgjithshëm të Thesarit. Paraja e gatshme që gjendet në Llogarinë Kryesore të Buxhetit të Republikës së Kosovës në fund të vitit 2020 ishte 316,897,000 € apo 96% e bilancit të fondeve.

5. Analiza e shënimeve shpjeguese

Qeveria dhe OB-të kanë nën kontroll dhe menaxhojnë me fonde publike, si dhe i përdorin këto burime për të arritur objektivat e realizimit të shërbimeve. Megjithatë, Qeveria do të duhej të mbajë evidenca dhe të ketë informata të hollësishme lidhur me fondet publike të cilat i menaxhon.

Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik inkurajon fuqimisht që të përmbahen shpalosjet e informatave shtesë, aty ku është e mundur, në mënyrë që të ngritet transparencja dhe përgjegjësia financiare. Shpalosja e informatave të përshtatshme në PFV-të në lidhje me aktivitetet e përgjithshme të Qeverisë, mund të rrisë transparencën e raporteve financiare dhe të ofroj mundësi për kuptimin më të mirë të relacionit ndërmjet aktiviteteve qeveritare dhe palëve të interesit.

Përmbajtja e shpalosjeve apo shtojcave në PFV-të duhet të jetë e qartë dhe të ofroj informacion të mjaftueshëm dhe cilësor për të gjithë zërat e pasqyrave, në mënyrë që shfrytëzuesit e PFV-ve t'i kuptojnë më mirë fushat e raportuara, përkatësisht trendet vjetore të buxhetit dhe arsyet për ndryshime.

Përgjithësisht, PFV-të përmbajnë shpalosje të shumta, të cilat ofrojnë informacione të hollësishme për përmbajtjen e shifrave në tri pasqyrat kryesore. Por, konkluzioni ynë është se nuk është i mjaftueshëm vetëm prezantimi në mënyrë analitike i shifrave në këto tri pasqyra. Krahasuar me RFV-në 2019, shënimet shpjeguese në RFV-në 2020 janë më të plota, megjithëse në disa elemente ende ka nevojë të zgjerohen shpjegimet përkatëse, veçanërisht në pjesët ku ndryshimet janë të vështira të kuptohen nga ana e përdoruesve.

5.1 Baza e përgatitjes, politikat kontabël dhe raportimi

Ministria e Financave, në emër të Qeverisë përgatitë Pasqyrat Financiare Vjetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës në pajtim me LMFPP nr.03/L-048, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr.04/L-116, Ligjin nr.04/L-194, Ligjin nr.05/L-063 dhe Ligjin nr.05/L-007, si dhe në bazë të SNKSP-ve Raportimi Financiar sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza e kontabilitetit dhe raportimit të Qeverisë është LMFPP-ja dhe SNKSP-të, sipas parimit të parasë së gatshme. Në këtë bazë, informatat e prezantuara në këto pasqyra financiare paraqesin pranimet dhe pagesat e parasë së gatshme dhe lëvizjen e gjendjes së parasë.

Sipas parimit kontabël të parasë së gatshme, pranimet/të hyrat njihen atëherë kur paratë janë transferuar në llogari të Thesarit, janë pranuar në banka komerciale apo janë në pritje për t'u transferuar në llogarinë e Thesarit dhe paratë e grumbulluara nga zyrtarët e organizatave buxhetore në pritje për t'u transferuar në llogarinë e Thesarit në BQK.

Pagesat/shpenzimet njihen atëherë kur ato dalin nga Llogaria e Vetme e Thesarit, kurse shpenzimet e parave të imëta dhe avanseve për udhëtime zyrtare, njihen në momentin e mbylljes së llogarisë së parave të imëta dhe arsyetimit të shpenzimeve për udhëtimin zyrtar.

Menaxhimi i parasë është organizuar në formën e Llogarisë së Vetme të Thesarit. Llogaria e Vetme e Thesarit është sistem i llogarive bankare që shfrytëzohen për mbledhjen e të hyrave dhe realizimin e shpenzimeve, të cilat i menaxhon dhe kontrollon Thesari në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

Thesari është i autorizuar që të ekzekutoj edhe pagesat e faturave dhe kërkesave për pagesë sipas nenit 39.2 të LMFPP-së dhe vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore sipas nenit 40 të LMFPP-së. Pagesat e tilla janë bërë

nga kategoritë e ndryshme nga fondet të cilat kanë qenë në dispozicion, gjegjësisht të lira për shlyerjen e obligimit konform kërkesave të LMFPP-së.

LMFPP-ja ka disa kërkesa shtesë për prezantimin e pasurive jo financiare dhe detyrimeve në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, në pajtim me Pjesën 2 të SNKSP-ve, në bazë të parasë së gatshme.

Pasuritë e prezantuara në shtojcën 7 janë bazuar në shënimet e SIMFK-së dhe përfshijnë pasuritë në vlerë mbi 1,000 € në pajtim me Rregulloren Financiare nr.02/2013. Lista e pasurive jo financiare është paraqitur në vlerën kontabël neto, pas zbatimit të normave të zhvlerësimit sipas kësaj rregulloreje.

Raporti përmban shpalosje të informatave edhe për llogari tjera, të cilat janë paraqitur në shtojcat: (8) Pasuritë me vlerë nën 1,000 €; (9) Stoqet; (10) Të arkëtueshmet; (11 dhe 12) Detyrimet; (16) të dhënat e punsimit, (17) Numri i të punësuarve jashtë listës së pagave; (18) Numri i të punësuarve me kontrata për shërbime të veçanta. Të gjitha këto shtojca janë konsoliduar nga pasqyrat individuale të organizatave buxhetore.

Transaksionet ndërmjet organizatave buxhetore, të quajtura “Transaksionet ndërdepartamentale” nuk janë konsoliduar në këto pasqyra financiare, me qëllim të ruajtjes së konsistencës së informatave të raportuara me pasqyrat financiare individuale të organizatave buxhetore. Shpenzimet janë kategorizuar sipas klasifikimit ekonomik dhe funksional të Ligjit të Buxhetit, i bazuar në Statistikat Financiare Qeveritare të FMN-së (SFQ) që janë verzion i SFQ-ve të vitit 2014, të bazuara në parandë e gatshme.

Pagesat e bëra nga palët e treta nuk konsiderohen pranime ose pagesa në para të gatshme, por janë përfitime të Qeverisë. Këto pagesa janë prezantuar si shënim i veçantë në shtojcën 4.1 në përputhje me SNKSP-të 2017, efektive nga 1 janari 2019.

Paraja e gatshme përbëhet nga fondet të cilat mbahen në Bankën Qendrore të Kosovës, bankat komerciale, si dhe paratë e gatshme në arkat e OB-ve dhe ekuivalentët e parasë së gatshme.

Pagesat e kthyera në BRK nga vitet paraprake në vitin aktual, evidentohen si të hyra të këtij viti. Valuta raportuese zyrtare në Kosovë është Euro (€), ndërsa të shpalosja e borxhit shtetëror, mund të jetë përdorur edhe valuta Të Drejtat Speciale të Tirazhit (DST) në shtojcën 21 dhe USD (dollarë amerikan) të pagesat e kuotave për anëtarësim në IFN, tek shtojca 22.

PFV-të autorizohen me datën e nënshkrimit të deklaratës nga Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit, pas aprovimit në Qeveri.

5.2 Konsolidimi i të dhënave nga Pasqyrat individuale me Pasqyrat e Qeverisë

Procesi i auditimit të organizatave buxhetore ka nxjerrë në pah një sërë mospërputhjesh ndërmjet pasqyrave individuale dhe konsolidimit të tyre në Pasqyrat financiare të Qeverisë. Kjo për shkak se disa prej OB-ve nuk kanë regjistruar dhe pasqyruar drejt disa zëra në pasqyrat e tyre financiare, të cilat janë kryesisht pjesë e shpalosjeve. Thesari ka bërë konsolidimin e të dhënave ashtu siç është raportuar nga organizatat individuale. Mospërputhjet në shifrat e konsoliduara, kanë të bëjnë me çështjet si më poshtë:

- Në pasqyrën e shpalosjeve, shtojca nr.7 në RFV-të e BRK-së për vitin 2020, pasuria kapitale mbi 1,000 € është prezantuar në vlerë prej 9,041,518,666 €, ndërsa sipas auditimeve, pasuria kapitale mbi 1,000 € ka rezultuar të jetë 8,943,588,684 €, me një mbivlersim prej 97,929,982 €. Kjo diferencë mbetet pas thyerjeve të saldove, për shkak se disa organizata kanë pasuri më shumë sesa i kanë paraqitur në pasqyra dhe të tjerat kanë prezantuar të dhëna të mangëta mbi gjendjen e pasurive;

- Në pasqyrën e shpalosjeve/shtojca nr.8 në RFV-të e BRK-së për vitin 2020, pasuria nën 1,000 € në pasqyrën e shpalosjeve është në vlerë 46,778,503 €, ndërsa sipas auditimeve individuale, vlera e pasurive është 44,927,697 €, me një mbivlerësim prej 1,850,806 €.
- Stoqet në pasqyrën e shpalosjeve në RFV të BRK-së ishin në vlerë 33,529,602 €, ndërsa sipas auditimeve individuale kjo vlerë rezulton 33,364,454 €, me një mbivlerësim prej 165,148 €.
- Obligimet e papaguara në nivel vendi, në pasqyrën e shpalosjeve/shtojca Nr.12 janë prezantuar në vlerë prej 331,418,958 €, kurse sipas raporteve individuale të auditimit vlera e obligimeve të papaguara ishte 362,982,078 €, ekziston një nënvlerësim i obligimeve prej 1,563,120 €;
- Gjendja e detyrimeve kontingjente në RFV-të e BRK-së është paraqitur në vlerë 211,972,679 €, ndërsa vlera e këtyre detyrimeve sipas auditimit ishte 217,358,083 €, apo me një nënvlerësim prej 5,385,4040 €; dhe
- Llogaritë e arkëtueshme ishin prezantuar në RFV-të e BRK-se janë paraqitur në vlerë prej 691,914,269 €, kurse sipas raporteve individuale të auditimit, vlera e këtyre llogarive ishte 692,228,120 €, e nenvlerësuar për 313,851 €.

5.3 Borxhet publike (të brendshme dhe të jashtme) dhe garancitë shtetërore, si dhe stoqet e borxhit shtetëror

Borxhet e përgjithshme shtetërore apo publike përbëhen nga Borxhet e Brendshme dhe Borxhet e Jashtme. Ndërsa, për nevoja të përlllogaritjes së borxhit të përgjithshëm kundrejt Bruto Produktit Vendor (BPV), në kategorinë e borxheve konsiderohen edhe Garancitë shtetërore. Si burim i financimit buxhetor, këto huamarrje merren me qëllim të mbulimit të deficiteve buxhetore dhe për nevoja të financimit të projekteve kapitale. Republika e Kosovës ka marrë borxhe të jashtme që nga viti 2009, ndërsa prej vitit 2012 huamarrja bëhet edhe nga burimet e brendshme.

Në fund të vitit 2020, Borxhi i Përgjithshëm ka arritur në vlerën 1,487,690,000 €, ku krahasuar me vitin paraprak ka një rritje prej 23.87%. Në këtë vlerë nuk janë të përfshira garancitë shtetërore prej 31,650,000 €. Kjo rritje është si rrjedhojë e disbursimeve prej 215,330,000 € gjatë vitit 2020 (prej të cilave 177,410,000 € janë për menaxhimin e pandemisë Covid-19) si dhe emetimet e reja të Letrave me Vlerë në kuadër të Borxhit të Brendshëm prej 169,950,000 €. Gjatë dy viteve të fundit treguesi i Borxhit në raport me BPV-në, ka pasur rritje, ku në fund të vitit 2019 ishte 17.51%, ndërsa në fund të vitit 2020 ishte 21.83%. Tabela në vazhdim paraqet trendin e borxhit gjatë tri viteve të fundit.

Tabela 13- Borxhi i brendshëm dhe i jashtëm shtetëror (në milionë €)

Përshkrimi	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018
Borxhi i Jashtëm	525.80	409.10	416.43
Borxhi i Brendshëm	961.90	791.94	676.62
Borxhi i Përgjithshëm	1,487.69	1,201.05	1,093.05
Garancitë Shtetërore	31.65	42.68	43.70
Borxhi i Përgjithshëm (% e BPV)	21.83	17.51	16.90

BPV nga ASK ²²	6,961.00	7,103.76	6,725.91
---------------------------	----------	----------	----------

MF-ja për vitin 2020 ka respektuar në tërësi limitin e lejuar ligjor për marrjen e Borxheve Publike, ku në këtë vit Borxhi Publik në raport me BPV-në ishte 21.83%. Sipas Ligji për Borxhet Publike është përcaktuar që në asnjë rast shuma e kryegjësë e papaguar e Borxhit të Përgjithshëm nuk duhet të tejkalojë dyzet për qind (40%) të BPV-së.

Të dhënat në tabelë tregojnë se pjesa më e madhe e borxheve (64.66%) janë nga huamarrja e brendshme, ndërsa borxhet e jashtme marrin pjesë me një përqindje më të ultë (35.34%). Siç shihet, në raport me vitin e kaluar, borxhi i jashtëm është rritur rreth 117,000,000 €, ndërkaq borxhet e brendshme kanë pasur një rritje prej më shumë se 170,000,000 € nga emetimet e reja të letrave me vlerë.

Garancitë shtetërore, paraqesin detyrime të mundshme dhe ato bëhen borxhe faktike vetëm në rastet kur subjekti publik, dështon të paguaj obligimet kontraktuese të garantuara. Në këto raste, Qeveria duhet të paguaj obligimet për garancionin e dhënë. Nga tabela shihet se Qeveria ka dhënë garancione për 31,650,000 € (Garancia për Trafikun Urban Prishtinë prej 7,650,000 € dhe Garancia për Linjën e Dytë Kreditore për Fondin e Sigurimit të Depozitave në Kosovë prej 24,000,000 €).

Borxhet e Jashtme

Në kuadër të Borxhit të Jashtëm në vitin 2020 janë disbursuar fonde në total prej 215,330,000 €. Shumat më të larta janë disbursuar nga kreditorët e Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim (ANZh) në vlerë 76,120,000 €, nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) në vlerë 51,960,000 €, nga Bashkimi Evropian (BE) në vlerë 50,000,000 €, kurse pjesa tjetër prej 37,250,000 € është tërhequr nga Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZhKE), UniCredit dhe Banka Islame për Zhvillim (BIZh). Borxhi i Jashtëm në fund të vitit 2020 arrinë shumën prej 525,800,000 €. Borxhi i Jashtëm ka shënuar rritje për 117,000,000 € apo 28.52% në raport me vitin 2019 dhe paraqet 35% të totalit të Borxhit Shtetëror dhe 7.55% të BPV-së.

Pjesa më e madhe apo rreth 70% e portofolit të Borxhit Ndërkombëtar është ndaj ANZh-së, Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (BNRZh) dhe FMN-së.

Tabela 14 - Borxhi i Jashtëm shtetëror (në milionë €)

Vitet	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018
Borxhi i jashtëm	525.80	409.10	416.43
Qeveria Qendrore	479.50	359.45	364.53
Borxhi i nënhuazuar	46.29	49.65	51.90
Borxhi i jashtëm (% e BPV-së)	7.55%	5.76	6.27
BPV	6,961.00	7,103.76	6,725.91

Gjatë vitit 2020 janë ratifikuar shtatë kredi/marrëveshje financiare në mes Qeverisë së Kosovës dhe kreditorëve, si dhe një marrëveshje për të cilën nuk aplikohet ratifikimi (tri të nënshkruara në vitin 2019 dhe katër në vitin 2020). Marrëveshjet financiare të nënshkruara janë si në vijim:

²² Borxhi i jashtëm ndryshon nëpër vite edhe si rrjedhojë e ndryshimit të kursit valutor. Vlerat e BPV-së për 2018-2019 janë marrë nga faqja zyrtare e internetit të Agjencionit të Statistikave të Kosovës, ndërsa, për vitin 2020 është marrë nga Ligji i Buxhetit 2020. Kalkulimi i treguesit të Borxhit të Përgjithshëm përfshinë edhe Garancitë Shtetërore.

- Dy marrëveshje me Bankën Botërore – ANZh;
- Një marrëveshje me BERZh;
- Një marrëveshje me FMN;
- Një marrëveshje me BZhKE;
- Një marrëveshje me BE; dhe
- Një marrëveshje me BEI.

Kontraktimi i marrëveshjeve të reja financiare është realizuar me qëllim të financimit të projekteve në sektorin e infrastrukturës ujore, për menaxhimin e pandemisë Covid-19 dhe mbështetje direkte buxhetore. Në vijim janë paraqitur marrëveshjet dhe qëllimi i tyre:

1. Përmes marrëveshjes financiare për kredi në mes Republikës së Kosovës dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, është miratuar Instrumenti i Financimit të Menjëhershëm për Republikën e Kosovës, në shumën totale prej 51.96 milionë € për të përkrahur nevojën e bilancit të pagesave që përfshinë mbështetjen për buxhetin e shtetit;

2. Marrëveshja financiare me ANZh-në për kredinë ‘Projekti Emergjent Covid-19’ për Kosovën, ka për qëllim parandalimin, detektimin dhe reagimin ndaj kërcënimit të paraqitur nga pandemia Covid-19, dhe forcimit të sistemeve kombëtare për përgatitjen e shëndetit publik në vend;

3. Marrëveshja financiare me BE-në për kredinë ‘Ndihma Makro-Financiare për Kosovën’, ka për qëllim të lehtësojë kufizimet e financimit të jashtëm të Kosovës, të lehtësojë bilancin e saj të pagesave dhe nevojave buxhetore, të forcojë pozicionin e saj të rezervës valutore dhe të ndihmojë atë të adresojë dobësitë aktuale të jashtme dhe ato financiare. Kjo ndihmë nga BE-ja është plotësuese për burimet që i janë dhënë Kosovës nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatorët dypalësh, në mbështetje të autoriteteve, programit të stabilizimit ekonomik dhe të reformave;

4. Marrëveshja financiare me BZhKE-në për kredinë ‘Instrumenti për Financim të Sektorit Publik për Reagim Emergjent ndaj Covid-19’, ka për qëllim të ndihmojë Republikën e Kosovës në përpjekjet e saj për të siguruar shërbime mjekësore për ata që preken nga virusi Covid-19 dhe të ndihmojë në menaxhimin e pandemisë;

5. Marrëveshja financiare me Bashkësinë Evropiane për Investime për kredinë ‘Impianti për Trajtimin e Ujërave të Zeza në Gjilan’, ka për qëllim asgjësimin e të gjithë ujërave të zeza, të gjeneruara në zonën urbane të Komunës së Gjilanit dhe fshatrave përreth, si dhe të trajtojnë këto ujëra të ndotura sipas standardeve të përcaktuara në Direktivën e Trajtimin të Ujërave të Ndotura Urbane 91/271/EEC;

6. Marrëveshja financiare me BERZh-in për kredinë ‘Kredia për Likuiditet të Urgjencës së Infrastrukturës Vitale’, ka për qëllim të ndihmojë Kosovën në sigurimin e fondeve të likuiditetit emergjent për ofruesit e infrastrukturës vitale të prekur nga kriza pandemike Covid-19; dhe

7. Marrëveshja financiare me ANZh-në për kredinë ‘Nxitja dhe Levimi i Mundësive për Sigurinë e Ujit’, ka për qëllim forcimin e themeleve kombëtare për menaxhimin e sigurisë së ujit dhe përmirësimin e sigurimit të ujit në pellgun Morava e Binçës.

Tabela 15 - Borxhi i Jashtëm sipas kreditorëve

(në milionë €)

Kreditori	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018
BNRZh	124.31	135.64	146.98
ANZh	132.20	60.53	49.51

FMN	111.44	132.60	160.14
UniCredit Austria	20.91	13.26	7.04
KfW	36.41	42.79	48.91
BIZh	14.27	8.83	3.32
FSZh	1.23	2.08	0.25
FOZhN	0.57	1.24	0.00
BERZh	6.32	4.11	0.28
BEI	7.00	7.00	0.00
RBI Austria	3.35	1.03	0.00
BE	50.00	0.00	0.00
BZhKE	17.78	0.00	0.00
Gjithsej Borxhi i Jashtëm	525.80	409.10	416.43

Borxhet e Brendshme

Republika e Kosovës ka filluar emetimin e Letrave me Vlerë nga janari i vitit 2012. Zhvillimi i tregut ka rezultuar të jetë mjaft i suksesshëm në aspektin e interesimit të investitorëve dhe kostos së huamarrjes, me ç'rast ky lloj i huamarrjes ka kontribuar si katalizatori kryesor në financimin e deficitit buxhetor.

Borxhi i Brendshëm është krijuar përmes shitjes së letrave me vlerë nga ana e Qeverisë në formë të bonove të Thesarit (deri 1 vit) dhe obligacioneve (2 deri 10 vite).

Në vitin 2020, borxhi i brendshëm është 961,900,000 €, që paraqet rreth 65% të Borxhit Shtetëror, apo 14% e BPV-së. Rritjet relative të Borxhit të Brendshëm në vitet e fundit: në vitin 2020 rritja për 21%, në vitin 2019 rritja 17% dhe në vitin 2018 rritja për 18%.

Gjatë vitit 2020, është arritur marrëveshje me Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës për emetimin e Obligacionit përmes plasimit direkt me vendosje private, në shumën prej 50,000,000 € dhe me maturitet 10 vjeçar, kjo për qëllim të menaxhimit të pandemisë Covid-19.

Tabela 16 – Borxhi i brendshëm në tri vitet e fundit (në milionë €)

Borxhi i Brendshëm (neto)	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018
Emetimet e Reja	169.95	115.32	102.43
Stoku i Borxhit të Brendshëm	961.90	791.94	676.62
Garancitë shtetërore	31.65	42.68	43.70
Borxhi i Brendshëm (% e BPV-së)	14.27	11.75%	10.60%
BPV	6,961.00	7,103.76	6,725.91

Mbajtësit e Letrave me Vlerë

Sipas Rregullores MF-BQK-së nr.01/2014 për Tregun Primar dhe Sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përveç Akterëve Primar dhe Participantëve Primar edhe personat e tjerë fizik dhe juridik kanë të drejtë të blejnë Letra me Vlerë në Tregun Primar si dhe atë Sekondar të Letrave me Vlerë të

Qeverisë së Kosovës. Si rezultat, përveç bankave komerciale që janë Akterë Primar si dhe Trustit Pensional si Participant Primar, Letra me Vlerë mbajnë edhe investitorë të tjerë fizik dhe juridik (biznese dhe individ privat). Në vijim kemi paraqitur në tabelë gjendjen sipas mbajtësve të Letrave me Vlerë për vitet 2016-2020.

Tabela 17 - Mbajtësit e Letrave me Vlerë (vlerë nominale) (në milionë €)

Instrumenti	2020	2019	2018
Bankat Komerciale	272.48	281.21	257.25
Fondet Pensionale	450.12	298.56	210.12
Institucionet Publike	198.86	181.02	185.98
Kompanitë e Sigurimeve	33.8	26.40	22.92
Të tjerë	10.01	8.06	3.55
Gjithsej	965.27	795.25	679.82

Shërbimi i Borxheve të Brendshme dhe të Jashtme

Në vitin 2020, shërbimet e Borxhit të Jashtëm dhe të Brendshëm ishin 116,000,000 €. Prej tyre, për Borxhin e Jashtëm së bashku me interesin ishte 99,000,000 € (rreth 67.94% e shumës së paguar është ndaj FMN-së, rreth 16.94% është shërbim i borxhit ndaj BNRZh-së dhe 15.13% ndaj kreditorëve të tjerë). Ndërsa, për Borxhin e Brendshëm ishte paguar interes rreth 17,000,000 €.

Tabela në vazhdim prezanton të dhënat për kthimin e borxheve dhe interesit të jashtëm, si dhe interesit të brendshëm, duke përfshirë kthimin e kryegjësë, shpenzimeve të interesit, tarifave zotuese dhe tarifave tjera si pjesë e borxhit.

Tabela 18 - Shërbimet e Borxhit të Jashtëm dhe të Brendshëm për vitin 2020 (në milionë €)

Kthimi i borxheve	Kryegjësja	Interesi i paguar	Tarifat zotuese	Tarifat tjera	Gjithsej pagesat
Borxhi i Jashtëm	88,207	9,835	811	260	99,113
Borxhi i Brendshëm	-	16,599	-	-	16,599
Gjithsej	88,207	26,434	811	260	115,712

Garancitë shtetërore

Për qëllime të përlogaritjes së Borxhit të Përgjithshëm dhe për të përcaktuar kufirin e borxhit të tillë, Garancitë Shtetërore dhe Komunale trajtohen si borxh. Në fund të vitit 2020, vlera e garancive të dhëna shtetërore ishte 31,650,000 € (garancia për trafikun urban Prishtinë prej 7,650,000 € dhe Garancia për Linjën e Dytë Kreditore për FSDK-në prej 24,000,000 €).

Bazuar në shtojcën 21 të PFV-ve të BRK-së shpalojta për borxhin shtetëror, vërejmë që prej marrëveshjeve të ratifikuara, në 5 projekte me vlerë 229,500,000 € nuk janë tërhequr fare mjetet financiare. Fondet e pashpenzuara kanë të bëjnë me projektet e pa realizuara si në vijim:

- Projekti i rrugës 6 nga Kijeva në Pejë në vlerë 80,000,000 €, ku zbatuese e projektit ishte Ministria e Infrastrukturës, viti i ratifikimit të marrëveshjes është 2018;

- Projekti për Autostradën Kijev - Zahaq në vlerë 71,000,000 €, zbatuese e projektit ishte Ministria e Infrastrukturës, viti i ratifikimit të marrëveshjes është 2018;
- Projekti trajtimi i ujërave të zeza në Prishtinë në vlerë 66,000,000 €, viti i ratifikimit të marrëveshjes është 2017;
- Projekti i Zhvillimit të Ujërave të Zeza në Gjilan në vlerë 10,000,000 €, viti i ratifikimit të marrëveshjes është 2020; dhe
- Projekti për Masat e Energjisë Efiçiente në komunat: Prishtinë, Gjakovë dhe Gjilan, në vlerë 2,500,000 €, viti i ratifikimit të marrëveshjes është 2016.

Kjo kishte ndodhur për shkak të planifikimit jo të mirë të projekteve të cilat do të financoheshin nga huamarrjet, vonesat në themelimin e njërive zbatuese të projekteve, procedurat e ndryshme të prokurimit nga ato të parapara me marrëveshje të kredive, etj.

Si rezultat i kësaj, Qeveria e Kosovës është duke paguar tarifë të zotimit për vlerën e mjeteve të zotuara të cilat nuk i ka tërhequr. Kjo si pasojë e mospërputhjes së dinamikës kohore në mes alokimit të kredive dhe realizimit të projekteve, vlera e paguar e tarifave të zotimit për mjetet e kredive të pa tërhequra nga huamarrësit është 811,255 €, për të gjitha kreditë e ratifikuara dhe të pa disbursuara deri në vitin 2020.

Rekomandimi për Qeverinë

Qeveria duhet që t'i shqyrtoj në baza të rregullta raportet vjetore të MFPT-së për borxhet publike dhe t'i përdor ato në diskutimet gjithëpërfshirëse kur vlerëson nevojat për huamarrje, rezultatet dhe pengesat në proces. Po ashtu, duhet të forcoj menaxhimin dhe kontrollet lidhur me shfrytëzimin efikas dhe efektiv të këtyre fondeve.

Rekomandimet për Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve

- Në bashkëpunim me Qeverinë dhe subjektet përfituese të fondeve duhet të sigurohet që para fillimit të negociimit të marrëveshjeve për huamarrje për projekte të caktuara, janë përmbushur të gjitha kushtet që sigurojnë zbatimin e plotë dhe efikas të tyre;
- Bazuar në raportet tremujore të Thesarit, MFPT-ja në bashkëpunim me ministrinë e linjës duhet t'i adresoj të gjitha sfidat e identifikuara, në zbatimin e projekteve që financohen nga huamarrjet. Në çfarëdo kohe dhe në të gjitha rastet kur vlerësohet e nevojshme, MFPT-ja duhet t'i sugjeroj Qeverisë masat e duhura për tejkalimin e këtyre sfidave; dhe
- Të ofroj udhëzime të qarta për organizatat buxhetore për përfshirjen e planeve të investimeve kapitale që do të financohen nga huamarrjet. Miratimi i projekteve duhet të bëhet vetëm nëse ato kanë kryer të gjitha përgatitjet dhe ofrojnë siguri të mjaftueshme dhe të dokumentuar se realizimi i këtyre projekteve do të bëhet në kohën dhe mënyrën e duhur.

6. Pasuritë

Rregullorja MF nr. 02/2013 mbi Menaxhimin e Pasurive në Organizata Buxhetore i obligon të gjitha organizatat të mbajnë regjistrat e pasurisë jo financiare që vazhdimisht të bëjnë ripërtëritjen ose azhurnimin e tyre, varësisht nga blerjet/përvetësimet e reja apo shqyrtimit sistematik të gjendjes së tyre të përdorimit.

Pasuritë e organizatave buxhetore, si tërësi ndahen në:

- Pasuri kapitale që kanë afat të përdorimit më të gjatë se një vit dhe që kanë vlerë financiare mbi 1,000 €;
- Pasuritë jo kapitale që kanë afat të përdorimit më shumë se një vit, por që kanë vlerë financiare më pak se 1,000 €; dhe
- Stoqet ose pajisjet rezervë dhe materiali për zyre.

Pasuritë pasuritë jofinanciare kapitale dhe jo kapitale

Menaxhimi i pasurive bëhet përmes dy sistemeve të centralizuara: Regjistrit kontabël të SIMFK, si sistem i integruar në kuadër të MF-së, ku evidentohen, mirëmbahen, vlerësohen dhe raportohen pasuritë që kanë vlerë mbi 1,000 €, si dhe aplikacionit “E - pasuria” që është një sistem i integruar i menaxhimit të pasurisë në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike tani në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ku të gjitha institucionet publike duhet të evidentojnë dhe raportojnë për pasuritë e tyre me vlera nën 1,000 €.

Organizatave buxhetore kanë raportuar vlera të ndryshme të pasurive në PFV-të individuale, shifra të cilat më pas janë konsoliduar në PFV-të e MF-së. Me rastin e auditimit të pasqyrave individuale, janë vërejtur mospërputhje në mes shifrave të raportuara dhe vlerave të audituara.

Gjetjet kryesore lidhur me raportimin dhe kontrollin e pasurive janë si vijim:

Institucionet Qendrore

Nga auditimet individuale, ka rezultuar se disa organizata nuk i kanë përfshirë në regjistrat e tyre një pjesë të pasurisë dhe si rezultat i kësaj, vlera neto e prezantuar në RFV-të e BRK-së ishte mbivlerësuar për pasuritë mbi 1000 € për 120,731,103 €, ndërsa për pasuritë nën 1000 € për 253,370 €.

Tabela 19 - Gjendja e pasurive në institucionet qendrore.

Pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale	Vlera e pasurisë e prezantuar në RFV-BRK nga MF-ja	Sipas Auditimeve	Mbivlerësimi/n ënvlerësimi
Pasuritë kapitale (mbi 1,000 €)	2,936,378,386 ⁱ	2,815,647,283	120,731,103
Pasuritë jo kapitale (nën 1,000 €)	27,736,714	27,483,344	253,370

Gabimet e identifikuar apo mospërputhjet e gjendjes së pasurive të raportuara më pak apo më shumë, janë identifikuar në tetëmbëdhjetë (18) organizata të nivelit qendror, ku bëjnë pjesë: 13 ministri, Zyra e Kryeministrit, Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar, Universiteti Prishtinës dhe tri agjenci të pavarura.

Dobësi tjera në kontrolle dhe menaxhimin e pasurive të cilat më së shpeshti janë hasur gjatë auditimit të tek **Institucionet Qendrore** janë:

- Në 10 institucione nuk është kryer harmonizimi i të dhënave në mes raportit vjetor të inventarizimit dhe regjistrimit të përgjithshëm të pasurisë;
- Në 18 institucione nuk kishte funksionuar sistemi e-pasuria ose të gjitha pasuritë nën 1000 € nuk janë vendosur ose vendosur pjesërisht në sistemin e-pasuria;
- Në nëntë institucione nuk është kryer inventarizimi vjetor, inventarizimi ishte i pjesshëm apo procesi kishte përfunduar me vonesa në inventarizimin e pasurisë, respektivisht raportet e inventarizimit ishin dorëzuar pas hartimit të pasqyrave financiare.; dhe
- Dobësi tjera të cilat janë vërejtur në nivelin qendror, por në numër më të vogël janë mangësitë në regjistrimin e pasurisë në vijim si dhe mos formimi i komisioneve për vlerësimin e pasurisë.

Institucionet Lokale

Te niveli komunal janë konstatuar dobësi të theksuara sa i përket evidentimit dhe raportimit të pasurive. Pasuria kapitale sipas vlerës neto e prezantuar në RFV-të e BRK-së ishte nënvlerësuar për 22,801,119 €, ndërsa pasuria jo kapitale për 1,597,436 €.

Tabela 20 - Gjendja e pasurive në komuna

Pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale	Vlera e pasurisë e prezantuar në RFV-BRK	Sipas Auditimeve	Mbivlerësimi/nënvlerësimi
Pasuritë kapitale (mbi 1,000 €)	6,105,140,280	6,127,941,401	(22,801,119)
Pasuritë jo kapitale (nën 1,000 €)	19,041,789	17,444,353	1,597,436

Mangësitë dhe gabimet në mbajtjen dhe regjistrimin e pasurive janë identifikuar në shumicën e komunave. Nga gjithsej tridhjetë e tetë (38) komuna, njëzetë e tri (23) prej tyre kanë mbivlerësuar ose nënvlerësuar pasuritë e prezantuara në RFV-të e BRK-së.

Dobësi tjera në kontrollë dhe menaxhim të cilat më së shpeshti janë hasur gjatë auditimit të pasurive tek komunat janë:

- Komuna e Zubin Potokut dhe Leposaviqit nuk kanë raportuar pasuritë me vlerë mbi 1,000 €.
- Komunat e Ferizajt, Zveçanit, Kllokotit dhe Novobërdës nuk kanë raportuar pasuritë jo financiare nën 1.000 € ndërsa komunat e Istogut, Leposaviqit dhe Zubin Potokut, kanë raportuar pasurinë jo financiare nën 1,000 € me vlerën zero;
- Në 17 komuna, nuk ishte kryer harmonizimi i të dhënave në mes regjistrimit të përgjithshëm të pasurisë dhe raportit të inventarizimit;
- Në 30 komuna, nuk ka funksionuar sistemi e-pasuria ose të gjitha pasuritë nën 1000 nuk janë vendosur ose vendosur pjesërisht në sistemin e-pasuria;
- Në 14 komuna ka munguar inventarizimi i pasurisë ose është bërë inventarizim i pjesshëm; dhe
- Në tetë komuna, mungojnë politikat dhe procedurat e brendshme për menaxhimin e pasurisë.

Dobësi tjera të cilat janë vërejtur në nivelin lokal, por në numër më të vogël janë: mangësitë në regjistrimin e pasurisë në vijim, mos regjistrimi i pasurive ose blerjeve të reja dhe mos fshirja e pasurive të cilat komunat nuk i kishin në posedim.

Shtatë komuna, kanë raportuar pasurinë në RFV-të e BRK-së me vlerën zero ose nuk kanë raportuar fare. Kjo paraqet paqartësi lidhur me regjistrimin dhe përditësimin e pasurive.

Stoqet për Institucionet Qendrore dhe Lokale

Stoqet ose pajisjet rezervë dhe materialet për zyre te institucionet qendrore sipas RFV-ve të BRK-së janë 30,966,105 €, ndërsa sipas auditimeve individuale 31,125,159 €, me një nënvlerësim prej 159,054 €. Ndërsa stoqet në komuna sipas RFV-ve të BRK-së janë 2,563,497 €, ndërsa sipas auditimeve 2,239,295 € me një mbivlerësim prej 324,201 €.

Vlen të theksohet se në fund të vitit 2020, nëntë (9) komuna nuk kanë raportuar stoqe, ndërsa dy komuna kanë raportuar stoqet me vlerë zero.

Konkluzioni i auditimit

Shpalosjet mbi pasuritë jo financiare dhe kontrollet mbi menaxhimin e tyre në vitin 2020 nuk kanë ofruar siguri të mjaftueshme se organizatat buxhetore kanë kontrolle dhe monitorime të plota mbi pasuritë dhe menaxhimin e tyre në mënyrë efikase. Përveç kësaj, të dhënat e pasurive fikse në sistemin e menaxhimit të pasurive: SIMFK dhe E-pasuria, janë të pasakta dhe jo të plota në disa raste. Praktika të njëjta të menaxhimit të pasurive janë duke vazhduar edhe me tutje si të institucionet e nivelit qendror ashtu edhe ato lokal edhe pse vite më radhë janë dhënë rekomandime për përmirësimin e kësaj fushë, ndërsa institucionet e pavarura kanë bërë një progres në raport me vitet paraprake.

Rekomandimet për Qeverinë

Qeveria duhet të luaj një rol aktiv në adresimin e të gjitha çështjeve lidhur me menaxhimin e pasurive duke ndërtuar mekanizma llogaridhënës në mënyrë që:

- Të gjitha organizatat buxhetore t'i përmbushin detyrimet ligjore, duke i regjistruar dhe raportuar saktë të gjitha pasuritë jo financiare në posedim; dhe
- T'i analizoj shkaqet për mos-funksionalizimin e plotë të sistemit e-pasuria, si një problem i trashëguar për vite me radhë dhe të ndërmerr masa për funksionalizimin te tij.

Rekomandimet për Ministrinë e Financave, Punës dhe Tranfereve

- Përmes trajnimeve të fund vitit lidhur me hartimin e PFV-ve, të fuqizoj kërkesën që të gjitha organizatat buxhetore t'i themelojnë me kohë komisionet e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive dhe rezultatet e inventarizimit të reflektojnë në PFV-të e vitit fiskal; dhe
- Me rastin e pranimit të PFV-ve nga organizatat buxhetore, të vendos kontrolle formale, në veçanti lidhur me raportimin e pasurive jo financiare dhe stoqeve me gjendjen zero dhe në rastet e tilla të kërkoj sqarime, ngase në raportet e tri viteve të fundit kishte diferenca të theksuara.

7. Llogaritë e arkëtueshme

Gjendja e llogarive të arkëtueshme (LIA) raportohet kryesisht në mënyrë manuale dhe pastaj ato konsolidohen, si për hartimin e pasqyrave financiare individuale të organizatave buxhetore, ashtu edhe për ato të konsoliduara. Përderisa përbëjnë një zë tejet të rëndësishëm të pasurive afatshkurtëra, ato kërkojnë vëmendje të shtuar, si për qëllime të auditimit ashtu edhe përgjatë procesit të tërësishëm të buxhetit - aq më tepër kur një qasje e tillë e mbledhjes së informatave kontabël, lë hapësirë për gabime të mundshme në raportimin apo shpalosjen e tyre. Prandaj, gabimet e identifikuara gjatë auditimeve të fundit kanë qenë materiale.

Për vitin 2020, gjithsej vlera e deklaruar e LIA në Raportin Financiar Vjetor 2020, për nivelin qendror dhe lokal arrinë në 691,914,269 € (NQ 479,101,665 € dhe NL 212,812,603 €). Ndërsa, sipas auditimit vlera e llogarive të arkëtueshme është 692,228,120 € (NQ 478,591,988 € dhe NL 213,636,132 €). Pra, kemi një diferencë prej 313,851 € të nenvlerësuar (përfshirë nivelin qendror dhe lokal).

Kjo mos shpalosje e saktë është si pasojë e mungesës së një strukture formale për raportimin, mbikëqyrjen dhe konsolidimin e të dhënave si dhe për shkak të gabimeve pothuajse teknike gjatë bartjes së shënimeve nga PFV në RFV, me rastin e përgatitjes së pasqyrave të konsoliduara.

Në vitin 2020 LIA bazuar në RFV ishin rritur në shumë prej 54,410,356 € apo 8.5% (në vitin 2020 LIA janë 691,914,269 € dhe në vitin 2019 LIA ishin 637,503,913 €). Pra siç shihet është një trend i rritjes së LIA nga viti në vit.

Tabela 21 - Përmbledhja e llogarive të arkëtueshme²³

Llogaritë e arkëtueshme	Sipas auditimit 2020	Sipas PF të OB 2020	Sipas RFV 2020	Sipas RFV 2019	Sipas RFV 2018	Krahasoni 2020-2019
Niveli qendror	478,591,988	479,101,666	479,101,666	455,091,604	462,687,206	5.28%
Niveli lokal	213,636,132	212,812,603	212,812,603	182,412,309	170,279,395	16.67%
Gjithsej	692,228,120	691,914,269	691,914,269	637,503,913	632,966,601	8.5%

Llogaritë e Arkëtueshme të Nivelit Qendror

Vlera e listuar në RFV 2020 për nivelin qendror është 479,101,666 €, e cila gjatë auditimit ka rezultuar të jetë e mbivlerësuar për 509,677 €, meqë kjo shifër sipas auditimit do duhej të paraqitet në vlerë 478,591,988 €. Disa nga gabimet ishin kryesisht:

- LIA të Ministria e Infrastrukturës ishin mbivlerësuar për 444,409 €. Shkaku i mbivlerësimit ishin gabimet teknike gjatë raportimit të LIA;
- LIA të Ministria e Financave ishin mbivlerësuar për 42,769 €. Shkak i mbivlerësimit të tyre sipas auditimit ishte menaxhim jo efikas i LIA;
- LIA të Ministria e Shëndetësisë ishin mbivlerësuar për 22,150 €. Shkaku i mbivlerësimit të LIA ishte se vlera e tillë ishte përfshirë gabimisht në kuadër të LIA;

²³ Në vlerat e llogarive të arkëtueshme nuk janë përfshirë të dhënat për Agjencionin Kosovar për Inteligjencë dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit.

- LIA Këshilli Gjyqësor i Kosovës ishin mbivlerësuar për 15,000 €. Shkak i mbivlerësimit të tyre sipas auditimit ishte menaxhimi jo efikas i LIA;
- LIA te Ministria e Punëve të Brendshme ishin mbivlerësuar për 10,722 €; dhe LIA te Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ishin nënvlerësuar për 25,372 €. Sipas auditimit vlera e LIA është 26,372 €.

Rreth 87% e llogarive të arkëtueshme të nivelit qendror e përbëjnë të arkëtueshmet nga Ministria e Financave (shifra e auditur 417,423,635 €).

Krahasuar me vitin paraprak, LIA te niveli qendror karakterizohen me një trend në rritje të LIA për 5.28% (LIA e vitit 2020 janë 479,101,665 € dhe LIA e vitit 2019 janë 455,091,604 €).

Llogaritë e Arkëtueshme të Nivelit Lokal

Sipas raportit të konsoliduar financiar (RFV), bilanci i të arkëtueshmeve në 34 komuna²⁴ arrinë në 212,812,603 € ndërsa sipas auditimit vlera e LIA është 213,636,132 €. Auditimi ka nxjerrë në pah një nënvlerësim prej 823,529 € te niveli lokal. Kjo diferencë rrjedhë për shkak të pakujdesisë gjatë mbajtjes, raportimit të të dhënave si dhe për shkak të harmonizimit në mënyrë manuale të të dhënave. Kjo ka ndikuar që procesi i raportimit dhe monitorimit për LIA nga drejtoritë përkatëse komunale të përcillet me një cilësi jo të kënaqshme.

Ndryshimet për LIA janë vërejtur te komunat si në vijim:

Ndërsa në vijim i shpalosim komunat që kanë nënvlerësuar LIA (ndryshimet në mes RFV-ve të BRK-së dhe vlerat sipas auditimit):

- Komuna e Istogut LIA i kishte të nënvlerësuar për 1,250,922 €;
- Komuna e Kllokotit LIA i kishte të nënvlerësuar për 418,340 €. Shkaku i nënvlerësimit ishte se në PFV llogaritë e arkëtueshme të prezantuar nga zyra për menaxhimin e tatimit në pronë ishin nënvlerësuar dhe taksat për grumbullimin e mbeturinave nuk ishin paraqitur fare;
- Komuna e Skenderaj LIA i kishte të nënvlerësuar për 80,780 €. Shkaku i nënvlerësimit të LIA ishte se llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në parcela nuk ishin prezantuar fare në PVF. Sipas sistemit Protax vlera e tyre në fund vitin 2020 ishte 80,780 €;
- Komuna e Ferizajt LIA i kishte të nënvlerësuar për 82,265 €. Shkaku i nënvlerësimit ishte se LIA ishin nënvlerësuar për Leje ndërtimi dhe nga qiratë;
- Komuna e Kaçanikut LIA i kishte të nënvlerësuar për 45,966 €. Shkaku i nënvlerësimit ishte se komuna nuk kishte ofruar informacione mbi gjendjen e të arkëtueshmeve nga shfrytëzimi i pronës publike që ishin dërguar te përmbauesi në vlerë prej 45,966 €;
- Komuna e Parteshit LIA i kishte të nënvlerësuar për 40,314 €; dhe
- Komuna e Rahovencit LIA i kishte të nënvlerësuar për 15,824 €. Shkaku i nënvlerësimit ishte se llogaritë e arkëtueshme për tatimin në pronë ishin nënvlerësuar për 15,824 €.

Ndërsa në vijim i shpalosim komunat që kanë mbivlerësuar LIA:

²⁴ Mitrovica e Veriut, Komuna e Zveçanit, Komuna e Leposaviqit dhe Komuna e Zubin Potokut nuk kanë raportuar për llogaritë e arkëtueshme. Vlen të përmendet se tatimi në pronë buxhetohet vit pas viti për tu inkasuar nga këto komuna.

- Komuna e Novobërdës LIA i kishte të mbivlerësuara për 970,816 €. Shkaku i mbivlerësimit ishte kontrolli i pamjaftueshëm gjatë bartjes së të dhënave lidhur me llogaritë të arkëtueshme nga tatimi në pronë në PFV;
- Komuna e Mitrovicës LIA i kishte të mbivlerësuara për 91,488 €. Shkaku i mbivlerësimit ishte llogaritë e arkëtueshme nga taksat në biznes ishin mbivlerësuar, pasi që softveri me të cilin menaxhohen këto llogari nuk ishte funksional në vitin 2020 dhe për këtë nuk ishin faturuar fare bizneset; dhe
- Komuna e Vushtrrisë LIA i kishte të mbivlerësuara për 42,000 €.

Krahasuar me vitin paraprak, LIA te niveli lokal karakterizohet me një trend në rritje për 16.67% (në vitin 2020 ishin 212,812,603 €, ndërsa në vitin 2019 ishin 182,412,309 €).

Në llogari të arkëtueshme të nivelit lokal përfshihen në përgjithësi të arkëtueshmet nga tatimi në pronë, taksat në biznes, taksat për shërbimet e mbeturinave, qiratë dhe tjera. Kjo kategori dominohet nga ajo e tatimit në pronë në të cilat përfshihen ngarkesat aktuale si dhe kamatat e dënimit për mos kryerje të obligimeve të mëhershme.

Shuma e llogarive të arkëtueshme si te niveli qendror ashtu edhe te niveli lokal ka pasur rritje në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019. Po ashtu, dobësi të theksuara janë identifikuar lidhur me procesin e raportimit dhe konsolidimit të LIA tek të dyja nivelet. Kjo ka ndikuar që procesi i raportimit dhe monitorimit për LIA nga departamentet përkatëse që menaxhojnë me LIA të përcillet me një cilësi të dobët.

Rekomandimi për Kuvendin e Kosovës, Qeverinë dhe Ministrinë e Financave, Punës dhe Tranfereve

Në koordinim me organizatat buxhetore që krijojnë të hyra, duhet të analizojnë në hollësi strukturën e këtyre llogarive, vjetërsinë si dhe gjasat për t'i inkasuar këto borxhe të trashëguara për vite me radhë. Rrjedhimisht, të krijojnë mekanizma të duhur për mbledhjen e këtyre borxheve, si dhe të kujdesën për raportimin dhe konsolidimin e plotë dhe të saktë të llogarive të arkëtueshme si te niveli qendror po ashtu edhe në nivelin lokal.

8. Detyrimet e papaguara dhe ato kontingjente

Detyrimet e papaguara

Detyrimet e papaguara paraqesin faturat e pranuar për punët/shërbimet e përfunduara nga operatorët ekonomik, por të cilat nuk janë paguar. Për shkak të përdorimit të kontabilitetit në para të gatshme, gjendja e detyrimeve të papaguara vetëm mund të shpaloset në pasqyrat financiare. Rrjedhimisht, ato përpunohen në mënyrë manuale nga organizatat buxhetore dhe raportohen në baza mujore në MF, për konsolidim të mëtejshëm. Ligji i buxhetit dhe rregullativa sekondare për shpenzimin e parasë publike, kufizon hyrjen e OB-ve në detyrime, meqë obligohen që porosinë e mallit (urdhërblertjen) ta bëjnë vetëm kur ka mjete në dispozicion. Por një gjë e tillë nuk respektohet çdo herë.

Detyrimet totale të papaguara sipas auditimit janë 362,982,078 €, ndërsa në raportin e konsoliduar financiar, detyrimet totale të papaguara janë paraqitur në shumën 361,418.958 €, vlerë kjo që sipas auditimit është e nënvlerësuar për 1,563,120 €. Krahasuar me vitin paraprak (RFV-2020/RFV-2019), detyrimet janë rritur për 868,052 €.

Tabela 22 - Detyrimet e papaguara në tri vitet e fundit

Detyrimet e papaguara	Sipas auditimit 2020	Sipas RFV-BRK 2020	Sipas RFV-BRK 2019	Sipas RFV-BRK 2018	Krahasoni 2020 – 2019 (%)
Niveli qendror	328,502,151	327,003,733	337,202,119	226,643,000	(3)
Niveli lokal	34,479,927	34,385,225	23,348,787	32,149,000	47
Gjithsej	362,982,078	361,418,958	360,550,906	258,792,000	(0.24)

Detyrimet e papaguara të nivelit qendror

Mosbarazimet kanë ndodhur për shkak të cilësisë së dobët në mbledhjen, konsolidimin dhe raportimin e shënimeve, kryesisht në organizatat si në vijim:

- Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) kishte nënvlerësuar detyrimet për 5,266,109 €, të cilat i ka deklaruar më pak në PFV-të dhe rrjedhimisht këto mangësi/shënime janë bartur edhe në RFV-në;
- Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) kishte mbivlerësuar detyrimet për 1,897,916 €, të cilat i ka deklaruar më shumë në PF dhe rrjedhimisht këto mangësi/shënime janë bartur edhe në RFV-në; dhe
- Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA) kishte mbivlerësuar detyrimet për 1,604,564 €, të cilat i ka deklaruar më shumë në PFV-të dhe rrjedhimisht këto mangësi/shënime janë bartur edhe në RFV-në.

Detyrimet e papaguara të nivelit lokal

Gabimet në raportim, në nivelin lokal janë kryesisht nga Komuna e Ferizajit, ku kishte nënvlerësim për 98,400 € obligim në fund të vitit 2020 dhe rrjedhimisht këto mangësi/shënime janë bartur edhe në RFV-në.

Komunat me detyrimet më të larta janë ajo e Gjilanit me 11,012,843 € apo 31.93% të gjithsej borxheve të nivelit lokal, pastaj Prishtina me 6,790,497 € apo 19.69%, si dhe Ferizaji me 4,116,646 € apo 11.94%.

Shpalojet e pasakta të detyrimeve paraqesin një pasqyrë jo të drejtë të pozitës financiare të OB-ve dhe Qeverisë ku mund të rezultojnë me vendime joadekuate gjatë procesit të buxhetimit. Kontrollat e dobëta me rastin e harmonizimit të të dhënave rrezikojnë identifikimin, raportimin e saktë dhe të plotë të detyrimeve duke vënë në pikëpyetje edhe kredibilitetin e pasqyrave.

Rekomandimet për Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve dhe organizatat buxhetore

Me rastin e ndarjeve buxhetore duhet të kenë prioritet ndarjen e fondeve për pagesën e detyrimeve të papaguara në mënyrë që të mënjanohen shpenzimet shtesë të kamatave dhe shpenzimet tjera administrative. Përveç kësaj, rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet edhe raportimit dhe konsolidimit të tyre në mënyrë që të prezantojnë gjendjen e plotë dhe të saktë të tyre në RFV-të të BRK-së.

Detyrimet kontingjente

Në pjesën e detyrimeve, shpalojen edhe detyrimet kontingjente të cilat paraqesin pretendime të ndryshme nga ana e paditësve, që kanë gjasa në të ardhmen të krijojnë detyrime për organizatat, varësisht prej vendimeve të gjykatës të cilat mund të jenë në favor të palëve paditëse. Këto kanë të bëjnë me kompensime për shpronësime, kompensim të borxhit, dëmit material, pagave dhe implikacioneve tjera financiare në lidhje me to.

Në raportin e konsoliduar, detyrimet kontingjente për vitin 2020 janë gjithsej 211,936,702 € (Niveli qendror 131,085,961 €) dhe (Niveli lokal 80,850,741 €), ndërsa sipas auditimit detyrimet kontingjente do duhej të paraqiten në vlerë prej 217,358,083 €. Bazuar në këto analiza rezultojnë se detyrimet kontingjente ishin të nënvlerësuar për 5,421,381 €. Kjo kategori si e tillë është subjekt i gabimeve potenciale në shpaloje. Por, diferencat gjithashtu kanë të bëjnë edhe me disa gabime që janë lëshuar nga niveli qendror dhe niveli lokal gjatë konsolidimit të shënimeve. Është shqetësues trendi pozitiv i këtyre detyrimeve dhe njëkohësisht pakujdesia dhe mos përkushtimi i duhur në raportimin e tyre. Krahasuar me vitin paraprak (192,519,745 € viti 2019), detyrimet kontingjente, sipas rezultateve të auditimit janë më të larta për 19,416,957 € apo rreth 10.1%.

Tabela 23 - Përmbledhje e detyrimeve kontingjente²⁵

Detyrimet Kontingjente	Sipas Auditimit 2020	Sipas RFV 2020	Sipas RFV-së 2019	Sipas RFV-së 2018	Lëvizja nga viti 2019 (%)
Niveli qendror	126,206,006	131,085,961	118,509,510	91,032,560	10.64
Niveli lokal	91,152,077	80,850,741	74,010,235	75,514,104	11.27
Gjithsej	217,358,083	211,936,702	192,519,745	166,546,664	10.25

Detyrimet Kontingjente të Nivelit Qendror

Vlera e detyrimeve kontingjente të Nivelit Qendror ishte raportuar në RFV-në 2020 në shumë prej 131,085,961 €, ndërsa sipas auditimit, duhet të jetë 126,206,006 €. Pra, te Nivelit Qendror kemi një mbivlerësim per

²⁵ Të dhënat për Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe Agjencionin Kosovare për Inteligjencë nuk janë të përfshira në këtë kalkulim.

4,879,955 €. Arsya për këtë është cilësia e dobët në mbledhjen, konsolidimin dhe raportimin e shënimeve nga OB-të tek MF-ja. Disa nga gabimet ishin:

- Ministria e Infrastrukturës ka raportuar në RFV-të e saj 18,987,471 € detyrime kontingjente, ndërsa sipas auditimit detyrimet kontingjente janë 15,554,240 €. Pra, kemi një mbivlerësim të detyrimeve kontingjente prej 3,433,231 €. Kjo kishte rrjedhur si rezultat i gabimeve teknike të raportuara në PFV si dhe pakujdesisë në kontrollin e brendshëm;
- Ministria e Punëve të Brendshme ka raportuar në RFV-të e saj 6,918,708 € detyrime kontingjente, ndërsa sipas auditimit detyrimet kontingjente janë 5,687,918 €. Pra, kemi një mbivlerësim të detyrimeve kontingjente prej 1,230,790 €. Kjo kishte rrjedhur si rezultat i gabimeve teknike në raportim të detyrimeve dhe mungesës në kontrollin e brendshëm;
- Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve kishte mbivlerësuar detyrimet kontingjente për 256,357 €. Shkaku i këtij mbivlerësimi ishte se në PFV-të ishin të pasqyruara pasuritë kontingjente dhe jo shuma e detyrimeve kontingjente; dhe
- Ministria e Shëndetësisë kishte të mbivlerësuar detyrimet kontingjente për 235,341 €.

Detyrimet Kontingjente të Nivelit Lokal

Detyrimet kontingjente të Nivelit Lokal janë dukshëm më të vogla në krahasim me ato të Nivelit Qendror. Padi të ndaj komunave janë të natyrave të ndryshme, duke filluar nga pretendimet për pagat jubilarë e deri tek paditë për shpronësime. Për shkak të qasjes aspak të strukturuar dhe jo formale në harmonizimin e të dhënave, auditimi ka nxjerrë një mori gabimesh. Shuma e raportuar sipas RFV-të e detyrimeve kontingjente ishte 80,850,741 €, ndërsa shuma e detyrimeve kontingjente sipas auditimit është 91,152,077 €. Pra, shuma e detyrimeve kontingjente është nënvlerësuar për 10,301,336 €.

Në vijim i shpalosim disa nga ndryshimet më domethënëse:

- Komuna e Prizrenit i kishte nënvlerësuar detyrimet kontingjente për 8,600,028 €. Këto detyrime kontingjente nuk i kishte raportuar në RFV-në dhe as në PFV-të e vitit 2020. Kjo ka ndodhur për shkak të mos koordinimit ndërmjet departamentit ligjor dhe departamentit të financave;
- Komuna e Deçanit kishte nënvlerësuar detyrimet kontingjente në vlerë prej 1,476,450 €; dhe
- Komuna e Gjakovës kishte nënvlerësuar detyrimet kontingjente në vlerë prej 158,850 €. Kjo ka ndodhur si rezultat i mos krijimit të një regjistri të përgjithshëm i cili do të duhej të azhurnohej dhe mirëmbahej ndër vite nga zyra ligjore në komunë.

Shpalosja e jo saktë e detyrimeve kontingjente ka ndikuar që të mos pasqyrohet gjendja e drejtë dhe e plotë. Kjo mund të ndikoj që informacioni i shpalosur për këto detyrime të jetë qorientues për palët e interesit.

Rekomandimet për Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve

Në koordinimin me organizatat buxhetore dhe akterët tjerë relevant, duhet të siguroj vlerësimin e saktë të detyrimeve kontingjente në mënyrë që shpalosjet në RFV-të të jenë të sakta. Aty ku nuk janë bartur shënimet në RFV-të apo aty ku ekzistojnë mospërputhje të shënimeve, të identifikohen arsyet e këtyre gabimeve dhe të njëjtat të korrigjohen për vitin e ardhshëm.

9. Pagesat sipas nenit 39.2 të LMFPF


Në bazë të autorizimeve që jep LMFPF-ja, neni 39, paragrafi 2, Thesari i Kosovës gjatë vitit ka trajtuar kërkesat e operatorëve ekonomik për pagesa të faturave të vonuara (mbi 60 ditë) bazuar në këtë ligj, prej të cilave janë aprovuar dhe është bartë shpenzimi nga buxheti i organizatës buxhetore përkatëse për shlyerje të detyrimeve të krijuara.

Vlera e këtyre pagesave të ekzekutuara nga Thesari për vitin 2020 ishte 190,698 €. Krahasuar me vitin paraprak 2019, ku vlera e pagesave të ekzekutuara ishte 1,559,692 €, ka një rënie shumë të theksuar në vlerë prej 1,368,994 €. Kjo rënie është një indikator pozitiv që tregon se kontrollet në lidhje me neglizhencën dhe papërgjegjësinë e zyrtarëve përgjegjës në pagesën e faturave me kohë, mos planifikimin/mos pagesën e shpenzimeve për pagat jubilarë, sipas kontratës kolektive, që janë shkaktarët kryesorë për ekzekutimin e këtyre pagesave, janë në drejtim të përmirësimit.

Tabela 24 - Pagesat sipas nenit 39.2 të LMFPF-së sipas kategorive ekonomike, për tri vitet e fundit (në €)

Pagesat sipas kategorive	Totali 2020	Totali 2019	Totali 2018
Mallra dhe shërbime /komunalitë	67,283	52,066	1,673,869
Investime kapitale	123,415	1,507,626	7,010,331
Gjithsej	190,698	1,559,692	8,684,200

Shikuar nga pjesëmarrja e këtyre shpenzimeve sipas organizatave buxhetore, pjesën më të madhe e përbëjnë organizatat e nivelit lokal (komunat). Në vijim, janë pasqyruar shpenzimet sipas nenit 39.2 të LMFPF-së sipas organizatave buxhetore:



Bazuar në raportet e auditimit të OB-ve për vitin 2020, me rastin e rishikimit të procesit të këtyre pagesave, nuk kemi vërejtur parregullsi dhe se procedura për trajtimin e kërkesave të furnitorëve për obligimet e vonuara dhe të papaguara sipas nenit 39.2 të LMFPF-së është zbatuar me konsistencë nga Thesari.

Ndërkaq, nga aspekti i raportimit financiar, sipas raportit vjetor financiar të buxhetit të RKS-së, pagesat sipas nenit 39.2 janë prezantuar në vlerë 184,672 €, me një ndryshim prej 6,026 €, krahasuar me gjendjen reale të pagesave bazuar në shënimet e fundit të SIMFK-së. Ky ndryshim vjen si rezultat i mosparaqitjes së shpenzimeve të MSH-së në vlerë 9,195 € dhe paraqitjes së vlerës 3,170 € si shpenzim i Komunës së Istogut, edhe pse e njëjta pagesë ishte anuluar në fillim të vitit 2021.

Rekomandimet për Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve

Me rastin e përgatitjes së Raportit Financiar Vjetor të BRK-së, të sigurohet për saktësinë e vlerës së prezantuar të pagesave sipas nenit 39.2, duke u bazuar në shënimet e fundit të korigjuara në SIMFK dhe përmes krahasimit/harmonizimit me PFV-të individuale të OB-ve që kanë pasur shpenzime të tilla.

9.1 Pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore

Mbështetur në LMFPN-në, Neni 40, Pika 1, kur një gjykatë nxjerrë urdhër ose vendim me të cilin kërkohet nga një autoritet publik që të paguajë çfarëdo lloji të kompensimit monetar ndaj një personi dhe urdhri ose vendimi nuk i nënshtrohet të drejtës së ankesës nga autoriteti publik ose autoriteti publik nuk e ka ushtruar këtë të drejtë me kohë, gjykata menjëherë i dërgon një kopje të urdhrorit ose vendimit Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë përkatëse, për ekzekutimin e pagesës në fjalë.


Pagesat sipas vendimeve të gjykatave dhe vendimeve të përmbaruesve privat për vitin 2020 ishin në vlerë 29,965,312 €. Në raport me vitin 2019, vlera e këtyre pagesave është rritur për 4,131,074 € apo 16%, ndërsa në raport me vitin 2018, rritja është më e madhe për 9,705,237 € apo 48%. Përderisa shkaktarët e kësaj gjendje janë pothuajse të njëjtë me vitet paraprake, mund të themi se trajtimi i këtyre shkaqeve nga përgjegjësit nuk ishte në nivelin e duhur.

Tabela 25 - Pagesat me vendim të gjykatave dhe përmbarimeve për tri vitet e fundit (në €)

Pagesat sipas kategorive	Totali 2020	Totali 2019	Totali 2018
Paga dhe mëditje	73,976	819,679	303,522
Mallra dhe shërbime/Komunali	12,881,930	7,088,607	4,058,530
Subvencione dhe Transfere	259,151	603,395	590,977
Investime kapitale	16,750,254	17,322,557	15,307,046
Gjithsej:	29,965,312	25,834,238	20,260,075

Pagesat për organizata të nivelit qendrorë ishin 15,324,361 €, apo 51% e totalit, ndërsa pagesat në nivelin lokal ishin në vlerë prej 14,640,951 € apo 49% e totalit të vendimeve gjyqësore. Më poshtë, në mënyrë grafike, janë pasqyruar dhjetë (10) organizata buxhetore tek të cilat janë ekzekutuar pagesa në vlera më të mëdha, të cilat e përbëjnë mbi 70% të shumës së pagesave të kryera me vendime gjyqësore (mbi 21 milionë €).

Pagesa të kryera me vendime gjyqësore sipas OB-ve me vlerat më të larta



Moskryerja e detyrimeve me kohë nga ana e organizatave buxhetore, ka rezultuar me kosto shtesë për buxhetin e shtetit për shkak të kostove të procedurave gjyqësore (përmbartimore) dhe shpenzimeve të interesit. Këto kosto shtesë kanë dëmtuar buxhetet e këtyre OB-ve dhe rrjedhimisht edhe objektivat e parapara t'i realizonin me ato mjete. Marrë parasysh faktin se pjesën më të madhe të këtyre shpenzimeve e përbejnë investimet kapitale, i bie se shumë projekte kanë mbetur pa u realizuar si rezultat i këtyre kostove.

Shkaqet kryesore të pagesës së faturave nga Thesari sipas vendimeve gjyqësore kryesisht kishin të bënin me pagesa të shpronësimeve si rezultat i ankesave të pronarëve që kanë qenë pjesë e procesit të shpronësimit, vonesat në pagesat e faturave nga ana e OB-ve për shkak të neglizhencës së zyrtarëve përgjegjës; mos kompensimi i punëtorëve për paga jubilarë dhe përcjellëse të cilat ishin të rregulluara sipas kontratës kolektive, por që nuk ishin buxhetuar nga kategoria e pagave; si dhe vonesat në pagesa për operatorët ekonomik si shkak i mungesës së mjeteve buxhetore.

Më tutje, nga auditimet e OB-ve ne kemi vërejtur se shpenzimet e vendimeve gjyqësore në masë të madhe ishin të keq klasifikuara në kategori ekonomike, çka do të thotë se edhe raportimi i këtyre shpenzimeve në pasqyrat financiare të OB-ve, dhe rrjedhimisht edhe në pasqyrat e konsoliduara të BRK-së nuk ishte i drejtë. Keqklasifikimi i shpenzimeve përmes vendimeve gjyqësore ka shkaktuar nënvlerësimin/mbivlerësimin e kategorive ekonomike në PFV-të për të njëjtën shumë.

Pjesa më e madhe e këtyre keqklasifikimeve kanë të bëjnë me pagesa të pagave jubilarë të punonjësve të pensionuar si rezultat i detyrimeve që dalin nga kontrata kolektive, nga kategoritë e tjera të shpenzimeve. Shumat e paguara janë keq klasifikuar për shkak se nuk përkojnë me kategorinë adekuate të shpenzimeve, me ç' rast janë mbivlerësuar shpenzimet në kategori tjera dhe për të njëjtën shumë janë nënvlerësuar shpenzimet e pagave. Pagesat nga kodet e gabuara kanë ndodhur për shkak të mungesës së fondeve buxhetore, të cilat me rastin e ndarjeve buxhetore nga Qeveria, përkatësisht Ministria e Financave, nuk ishin marrë parasysh si detyrime rrjedhëse gjatë vitit dhe rrjedhimisht, nuk ishte ndarë asnjë fond kontingjent për kompensimin e tyre. Thesari kishte ekzekutuar pagesat nga fondet e ndara për kategoritë tjera. Gjatë auditimit të vitit 2020, ne kemi identifikuar në 23 OB këso lloj pagesash.

Sa i përket raportimit financiar të këtyre pagesave, sipas raportit vjetor financiar të buxhetit të RKS-së, pagesat përmes vendimeve gjyqësore janë prezantuar në vlerë 30,220,398 €, me një ndryshim prej 255,086 € krahasuar me gjendjen reale të këtyre pagesave. Ky ndryshim ishte kryesisht për shkak të mos reflektimit të drejtë të disa korigjimeve të cilat kanë ardhur si rezultat i ndryshimeve me rastin e bartjes së shpenzimeve si pasojë e ristrukturimit të ministrive sipas vendimit të qeverisë nr. 10/26 të datës 23.04.2020.

Rekomandimet për Qeverinë

- Të shqyrtoj obligimet dhe përgjegjësitë eventuale të OB-ve që burojnë nga marrëveshjet kolektive valide dhe të ndërmarrin veprimet përkatëse. Në varësi të këtyre obligimeve dhe mundësive buxhetore, të siguroj që organizatat buxhetore bëjnë planifikimin adekuat të buxhetit, në mënyrë që të shmangen shpenzime të panevojshme nga proceset eventuale gjyqësore si pasojë e mos përmbushjes së obligimeve eventuale që burojnë nga këto marrëveshje.

Rekomandimet për Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve

- Me rastin e përgatitjes së RFV-së të BRK-së, të sigurohet për saktësinë e vlerës së prezantuar të këtyre pagesave, duke u bazuar në shënimet e fundit të korigjuara të SIMFK-së dhe përmes krahasimit/harmonizimit me PFV-të individuale të OB-ve që kanë pasur shpenzime të tilla.

10. Të dhënat e punësimit

Sipas Ligjit Nr. 07/L -014 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, numri i lejuar i të punësuarve për nivelin qendror (Ministritë dhe Institucionet e Pavarura), dhe nivelin lokal ishte 85,436, përderisa numri faktik i të punësuarve sipas PFV të BRK-së ishte 81,690. Nëse e krahasojmë numrin e të punësuarve faktik të vitit 2020 me numrin faktik të të punësuarve në vitin 2019 (83,789), kemi një rënie të të punësuarve për 2,099, kjo kryesisht kishte ndodhur për shkak të pensionimeve. Siç shihet Organizatat buxhetore në vitin 2020 nuk kishin arritur t'i plotësojnë të gjitha vendet e punës të lejuara me ligjin e buxhetit. Dallimi në mes numrit të lejuar dhe faktik të të punësuarve ishte për 3,746. Ndër shkaqet e mosplotësimit të pozitive ishin: shfuqizimi i ligjit për shërbimin civil nga ligji i ri për zyrtarët publik, dërgimi i Ligjit nr. 06/L – 114 për Zyrtarët Publik në Gjykatën Kushtetuese për interpretim nga Avokati i Popullit, mungesa e legjislacionit sekondar që ndërlihet me këtë ligj, pandemia e shkaktuar nga COVID 19.

Mos plotësimi i numrit të aprovuar të të punësuarve sipas ligjit të buxhetit për vitin 2020, si në nivelin qendror ashtu edhe atë komunal, mund të rezultojë me performancë të dobët në nivel të organizatës buxhetore dhe mos arritje të planeve dhe objektivave të synuara.

10.1 Të punësuarit jashtë listës së pagave

Sipas PFV-ve të BRK-së për vitin 2020, numri total i të punësuarve jashtë listës së pagave ishte 709, ku institucionet e nivelit qendror (ministritë dhe institucionet e pavarura) i kishin 619, ndërsa niveli lokal 90 punësuar jashtë listës së pagave. Nëse e krahasojmë këtë numer me vitin e kaluar (405) kemi një rritje për 304 të punësuar.

Numri më i madh i tyre ishte në Ministrinë e Shëndetësisë (510) të cilët ishin staf i angazhuar me vendim të qeverisë në luftë kundër pandemisë COVID 19.

Po ashtu edhe në Organin Shqyrtues të Prokurimit janë 46 punëtorë të angazhuar si ekspertë të jashtëm teknik dhe profesional.

Komuna e Glllogocit (31), janë staf të angazhuar në sektorin e arsimit si zëvendësim për lehonat.

10.2 Të punësuarit përmes Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta

Sipas PFV-ve të BRK-së për vitin 2020, numri total i të angazhuarve përmes Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta (MShV), ishte 2,233. Krahasuar me vitin 2019 (4,336), kemi një rënie të këtyre të angazhuarve për 2,103. Pjesa dërmuese e organizatave buxhetore me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 06/L – 114 për Zyrtarët Publik, pas skadimit të kontratave të këtyre të angazhuarve, nuk i kanë vazhduar më ato. Sidoqoftë, edhe në vitin 2020 kishte një numër të konsiderueshëm të këtyre të angazhuarve që ishin qoftë të trashëguar ndër vite, apo të angazhuar pa ndonjë procedurë gjatë vitit 2020 për pozita të rregullta të punës. Për të eliminuar tërësisht këtë dukuri, OB-të duhet të respektojnë të gjitha kërkesat ligjore sa i përket të angazhuarve me marrëveshje për shërbime të veçanta.

Pjesa e dytë – Përmbledhja e rezultateve të auditimeve individuale

11. Zbatimi i rekomandimeve

Rëndësia e raporteve të auditimit qëndron në identifikimin e dobësive në sistemet e qeverisjes, veçanërisht të sistemeve financiare, ndërsa zbatimi i rekomandimeve të auditimit shërben si një mekanizëm për sanimin e këtyre dobësive dhe bërjen e sistemeve më efikase dhe efektive në arritjen e objektivave. Analizat në këtë fushë kanë rezultuar se niveli aktual i zbatimit të rekomandimeve të auditimit nuk është i kënaqshëm.

Pas pranimit të RVA-së për vitin 2019, Qeveria kishte përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

Shumica e organizatave buxhetore nuk zbatojnë proces sistematik për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve. Ndonëse, krahasuar me vitin 2019, numri i rekomandimeve ka shënuar rënie, megjithatë, numri i rekomandimeve të zbatuara plotësisht është në nivel prej 45%, ndërsa pjesa tjetër e rekomandimeve janë në proces të zbatimit ose nuk janë zbatuar ende, përfshirë këtu edhe rekomandimet nga vitet e mëhershme. Përveç kësaj, një numër i rekomandimeve janë trajtuar si të mbyllura për faktin e ndryshimeve të bazës ligjore si dhe ndryshimit të strukturës së raportimit e të cilat nuk do të përsëriten.

Ngecjet në zbatimin e plotë të rekomandimeve ndikojnë në përsëritjen e dobësive dhe mangësive të kontrollit dhe përsëritjen sistematike të parregullsive nga viti në vit. Shkaqet dhe arsyet që kanë ndikuar për një progres të dobët, janë të ndryshme, të cilat do të shpjegohen më poshtë.

Ndikimi i auditimit, matet me nivelin e zbatimit të rekomandimeve dhe është treguesi më i mirë nëse menaxhmenti po përmirëson proceset ekzistuese dhe kontrollet në fushat ku janë identifikuar parregullsitë.

ZKA-ja, përmes auditimeve individuale bën edhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në vitin paraprak dhe vitet e mëhershme, duke i pasqyruar qartë fushat në të cilat janë marrë masa dhe veprime përmirësuese, si dhe fushat ku nuk janë vërejtur ndryshime.

Shtojca I e raportit ofron informata të plota mbi progresin e rekomandimeve të dhëna në RVA, ndërsa Tabela 1 dhe 2 paraqesin statistikat e rekomandimeve për organizatat individuale.

11.1 Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në RVA-në për 2019

Në RVA-në për vitin 2019, Auditori i Përgjithshëm i kishte rekomanduar Kuvendit të kërkojë nga Qeveria një raport në lidhje me rekomandimet e dhëna në RVA të vitit 2019 dhe të përgatisë një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në RVA të vitit 2019, si dhe raporte në lidhje me progresin e këtij plani në baza gjashtë mujore.

Qeveria e Kosovës në shtator të vitit 2020 kishte aprovuar Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, ku janë obliguar të gjitha organizatat buxhetore (OB) për zbatimin e tij. Sipas KMFP-së, i njëjti është dërguar edhe në Kuvendin e Kosovës (KMFP) për shqyrtimin e progresit të rekomandimeve.

Në bazë të informatave të mbledhura gjatë procesit të auditimit për pasqyrat e buxhetit si dhe nga auditimet individuale, kemi vërejtur se veprimet e ndërmarra nga ana e Kuvendit të Kosovës, Qeverisë dhe institucioneve

tjera, kanë reflektuar me një progres të ultë në zbatimin e rekomandimeve edhe pse krahasuar me vitin e kaluar për nga numri, niveli i tyre ka shënuar rënie.

Nga gjithsej 43 rekomandime²⁶ të dhëna në RVA-në 2019, 8 janë zbatuar plotësisht, 20 ishin në proces të zbatimit dhe 15 të tjera nuk ishin adresuar ende. Shtojca II paraqet të dhëna të detajuara për rekomandimet e dhëna në RVA 2018.

Moszbatimi i rekomandimeve ka ndikuar që dobësitë dhe parregullsitë e caktuara të përsëriten veçanërisht në fushat, si:

- Raportimi i gabueshëm i shpenzimeve në PFV-të për shkak të keqklasifikimit (përfshirë edhe pagesat direkte nga Thesari përfshirë pagat jubilarë në komuna) dhe shpalojsja jo e mjaftueshme e informatave;
- Dobësi në procedurat e prokurimit;
- Dobësi në menaxhimin e të hyrave dhe shpenzimeve;
- Dobësi në menaxhimin e personelit dhe procedurave për subvencionet;
- Mungesë të shërbimeve të auditimit të brendshëm në disa organizata dhe për institucionet e vogla të pavarura; dhe
- Menaxhim joefikas i burimeve në komuna.

11.2 Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale 2019

Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve është pjesë e procesit të përhershëm të auditimit. Vlerësimi se si dhe sa janë zbatuar ato, bëhet për secilën organizatë buxhetore gjatë auditimit të rregullt dhe rezultatet për vitin paraprak, paraqiten në raportet e auditimit për vitin vijues.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat për gjendjen e rekomandimeve të vitit 2019 dhe 2018, të cilat janë të kategorizuara sipas organizatave të audituara.

Organizatave të audituara janë ndarë në: Institucione të nivelit qendror²⁷, Institucione të pavarura²⁸ dhe Institucione të nivelit lokal (38 Komuna).

Në vijim është paraqitur tabela me numrin e rekomandimeve të dhëna dhe përqindjet e zbatimit të tyre.

²⁶ Tri (3) Rekomandime janë dhënë për Kuvendin e Kosovës, 39 për Qeverinë/ministritë, dhe 1 për Kuvendet Komunale. Nga këto rekomandime, 2 janë dhënë në lidhje me auditimin e performancës.

²⁷ Kuvendi I Kosovës, Zyra e Presidentit, Zyra e Kryeministrit, 16 Ministri, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, Administrata Tatimore e Kosovës, DK dhe ShSKUK.

²⁸ Në institucionet e pavarura janë përfshirë Universiteti i Prishtinës dhe 28 institucione.

Tabela 26 - Zbatimi i rekomandimeve të AP-së për vitin 2019

Subjektet e audituara	Nr. total i rekomandimeve	Të zbatuara		Pjesërisht të zbatuara		Të pazbatuara		Të mbyllura të pazbatuara	
		Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Institucionet e nivelit qendror	266	138	52%	10	4%	71	27%	47	18%
Institucionet e pavarura	54	30	56%	0	0%	16	30%	8	13%
Institucionet e nivelit lokal	483	197	41%	43	9%	183	38%	60	12%
Gjithsej rekomandime	803	365	45%	53	7%	271	34%	114	14%

Tabela 27 - Zbatimi i rekomandimeve të AP-së për vitin 2018

Subjektet e audituara	Nr. total i rekomandimeve	Të zbatuara		Pjesërisht të zbatuara		Të pazbatuara		Të mbyllura të pazbatuara	
		Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Institucionet e nivelit qendror	274	111	41%	32	12%	101	37%	30	11%
Institucionet e pavarura	59	42	71%	3	5%	10	17%	4	7%
Institucionet e nivelit lokal	588	217	37%	78	13%	201	34%	92	16%
Gjithsej rekomandime	921	370	40%	113	12%	312	34%	126	14%

Siç shihet edhe nga tabelat më lart, numri total i rekomandimeve të dhëna për vitet 2018/2019, është në rënie, e cila reflektohet sipas nivelit të institucioneve, megjithatë niveli i rekomandimeve të pazbatuara apo që nuk ka filluar zbatim, ende është jo i kënaqshëm.

Në përgjithësi, organizatat buxhetore nuk ndjekin ndonjë proces formal të monitorimit, vlerësimit apo raportimit mbi shkallën e progresit. Kjo pasqyron mungesën e përgjegjësisë për të siguruar që rekomandimet zbatohen me kohë dhe pengesat për veprim, identifikohen dhe adresohen.

Në vitin 2019, ZKA-ja ka dërguar tek OB-të “Rregullore të punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit” si dhe formatet e formularëve për planin e veprimit të rekomandimeve dhe monitorimit (progresit) të tyre.

Në mënyrë që situata të përmirësohet, nevojitet rritje e përkushtimit dhe llogaridhënies nga personat përgjegjës dhe monitorimi i rregullt i zbatimit të rekomandimeve nga të gjitha OB-të.

Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet e performancës

Qëllimi i rekomandimeve në auditimet e performancës është në përmirësimin e procesit të zbatimit dhe funksionimit efektiv të sistemeve, programeve dhe aktiviteteve qeveritare. Rekomandimet i adresohen subjekteve të audituara në mënyrë që të përmirësojnë qasjen e tyre në raport me shpenzimin e fondeve publike.

Përmes auditimeve të performances, ZKA-ja i ka ofruar Kuvendit dhe të audituarve rekomandime të dobishme që të përmirësojnë dhe rrisin ekonomikitetin, efikasitetin dhe efektivitetin në sektorë të rëndësishëm si: sistemi gjyqësor, shëndetësia, mjedisi, sistemet e teknologjisë informative, prokurimi publik. Rekomandimet e auditimit të performances kanë përfshirë si nivelin e qeverisjes qendrore ashtu edhe atë lokale.

Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve nga raportet individuale të auditimit të performancës bëhet përmes auditimeve të veçanta, të cilat njihen edhe si “faza e përcjelljes”. Pas këtij procesi nxjerrën edhe rezultatet e zbatimit të rekomandimeve.

Në RVA-në për vitin 2019 janë dhënë dy rekomandime, prej të cilave njëri është i zbatuar derisa një është në proces të zbatimit. Në shtojcën I të këtij raporti, është paraqitur gjendja e zbatimit të këtyre rekomandimeve.

Arsyet për zbatimin e ultë të rekomandimeve

Mungesa e proceseve formale për monitorimin e mirëfilltë dhe sistematik të planeve të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, si dhe mungesa e përkushtimit të duhur për trajtimin e tyre, janë ndër shkaktarët kryesorë për nivelin e ulët të zbatimit të rekomandimeve. Po ashtu, mungesa e mbikëqyrjes efikase nga ana e Qeverisë dhe organeve mbikëqyrëse, ka ndikuar që organizatat buxhetore të shmangin zbatimin e plotë dhe konsistent të udhëzimeve për menaxhimin financiar, duke bërë që rekomandimet të përsëriten.

Për të rritur nivelin e zbatimit të rekomandimeve, nevojiten masa shtesë nga ana e Qeverisë ndaj OB-ve dhe forcimi i masave të llogaridhënies ndaj Kuvendit të Kosovës.

Rekomandimet për Kuvendin e Kosovës

Të siguroj që plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve i përgatitur nga Qeveria, është shqyrtuar nga KMFP-ja. Këto plane duhet të përcaktojnë saktë veprimet, afatet kohore dhe personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve dhe monitorimin e tyre. Po ashtu, të siguroj që së paku dy herë në vit KMFP-ja ka shqyrtuar progresin e arritur në zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Rekomandimi për Qeverinë

Qeveria duhet të vendos një proces efektiv të monitorimit të zbatimit të rekomandimeve. Me OB-të, t'i diskutoj të gjitha masat efektive që mund ta përmirësojnë procesin, në veçanti fuqizimin e masave që forcojnë llogaridhënien dhe parandalojnë ngecjet në zbatimin e rekomandimeve.

12. Opinionet e auditimeve në raportet individuale 2020

ZKA-ja për vitin 2020, ka përfunduar 90 auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Auditimet janë kryer në bazë të doracakut dhe metodologjisë së përditësuar të auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë, për të qenë në linjë me Standardet e Auditimit (SNISA-t). Në bazë të kësaj metodologjie ne kemi dhënë opinionet e auditimit për Pasqyrat financiare, në përputhje me SNISA-t, dhe për herë të parë kemi dhënë konkluzione në lidhje me pajtueshmërinë me autoritetet për secilën OB. Opinionet e auditimit në lidhje me PFV-të e OB-ve, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 28 - Lloji dhe numri i opinionëve për PFV-të individuale të OB-ve për vitin 2020

Subjektet e audituara	Opinion i pamodifikuar	Opinion i kualifikuar	Opinion i kundërt	Gjithsej
Institucionet e Nivelit Qendror	8	14	0	22
Komuna	25	13	0	38
Institucionet e Pavarura	30	0	0	30
Gjithsej	63	27	0	90

Siç shihet nga tabela e mësipërme, auditimet individuale të OB-ve kanë rezultuar me: 63 opinione të pamodifikuara (prej tyre 39 të pamodifikuara dhe 24 të pamodifikuara me theksim të çështjes), si dhe 27 opinione të modifikuara (prej tyre 13 opinione të kualifikuara dhe 14 opinione të kualifikuara me theksim të çështjes). Shprehur në përqindje, 70% e opinionëve të auditimit janë të pamodifikuara, që nënkupton se ka pasur cilësi të mirë dhe raportim korrekt të informatave në PFV, ndërsa 30% janë opinione të modifikuara, që do të thotë se një numër i konsiderueshëm i OB-ve kanë pasur problem me raportimin e informatave të kërkuara, në PFV-të. Në vitin paraprak, pra 2019 vetëm në 1% të rasteve, pasqyrat kanë përmbajtur gabime dhe parregullsi materiale, derisa në vitin 2018 në 10% të rasteve.

Arsyet kryesore për modifikimin e opinionëve të auditimit ishin kryesisht: keqklasifikimi dhe raportimi jo i duhur i shpenzimeve (i realizuar nga OB), gabimet në prezantimin e informatave për pasuritë kapitale dhe jo kapitale, pagesat e paarsyetuara (kjo vlen për nivelin qendror ku janë kryer pagesa për punëtorët që nuk kanë vijuar punën, kryesisht ish pjestarët e mbrojtjes civile), mos shpallja e informatave për shpenzimet për Covid-19, etj.

Arsyet kryesore për theksimin e çështjes, në shumicën e auditimeve individuale kanë qenë keqklasifikimi i shpenzimeve, i ndikuar nga pagesat përmes vendimeve të gjykatave dhe përmbartësve, keqklasifikimet e ndikuara nga planifikimi i gabuar i buxhetit, etj.

12.1 Rekomandimet e dhëna në raportet individuale për vitin 2020

Përveç opinionëve të auditimit për PFV-të, në raportet individuale të OB-ve kemi dhënë rekomandimet për përmirësimin e secilës fushë ku janë identifikuar mangësi dhe gabime. Në tabelën e mëposhtme i kemi paraqitur rekomandimet e dhëna në tri vitet e fundit, për OB-të, që i kemi grumbulluar në tri kategori.

Tabela 29 - Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale të OB-ve

Subjektet e audituara	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2018
Institucionet e Nivelit Qendror	244	263	275
Komunat	367	488	585

Institucionet e Pavarura	43	52	60
Gjithsej Rekomandime:	654	803	920

Të dhënat e paraqitura në tabële tregojnë për një rënie të vazhdueshme të numrit të rekomandimeve nëpër vite. Rënie më e madhe e numrit të rekomandimeve këtë vit vërehet te komunitat, derisa rënie më e lehtë e numrit të rekomandimeve është tek OB-të e nivelit qendror, edhe pse kjo mund të jetë ndikuar nga numri më i vogël i ministrive, pasi në raport me vitin parakrah në vitin 2020 kishte 5 ministri më pak, ndërsa institucionet e pavarura qëndrojnë më mirë dhe numri i rekomandimeve vazhdon të zvogëlohet vit pas viti.

13. Sistemi i auditimit të brendshëm

Auditimi i Brendshëm (AB) është funksion i rëndësishëm i sistemit i cili siguron menaxhmentin e lartë se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Komiteti i Auditimit (KA) është organ këshillëdhënës i menaxhmentit të lartë të Subjekteve të Sektorit Publik, dhe mbështetës për auditorët e brendshëm duke siguruar pavarësinë e tyre, vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve dhe siguruar zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Në kuadër të objektivave të Strategjisë së Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike është avancimi i AB-së përmes zbatimit të programit për zhvillimin profesional, sigurimit të cilësisë për pajtueshmëri si dhe azhurnimit të kornizës ligjore. Në shërbim të këtij qëllimi Ministria e Financave - Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm, në shkurt 2020 ka hartuar Doracakun e Auditimit të Brendshëm.

NjQHAB është koordinatore e gjithë procesit për auditim të brendshëm dhe ndër të tjera monitoron subjekte të sektorit publik për kontrollin e brendshëm të financave publike.

NjAB-të në vitin 2020 kishin në fokus vitin aktual me një nivel prej 67%, përderisa sa i përket veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti i OB-ve në zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm kemi vërejtur se 45% e rekomandimeve të dhëna kishin gjetur zbatim të plotë përderisa pjesa tjetër ishin në proces apo të pazbatuara.

Në sistemin e auditimit të brendshëm kemi vërejtur mangësitë si në vijim:

- Rregullorja 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm përcakton kriteret që duhet plotësuar për themelimin e NjAB-së dhe përcakton numrin minimal të auditorëve që duhet të ketë OB-ja. Bazuar në këto kritere kemi identifikuar se prej 64 OB-ve përkundër që e plotësojnë kriterin tri²⁹ prej tyre nuk e kishin të themeluar NjAB-në. Përderisa sa i përket stafit të mjaftueshëm me auditor nga 61 OB që kanë NjAB-in mbi gjysma (34) prej tyre kishin numër të auditorëve më pak se sa që e parasheh rregullorja. Megjithatë, niveli i auditimeve të realizuara në raport me të planifikuarat ishte prej 85%, që është një tregues se numri i auditorëve të brendshëm në shumicën e rasteve është i mjaftueshëm; dhe
- Sfidë mbetet themelimi i KA-ve në të gjitha organizatat. Nga 61 OB-të që e kishin NjAB-në, në gjashtë³⁰ prej tyre nuk e kishin themeluar KA-në në vitin 2020. Më tej, nga 55 OB ku funksiononte KA është vërejtur se në 27 prej tyre KA-të kishin mbajtur me pak se katër takime apo aq sa kërkohet me UA 01/2019. Po ashtu, 15 KA nuk e kishin dorëzuar raportin vjetor siç kërkohet me nenin 10 të UA. Kjo tregon se KA-të ende nuk janë mjaftueshëm efektive për të mbështetur plotësisht punën e NjAB-së.

Auditimet e brendshme vazhdojnë të mbeten të orientuara drejt pajtueshmërisë dhe më pak të përqendruara në auditime të performancës dhe të sistemeve.

Sistemi i kontrollit të brendshëm përkundër përmirësimeve nga viti i kaluar, ende nuk është në nivelin e kënaqshëm, në mënyrë që AB-të të veprojnë si këshilltarë dhe mekanizma parandalues i gabimeve dhe parregullsive.

²⁹ Mitrovica Veriore, Leposaviqi dhe Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale.

³⁰ Zyra e Kryeministrit, Ministria e Pushtetit Lokal, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Zhvillimit Rajonal, Komuna e Ranillugut dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Rekomandojmë Qeverinë që të siguroj se:

- Menaxhmentet e OB-ve të cilat janë të obliguara të themelojnë NjAB-në sipas rregullores QRK-nr. 01/2019 duhet sa më parë ta krijojnë këtë njësi, përmes së cilës do të sigurohet funksionimi efikas dhe efektiv i sistemit të kontrollit të brendshëm. Po ashtu, OB-të që nuk janë të obliguara të kenë NjAB-në, funksionin e auditimit të brendshëm ta ushtrojnë përmes mënyrave tjera të parapara me këtë Rregullore; dhe
- Të gjitha OB-të themelojnë Komitetet e Auditimit për të mbështetur realizimin e objektivave të NjAB-së. Këto komitete duhet të hartojnë raportin vjetor siç kërkohet me UA-në, të shtojnë efektitetin dhe të kontribuojnë në rritjen e llogaridhënies në OB dhe forcimin e rolit të AB-së.

14. Prokurimi

Përmes prokurimit publik, në vitin 2020, janë lidhur 10,935 kontrata në vlerë 499,311,906 € që krahasuar me vitin paraprak paraqet një rënie në vlerë prej 36%. Gjithsej 158 autoritete kontraktuese (AK) ishin përfshirë në zhvillimin e këtyre aktiviteteve të prokurimit, ndërsa për 16 institucione të pavarura aktivitetet e prokurimit i ka zhvilluar Agjencia Qendrore e Prokurimit.

Në vitin 2020, organizatat buxhetore (OB-të) kanë nënshkruar 8,039 kontrata publike që përbën mbi 73% të numrit total të kontratave publike, pasuar me 2,888 kontrata që i kanë nënshkruar ndërmarrjet publike. Krahasuar me vitin paraprak numri i kontratave publike ka pësuar rënie me afër 12%.

Burimi kryesor i financimit për tenderët publik ishte buxheti i Kosovës me 86%, pastaj të hyrat vetjake me 13% dhe 1% ishin financuar nga donacionet.

Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) ka vepruar si autoritet kontraktues në emër të të gjitha OB-ve për 14 lloje të furnizimeve dhe ka zhvilluar aktivitete të prokurimit që kanë rezultuar me nënshkrimin e kontratave publike të centralizuara. Gjatë vitit 2020, AQP-ja ka kryer shtatë aktivitete të prokurimit që kanë rezultuar me 26 kontrata (për shkak të ndarjes së tenderëve në lloje) vlera e përgjithshme e të cilave është 37,088,196 €. Gjithsej 103 kontrata të centralizuara për këto 14 lloje të furnizimeve, kanë qenë në zbatim gjatë vitit 2020, por që janë lidhur në vitet paraprake.

Më tutje, Drejtoria për prokurime të veçanta e AQP-së gjatë vitit 2020 ka zhvilluar 65 aktivitete të prokurimit për OB të ndryshme sipas kërkesës së tyre dhe ka nënshkruar 76 kontrata vlera e përgjithshme e të cilave është 1,568,937 €, afërsisht e njëjtë me vlerën e kontratave që kishte nënshkruar vitin paraprak.

Nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të vitit 2020 që Zyra Kombëtare e Auditimit e ka kryer në OB, janë identifikuar çështje të ndryshme të prokurimit që kanë të bëjnë me fazën e tenderimit si dhe atë të menaxhimit të kontratave publike.

Sa i përket parregullsive (të pretenduara) gjatë fazës së tenderimit, operatorët ekonomik që kishin dorëzuar ofertat e tyre në përgjigje të tenderëve publik, gjatë vitit 2020 kishin parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) 1184 ankesa që paraqet një rritje prej 20% në krahasim me vitin paraprak (981 ankesa në vitin 2019). Në raport me totalin e aktiviteteve të prokurimit të zhvilluara gjatë vitit 2020, rezulton se ka pasur një ankesë për çdo të 11-tin tender të publikuar.

Lidhur me ankesat e parashtruara, OSHP-ja ka vendosur në favor të OE-ve për 56% të rasteve, pra më shumë se gjysma (605 raste) janë kthyer në rivlerësim dhe në ri-tenderim (63 raste), derisa i ka aprovuar 339 vendime të AK-ve që përbëjnë 29% të numrit të përgjithshëm të ankesave. OSHP-ja ka shqiptuar tri gjopa për tri AK gjatë vitit 2020, vlera e përgjithshme e të cilave është 20,000 €.

Çështja më e shpeshtë që është vërejtur në tenderët publik është hyrja në obligime kontraktuese pa buxhet të mjaftueshëm si dhe zhvillimi i aktivitetit të prokurimit dhe lidhja e kontratave (të ndërtimit) në mungesë të projekteve kryesore.

14.1 Parregullsitë në fushën e prokurimit publik

Edhe në vitin 2020 sikurse në vitet e kaluara, raportet individuale të auditimit kanë nxjerrë në pah një sërë mangësish në zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit si dhe në zbatimin të kontratave publike të lidhura përmes prokurimit.

Gjatë vitit 2020, auditimi ka gjetur mangësi në çdo fazë të prokurimit. Në tabelën në vijim kemi prezantuar dobësitë që janë përsëritur më së shpeshti.

Tabela 30 - Dobësitë e përsëritura në prokurimin publik

Çështja	Ndikimi	Veprimet e kërkuara nga organizatat buxhetore
Hyrja në obligime kontraktuale duke nënshkruar kontratat pa buxhet të mjaftueshëm në dispozicion.	Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme mund të rezultojë në vonesa në realizimin e punëve ose të pagesave si dhe rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për periudhat vijuese.	Të forcojnë kontrollet duke siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit çdo projekt kapital të ketë fonde të mjaftueshme për realizim.
Zhvillimi i aktivitetit të prokurimit për kontrata për punë, në mungesë të projektit kryesor.	Inicimi i aktivitetit të prokurimit në mungesë të projektit kryesor rezulton me anashkalimin e kërkesës ligjore dhe mund të rezultojë me realizim të dobët që për pasojë mund të rezultojnë me kosto shtesë apo vlerë të dobët për parane e shpenzuar.	Përmes menaxherit të prokurimit të sigurojnë që asnjë aktivitet i prokurimit që ka të bëjë me punë të mos iniciohet pa u siguruar se ekziston projekti kryesor. Parapërgatitjet e duhura për një projekt nga njësia kërkuese do të kenë efekt direkt në hartimin e specifikimeve të qarta, duke eliminuar pengesat si të vonesave ashtu edhe të kostove shtesë.
Blerja pa procedura të prokurimit	Mos aplikimi i procedurave të prokurimit, zvogëlon konkurrencën dhe transparencën për shpenzimin e parasë publike dhe OB-ja mund të marrë produkte me çmime jo të favorshme.	Të sigurojnë se blerja e shërbimeve apo produkteve bëhet sipas procedurave adekuate të prokurimit. Në rastet kur financimi është nga donatorët të definohet me marrëveshje të financimit/grantit se çfarë procedura të prokurimit parashikohen të zhvillohen.
Mos respektim i kërkesave të vendosura në dosjen e tenderit gjatë përzgjedhjes së operatorëve ekonomik.	Shpërblimi me kontratë i operatorëve ekonomik të cilët mund të mos i plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit, mund të ndikojë që të njëjtit të mos mund t' i dorëzojnë /përfundojnë mallrat/punët siç kërkohet.	Të sigurojnë se po respektohen kërkesat e paraqitura në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit nga komisionet e vlerësimit, në mënyrë që vetëm operatorët që kanë përmbushur të gjitha kushtet, të shpërblehen me kontratë.
Mungesa e komisionit për pranimin e mallrave	Pranimi i mallrave në mungesë të plotë të anëtarëve të komisionit të pranimin siç është përcaktuar në kontratë rrit rrezikun që mallrat të mos jenë sipas sasisë dhe kushteve të kontratës.	Të sigurojnë që pranimi i mallrave bëhet sipas kushteve të kontratës dhe që asnjë pagesë të mos bëhet nëse pranimet nuk janë të nënshkruara nga tre anëtar të komisionit.
Tejkalimi i sasive mbi 30% në kontrata kornizë	Tejkalimi i kontratës kornizë mbi normën e lejuar, ndikon që organizata buxhetore (OB) të hyj në obligime të paplanifikuara dhe rrjedhimisht ndikon që të bëhen shpenzime jo në pajtim me kornizën ligjore.	Të sigurojnë që mos të bëhen tejkalime të kontratave mbi normën e lejuar 30% dhe kontratat të cilat tashmë kanë tejkaluar limitet e lejuara të ndërpriten menjëherë.

Angazhimi për shërbime të veçanta pa procedurë prokurimi.	Anashkalimi i procedurave të prokurimit në lidhje me mbulimin e pozitave për shërbime të veçanta, përveç mosrespektimit të procedurave ligjore po ashtu e rrit edhe rrezikun e angazhimit të personave jo adekuat për pozita dhe detyrat e caktuara, çka mund të reflektoj edhe në performancë e tyre në punë.	Të sigurojnë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jetë në gjendje të përmbush detyrat e kërkuara. Po ashtu, menaxhmenti duhet të përkujdeset që angazhimet për pozitat e rregullta të zhvillohen përmes procesit të rregullt të rekrutimit.
Ndarje e tenderëve dhe mos aplikimi i procedurës së hapur.	Ndarjet dhe shmangiet e procedurave të përshtatshme të prokurimit reflektojnë me mungesë transparence dhe kufizim të konkurrencës, duke rrezikuar edhe aspektin kualitativ të furnizimeve të pranuar për parane e shpenzuar.	Të sigurojnë një planifikim të drejtë dhe të saktë, duke evituar çfarëdo ndarje të aktiviteteve të njëjta të prokurimit, ashtu që të sigurohet blerje efikase dhe të mundësohet në këtë formë respektimi i kërkesave ligjore për parane e shpenzuar.
Aneks kontrata përtej vlerës së lejuar prej 10%	Anashkalimi i procedurave të hapura në rastet kur sasi të shtesë tejkalojnë 10% të vlerës së kontratës mund të ndikoj në dëmtimin e konkurrencës. Gjithashtu, ndryshimi i paramasës dhe parallogarisë së kontraktuar vë në dukje dobësitë e kontratës dhe të kontrolleve të ushtruara nga menaxhmenti.	Të sigurojnë se specifikat teknike janë hartuar në harmoni me projektet ekzekutive dhe aprovimet e ndryshimeve duhet të behën vetëm për rastet e lejuara me ligj. Gjithashtu, kur paraqitet nevoja për punë shtesë të bëhet një analizë e hollësishme e sasive të nevojshme dhe në rastet kur nevojat e autoritetit kontraktues nuk mund të plotësohen pa bërë ndryshime thelbësore të kontratës, atëherë duhet të aplikohet procedurë e hapur e prokurimit në harmoni me kërkesat ligjore të LPP-së.

Rekomandimet për Organizatat Buxhetore

- Të sigurojnë se secila kontratë ka fonde të mjaftueshme, të miratuara në ligjin e buxhetit, për të mbuluar koston e projektit në mënyrë që të realizohet sipas planifikimit;
- Të përdorin procedura të prokurimit të cilat sigurojnë nuk e kufizojnë konkurrencën dhe sigurojnë vlerë për parane e shpenzuar; dhe
- Të sigurojnë që aktivitetet e prokurimit për kontrata për punë nuk iniciohen pa projektin kryesor

15. Aplikueshmëria e ligjeve dhe sfidat ligjore

Në auditimet e kryera gjatë viti 2020 ka pasur raste të mos pajtueshmërive së caktuara me dispozitat ligjore (përfshirë këtu mangësitë gjatë zbatimit të ligjeve të tatimit në pronë, lejeve të ndërtimit, shfrytëzimit të pronës publike, raportimit të PFV-ve nga ndërmarrjet publike, si dhe vendimet e ndryshme të shpronësimit). Raste e trajtuara kanë të bëjnë me aplikueshmerinë e ligjeve dhe sfidat ligjore të një rëndësie të veçantë të cilat do raportohen në RVA, si vijim:

a) Rregullimet e ndryshme ligjore për datat e raportimit dhe publikimit të PFV-ve të audituara.

Bazuar në nenin 33.1 të Ligjit nr. Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (NP), Pasqyrat Financiare Vjetore të çdo Ndërmarrje Publike i nënshtrohen një auditimi të jashtëm të paraparë me ligj në pajtim me standardet e pranuar ndërkombëtare të auditimit. Ky auditim kryhet nga një auditor i pavarur, kompetent dhe i kualifikuar. Produkti përfundimtar i një auditimi të tillë duhet të jetë një opinion mbi vërtetësinë për Pasqyrat Vjetore Financiare përfshirë, këtu edhe Letër Menaxhmentin. Opinioni dhe Letra e Menaxhmentit duhet të dorëzohen tek Njësia e Politikave dhe Monitorim të NP-ve më së largu deri më 30 maj të vitit vijues për vitin paraprak. Përveç kësaj, Auditori i Përgjithshëm, Qeveria dhe Kuvendi mund të kryejnë çfarëdo lloj auditimi që konsiderojnë se është i nevojshëm. Bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim (KRFA), afatet kohore për dorëzimin dhe publikimin e pasqyrave financiare të shoqërive tregtare që auditohen në pajtim me SNA-të dhe në pajtim me nenin 7 paragrafi 1 dhe nenin 8 paragrafi 1 të këtij Ligji, dorëzohen dhe publikohen në KKRF dhe një kopje dorëzohet në Ministrinë përkatëse për Tregti dhe Industri jo më vonë se më 30 prill të vitit vijues.

Ligji nr. 03/L 048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi (me plotësim ndryshime) neni 48, për auditimet e rregullsisë, Auditori i Përgjithshëm i dorëzon raportet përfundimtare secilit institucion të audituar si dhe subjektit të cilit i përgjigjet drejtpërdrejtë institucioni përkatës, si dhe Ministrinë, jo më vonë se me 30 Qershor.

Prandaj siç shihet, për dorëzimin e raportit auditues të NP-ve me këto kërkesa ligjore përcaktohen tri afate të ndryshme: sipas Ligjit të KRFA-së 30 prilli; sipas Ligjit të NP-ve 30 maji; dhe sipas LMFPP-së 30 qershori. Kjo si rezultat i rregullimeve të ndryshme dhe mos harmonizimit të këtyre tri ligjeve që rregullojnë çështjen e raportimit të ndërmarrjeve publike.

Si pasojë e kolizionit ligjor në mes të këtyre tri ligjeve, KKRF-ja ka shqiptuar gjopa ndaj disa NP-ve të cilat janë vonuar për dorëzimin e PFV-ve të tyre brenda datave të përmendura me lartë (30 prill), edhe pse vonesat ishin shkaktuar për arsye të auditimeve të kryera nga ZKA-ja në pajtim me ligjin në fuqi.

b) Vendimet e Qeverisë për shpronësim pa ndarjen e mjeteve buxhetore

Vendimet e Qeverisë për shpronësime të tokave për projektet e ndryshme infrastrukturore krijojnë obligime financiare që kanë kosto relativisht të larta dhe të njëjtat nuk janë të buxhetuara për mbulimin e obligimeve që rezultojnë me krijimin e shpenzimeve tjera shtesë.

Në një rast kemi vërejtur se me vendimin e Qeverisë nr.08/148 të datës 05.11.2010, që ka të bëjë me shpronësimin e pronave të paluajtshme të ngastrave kadastrale, borxhi fillestar ishte 662,476 €, mirëpo për shkak të vonesave 10 vjeçare (2010-2020) në ekzekutimin e pagesave, borxhi ishte rritur në 1,692,551 €, pra me një kosto shtesë prej 800,974 € në emër të kamatave (7% vjetore) dhe 229,101 € për shpenzime tjera administrative dhe procedurale që i obligohen MEA-s për t'i mbuluar.

c) Komunat (Mitrovica e Veriut, Zveçan, dhe Zubin Potok) - Moszbatimi i ligjeve për mbledhjen e të hyrave (tatimi në pronë, leje ndërtimit, dhe dhënies në shfrytëzim të pronës publike)

Neni 2 i Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme, përcakton qartë se secila OB duhet të mbledhë të hyra nga tatimi në pronën e paluajtshme. Ndërlidhur me këtë edhe Ligji nr. 04/L-110 për Ndërtimet në nenet 1 dhe 2 përcakton qëllimin e lëshimit të lejeve ndërtimore. Ndërsa Ligji nr. 04/L-144 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës rregullon mënyrën dhe përcakton procedurat dhe format për dhënien në shfrytëzim të pronës publike.

Gjatë vitit 2020, sikurse edhe në vitet e mëparshme, komunat: Mitrovica e Veriut, Zveçani dhe Zubin Potoku vazhdojnë të mos mbledhin të hyra nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, pronat e dhëna në shfrytëzim si dhe nuk kanë hartuar rregullore të brendshme për taksat, tarifatat dhe ngarkesat e qytetarëve për shërbimet e përfituara publike. Prandaj edhe niveli i mbledhjes së të hyrave vetjake është shumë i ulët. Kjo ka ndodhur pasi që komunat ende nuk i zbatojnë ligjet dhe nuk kanë ndërmarrë veprime konkrete për arkëtimin e të hyrave nga këto veprimtari që kanë ndikim të rëndësishëm në nivelin e buxhetit të komunës dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Moszbatimi i ligjeve dhe rregulloreve për mbledhjen e tatimit në pronë, lejeve të ndërtimit, tarifave dhe taksave të tjera nga komunat pasqyron një qasje joserioze ndaj zbatimit të kërkesave ligjore në këto fusha. Kjo rrit rrezikun e mos pajtueshmërisë me ligjet e aplikueshme dhe zvogëlon nivelin e të hyrave, si dhe mundësinë e financimit të projekteve nga këto burime të të hyrave.

Rekomandimet për Qeverinë dhe Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve

- Të iniciojnë ndryshimin e kuadrit ligjor për sa i përket raportimit financiar dhe auditimit të NP-ve në mënyrë që të siguroj harmonizimin e ligjeve që rregullojnë këtë fushë; dhe
- Me rastin e nxjerrjes së vendimeve për shpronësimin e pronave të analizoj dhe të bëjë një vlerësim të efekteve/kostove financiare për projektet përkatëse. Poashtu, të buxhetoj mjetet financiare dhe të ekzekutoj me kohë pagesat në mënyrë që të mos krijohen shpenzime shtesë nga OB-të për shpronësimin e pronave.

Rekomandimet për komunat Mitrovicë Veriore, Zveçan dhe Zubin Potok

Të sigurojnë zbatimin e ligjeve për mbledhjen e të hyrave, si dhe të sigurojnë hartimin dhe aprovimin e rregulloreve të brendshme për taksat dhe tarifatat përkatëse. Inkasimi i këtyre të hyrave do të mundësonte realizimin e më shumë projekteve, rrjedhimisht edhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve.

16. Çështjet e ndërlidhura me shpenzimet për menaxhimin e pandemisë Covid -19

Në vitin 2020, shpenzimet e buxhetuara për menaxhimin e pandemisë Covid 19 ishin 294,565,723 €, prej të cilave ishin shpenzuar 285,547,016 € apo 97% e tyre.

Tabela 31 - Pagesat për menaxhimin e pandemisë Covid 19 (kodet 00099 dhe 00098)

Përshkrimi	Buxheti	Pagesat	Progresi %
Pakoja Emergjente (00099)	172,163,254	168,037,902	98%
Pakoja e Rimëkëmbjes ekonomike (00098)	122,402,469	117,509,114	96%
Gjithsej	294,565,723	285,547,016	97%

Buxheti dhe pagesat për menaxhimin e pandemisë Covid-19 ishin nga Pakoja Emergjente (kodi 00099) dhe Pakoja e Rimëkëmbjes ekonomike (kodi 00098). Këto janë ndarë si në vijim:

Tabela 32 - Pagesat për menaxhimin e pandemisë Covid 19 - Pakoja Emergjente (00099)

Kategoria ekonomike	Buxheti	Pagesat	Progresi %
Paga dhe shtesa	33,781,638	33,784,096	100%
Mallra dhe shërbime	20,885,865	19,721,517	94%
Shpenzime komunale	143,306	141,348	99%
Subvencione dhe transfere	115,806,351	113,797,341	98%
Shpenzime kapitale	1,546,094	593,600	38%
Gjithsej	172,163,254	168,037,902	98%

Tabela 33 - Pagesat për menaxhimin e pandemisë Covid 19 – Pakoja e Rimëkëmbjes ekonomike (00098)

Pershkrimi	Buxheti	Pagesat	Progresi %
Paga dhe shtesa	200,000	175,176	88%
Mallra dhe shërbime	6,834,520	4,039,469	59%
Shpenzime komunale	52,453	52,440	100%
Subvencione dhe transfere	115,315,496	113,242,030	98%
Gjithsej	122,402,469	117,509,114	96%

Nga Pakoja Emergjente për menaxhimin e pandemisë Covid 19 - ishin buxhetuar 172,163,254 € prej të cilave ishin shpenzuar 168,037,902 € apo 98%. Ndërsa nga Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike ishin buxhetuar 122,402,469 €, ku shpenzimi ishte 117,509,114 € apo 96%. Pjesa më e madhe e buxhetit ishte buxhetuar dhe shpenzuar në kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve. Ministria e Financave, përkatësisht Thesari me datën 11.12.2020 kishte nxjerr Qarkoren mbi proceset dhe afatet për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore 2020. Në këtë qarkore ishte kërkuar që pasqyrat financiare duhen të përmbajnë një seksion të veçantë (shtojcë), ku raportohen dhe shpalosen shpenzimet e lidhura me menaxhimin e pandemisë (Covid-19), me shpjegimet e nevojshme për transparencë buxhetore.

Bazuar në këtë, organizatat buxhetore (OB) kishin shpalosur shpenzimet për menaxhimin e pandemisë, me përjashtim të disa prej tyre, të cilat nuk kishin shpalosur apo kishin shpalosur pjesërisht shpenzimet e Covidit në pasqyrat financiare vjetore.

Nga niveli qendror, vetëm Zyra e Kryeministrit nuk kishte shpалosur në pasyrat financiare vjetore shpenzimet e Covidit. Ndërsa, sa i përket nivelit lokal komunitat të cilat nuk kanë shpалosur shpenzimet për menaxhimin e pandemisë Covid-19 janë: Istogu, Shterpeca dhe Parteshi.

Komunitat që kanë shpалosur pjesërisht shpenzimet për menaxhimin e pandemisë Covid-19 janë:

- Komuna e Rahovecit për shpenzimet totale 410,080 € ka shpалosur pjesërisht vetëm vlerën prej 303,996 €;
- Komuna e Zubin Potokut, ka shpалosur shpenzimet e mallrave, mirëpo jo edhe vlerën prej 306,239 € të shpenzuara për subvencione; dhe
- Komuna e Zveçanit, ka shpалosur shpenzimet e mallrave, por jo edhe vlerën prej 275,991 € të shpenzuara për subvencione.

Kjo tregon që OB në fjalë nuk kanë respektuar kërkesat nga MF-ja për shpалosjen e shpenzimeve të Covidit siç ishte kërkuar në Qarkoren mbi proceset dhe afatet për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore 2020, me qëllim të transparencës buxhetore.

Rekomandimi për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve

Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit, duhet të sigurojnë se organizatat buxhetore me rastin e përgatitjes së PFV-ve do të respektojnë të gjitha kërkesat ligjore sa i përket shpалosjeve, përfshirë edhe shpenzimet për menaxhimin e pandemisë Covid-19.

Zyra Kombëtare e Auditimit është në proces të përfundimit të auditimit të performancës lidhur me menaxhimin e pandemisë Covid-19, ku pritet të shpалosen më në detaje menaxhimi me furnizim me materiale shëndetsore dhe optimizimi i burimeve njerëzore dhe teknike për të i'u përgjigjur nevojave të pacientëve të prekur me Covid.

Pjesa e tretë - Auditimet e performancës dhe ndërmarrjeve publike

17. Auditimet e performancës

Zyra Kombëtare e Auditimit, vazhdon me fokusin e veçantë që i vë auditimeve të performancës si faktor i rëndësishëm në ndryshimin dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve. Auditimet e performancës vlerësojnë se sa fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe efektive dhe në dobi të mirëqenies së qytetarëve. Përmes rezultateve të auditimit të ZKA-së, Kuvendi dhe qytetarët do të jenë në gjendje që t'i mbajnë llogaridhënës administruesit e burimeve publike.

Për sezonin auditues 2020-2021 janë mbuluar fusha me interes dhe rëndësi shoqërore, ekonomike, ambientale, shëndetësore, të sigurisë dhe fushën e prokurimit publik dhe projekteve nga donatorët. Përmes këtyre auditimeve, Zyra Kombëtare e Auditimit ka synuar të promovojë efikasitetin, llogaridhënien, efektivitetin dhe transparencën e administratës publike.

ZKA-ja në vitet e fundit një rëndësi të veçantë i ka kushtuar edhe auditimeve të teknologjisë së informacionit. Këto auditime janë një ekzaminim dhe rishikim i sistemeve të Teknologjisë së Informacionit dhe kontrolleve përkatëse për të pasur siguri mbi parimet e ligjshmërisë, efikasitetit, ekonomisë, dhe efektivitetit të sistemeve të Teknologjisë së Informacionit dhe kontrolleve përkatëse. Edhe këtë vit janë përfshirë sisteme të informacionit me ndikim në institucionet publike dhe shërbimet ndaj qytetarëve dhe sipas rrezikut potencial në menaxhimin e tyre.

Gjatë sezonit raportues, janë kryer 11 raporte të auditimit të performancës dhe të teknologjisë së informacionit. Në vijim, shkurtimisht është paraqitur përmbajtja e këtyre raporteve, përfshirë objektivin, gjetjet dhe mesazhet e auditimit.

Tema 1 - Procesi i licencimit të shfrytëzuesve të mineraleve ndërtimore e industriale dhe mbrojtja e ambientit nga kjo veprimtari

Institucionet përgjegjëse duhet t'i sigurojnë qytetarët se shfrytëzimi i mineraleve ndërtimore e industriale në vend realizohet në mënyrën e duhur dhe se sigurohet mbrojtja e mjedisit ku veprojnë. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale rregullon aktivitetet e pajimit me licenca për hulumtim dhe shfrytëzim. Ndërsa, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit është përgjegjëse për lëshimin e pëlqimeve dhe lejeve mjedisore si dhe në bashkëpunim me inspektoratet e niveleve qendrore dhe lokale janë përgjegjëse dhe rregullojnë aktivitetet e mbrojtjes së mjedisit.

Mesazhi i auditimit: *Rezultatet e auditimit tregojnë se institucionet përgjegjëse nuk kanë bërë mjaftueshëm për të mbrojtur ambientin nga operatorët ekonomik gjatë zhvillimit të aktivitetit minerar duke mundësuar që këta operator të operojnë pazbatuar kriteret e kërkuara dhe pa ofruar siguri në terren. Sistemi i vendosur nga Komisioni për Miniera dhe Minerale nuk ka ofruar siguri të mjaftueshme se janë plotësuar të gjitha kriteret gjatë procesit të licencimit.*

Nuk ka koordinimin mes palëve gjatë licencimit, mungon pajimi me pëlqime nga organet përgjegjëse për rrugët, mungon programi i rehabilitimit dhe realizohet vazhdimi i licencave në mungesë të rikultivimit të zonave ku janë shfrytëzuar mineralet. Inspektimet nga inspektorati i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale janë përcjellë me mangësi në zbatimin e dispozitave ndëshkuese dhe në monitorimin e operuesve ilegal. Sistemi/procesi për dhënien e pëlqimeve dhe lejeve mjedisore nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit

karakterizohet me disa mangësi në monitorimin e vlefshmërisë së pëlqimeve mjedisore dhe procesin e lejeve mjedisore, monitorimin e operuesve që shfrytëzojnë mineralet. Po ashtu inspektimi nga Inspektorati i MEA-së të shfrytëzuesve të mineraleve karakterizohet me mangësi në zbatimin e dispozitave ndëshkuese. Këto mangësi kanë ndikim negativ direkt në mjedis nga aktiviteti minerar, paraqesin rrezik për njerëzit dhe kafshët dhe njëkohësisht kanë edhe efekt financiar.

Tema 2 - Zbatimi i rekomandimeve të raportit “Administrimi i programit për trajtimin mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike dhe vlerësimi i rezultateve”

Programi për trajtimin mjekësor jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike (më tutje Programi) jep të drejtën për trajtim të barabartë për secilin qytetar në rastet kur një shërbim i tillë nuk mund të ofrohet brenda Institucioneve Shëndetësore Publike. Përmes buxhetit të vendit nën menaxhimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore për tri vitet 2017 deri më 2019 janë dhënë rreth 28 milionë € të destinuar për këtë program.

Mesazhi i auditimit: *Auditimi përcjellës tregon se nga katër rekomandimet e dhëna, dy prej tyre janë zbatuar kurse dy kanë zbatim të pjesshëm nga Fondi i Sigurimeve Shëndetësore. Megjithatë Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar nuk kanë vlerësuar rezultatet e këtij programi për më tepër, në planet e tyre të investimeve nuk e kanë trajtuar nevojën për të ulur kërkesën për trajtim të pacienteve jashtë Institucioneve Shëndetësore publike.*

Aplikacioni softuerik për regjistrimin/përpunimin dhe menaxhimin e të dhënave të aplikuesve është krijuar dhe është duke u përdorur nga personeli në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore. Komisioni për Vlerësimin Mjekësor posedon listën e vlerësimit të aplikacioneve për rastet jo emergjente. Bordi Ekzekutiv shqyrton aplikacionet me kohë sipas udhëzimit administrativ në të cilin janë përfshirë llojet e sëmundjeve dhe çmimores për referim jashtë institucioneve shëndetësore publike, mirëpo nuk raporton në baza të rregullta-tremujore. Ndërsa, çmimorja së bashku me llojet e sëmundjeve nuk është përditësuar nga viti 2017 përkundër se në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës në vazhdimësi janë bërë investime në infrastrukturë, burime njerëzore që kanë mundur të ndikojnë në rritjen e trajtimeve si dhe çmimet mund të kenë pësuar ndryshime.

Po ashtu, Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar nuk kanë ndërmarr ndonjë veprim lidhur me vlerësimin e rezultateve të këtij programi. Për më tepër, edhe gjatë planifikimit të burimeve njerëzore dhe investimeve në infrastrukturë fizike nuk e kanë trajtuar nevojën për të ulur kërkesën për trajtim të pacienteve jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike.

Tema 3 - Transparenca dhe llogaridhënia në procesin e financimit të organizatave jo-qeveritare

Organizatave jo-qeveritare veprojnë në promovimin e zhvillimit lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar dhe përmes shërbimeve që ofrojnë ato ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve shoqërore, individuale, grupore ose më gjerë. Ato kanë ndikim në fusha të ndryshme si: të drejtat e njeriut, arsim, shëndetësi, qeverisje, mbrojtjen e të varfërve, etj. Institucionet përgjegjëse financuese duhet të sigurojnë një proces të financimit të organizatave jo-qeveritare i cili duhet të menaxhohet mirë, të ofrojë transparencë të plotë, është konkurrues dhe zbatimi i projekteve dhe programeve të organizatave jo-qeveritare i përgjigjet prioriteteve dhe të arrij qëllimet e synuara të institucioneve publike.

Mesazhi i auditimit: *Auditimi ka gjetur se Zyra e Kryeministrit, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit si dhe Komuna e Prishtinës, gjatë procesit të financimit të organizatave jo-qeveritare kanë anashkaluar procedurat dhe kriteret për financim.*

Kishte raste kur financimi i organizatave jo-qeveritare është bërë pa ndonjë vlerësim real dhe vetëm me vendime të udhëheqësve. Organizatat jo-qeveritare janë përkrahur nga më shumë se një burim i financimit publik për projektin e njëjtë nga Institucionet publike. Një çështje me theks të veçantë është dështimi në vlerësimin e rezultateve për projektet e financuara si pasojë e mungesës së monitorimit të projekteve. Institucionet Publike nuk kanë arritur të përcjellin/monitorojnë ecurinë e projekteve dhe të dëshmojnë mbi këto përcjellje. Zyrat financuese në Zyrën e Kryeministrit dhe në drejtoritë përkatëse të Ministrisë e Kulturës Rinisë dhe Sportit nuk kanë pasqyruar të dhënat e financimit përmes raporteve vjetore. Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit nuk ka bërë përpjekje që të bëjë publikimin e të dhënave mbi financimet e projekteve të organizatave jo-qeveritare në web-faqe dhe të bëjë menaxhimin e bazë së të dhënave në nivel të kënaqshëm.

Tema 4 - Parandalimi dhe reagimi ndaj situatave emergjente: Vërshimet

Menaxhimi i emergjencave kërkon një organizim të mirë institucional në aspektin e gatishmërisë për parandalimin apo reagimin ndaj situatave të jashtëzakonshme. Reagimi ndaj rasteve emergjente paraqet një varg aktiviteteve sfiduese që duhet të ndërmerren nga institucionet shtetërore. Situatat e jashtëzakonshme dallojnë nga përmasat, shkaqet dhe pasojat, kështu që kërkojnë një përgatitje dhe reagim institucional të organizuar mirë. Cikli i menaxhimit të emergjencave tregon se gatishmëria e mirë për emergjencat është një proces i vazhdueshëm. Gjithashtu sqaron faktin se kur ndodh ndonjë fatkeqësi, reagimi i shpejtë është thelbësor për të minimizuar dëmet njerëzore dhe materiale. Bazuar në përvojat e më hershme pas çdo gjendje jo të zakonshme vjen periudha e rimëkëmbjes dhe e rikthimit të ekonomisë apo sektorëve të prekur, në gjendjen e mëparshme.

Mesazhi i auditimit: *Auditimi ka konstatuar se institucionet përgjegjëse në nivelin qendror dhe atë lokal, nuk kanë arritur të krijojnë një sistem të përshtatshëm i cili siguron në mënyrë efektive parandalimin dhe reagimin ndaj situatave emergjente të vërshimeve/përmytjeve në Republikën e Kosovës.*

Raporti thekson se dokumentet strategjike nuk janë përditësuar duke mos i marrë parasysh ndryshimet dhe nevojat e palëve të përfshira në menaxhimin e situatave emergjente. Gjithashtu, dokumenti i vlerësimit të rrezikut në nivel vendi nuk është përditësuar që nga vitit 2016 dhe të dhënat historike mbi fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera nuk janë të plota. Mungon monitorimi i aktiviteteve të parandalimit dhe matjes së performancës të Njësisë Profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtim. Niveli qendror dhe lokal nuk kanë arritur të sigurojnë burimet njerëzore dhe teknike të mjaftueshme për reagim ndaj situatave emergjente/vërshimet.

Tema 5 – Vlera për para në Prokurimet e centralizuara – pjesa e dytë

“Vlera për para në prokurimin e centralizuar, pjesa e dytë” është vazhdim i auditimit të vitit 2018 me të njëjtin emër. Qëllimi i këtij auditimi ishte që të vlerësojë se a është arritur vlerë për para në prokurimet e centralizuara, pra a janë arritur kursime buxhetore dhe a ka nxjerrë mësim Agjencia Qendrore e Prokurimit nga përvoja me prokurimet e para të centralizuara.

Mesazhi i auditimit: *Në prokurime të centralizuara ka vlerë për para, mirëpo ka nevojë edhe për disa përmirësime në proces prandaj Agjencisë Qendrore të Prokurimit i janë adresuar gjashtë rekomandime.*

Agjencia Qendrore e Prokurimit përmes aktiviteteve të prokurimit të centralizuar iu kishte kursyer organizatave buxhetore 2.5% të fondeve të ndara për prokurimin e mallrave të caktuara. Megjithatë, përveç kursimeve prej 477 mijë €, Agjencia Qendrore e Prokurimit do të mund të kishte kursyer afër 514 mijë € sikur e gjithë sasia e furnizuar me kontrata të centralizuara do të blihej me çmimet më të ulëta të artikujve përkatës të kontratave individuale. Me këtë, kursimet totale që do të rezultonin nga prokurimi i centralizuar do të arrinin mbi një milion € që përbën mbi 5% të buxhetit të shpenzuar vetëm për tri kontrata të centralizuara.

Për më tepër, Agjencia Qendrore e Prokurimit kishte mangësi në komunikim me shfrytëzuesit e paraparë të kontratave të centralizuara që për pasojë kishte rezultuar me mbivlerësimin ose nënvlerësimin të nevojave të cilat ishin bërë shkak për realizimin e tyre të ulët ose të tepërt. Mangësi kishte edhe në monitorimin e kontratave të centralizuara nga Agjencia Qendrore e Prokurimit. Mungesa e një monitorimi efektiv ishte bërë shkak që Agjencia Qendrore e Prokurimit të mos ndërmarrë veprime korigjuese kur kontratat nuk ishte duke u zbatuar ashtu siç ishin paraparë.

Agjencia Qendrore e Prokurimit nuk kishte bërë një analizë të mirëfilltë të efekteve të prokurimit të centralizuar për të konstatuar se a po rezultojnë me kursime apo me shpenzime shtesë. Kjo për shkak se nuk kishte bërë hulumtim të duhur të tregut që do t'i siguronte Agjencisë çmime referuese me të cilat do të krahasoheshin çmimet e kontratave të centralizuara.

Tema 6 - Vlera për para për ndërtimin e rrugëve rajonale dhe lokale – [DRAFT para komenteve në organizatë]

Duke pasur parasysh se ndërtimi i rrugëve merr një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve për investime kapitale, Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin me titull “Vlera për para në ndërtimin e rrugëve lokale dhe rajonale”, për të vlerësuar se a është arritur vlerë për para. Në këtë auditim kemi përfshirë Ministrinë e Infrastrukturës dhe komunat Prishtinë, Prizren, Ferizaj dhe Malishevë.

Mesazhi i auditimit: *Ndërtimi rrugëve lokale dhe rajonale përcillet me mangësi të shumta duke filluar nga mungesa e studimit të fizibilitetit, planifikimi jo adekuat i aktiviteteve, buxheti i pamjaftueshëm, problemet me shpronësime, problemet me hartimin e projekteve kryesore dhe paqartësi përpara i përket referimit në standarde të ndërtimit të rrugëve.*

Për pasojë, ndërtimi i rrugëve ishte përcjellë me vonesa deri në tri vite e disa kishin mbetur papërfunduar edhe pesë vite pas fillimit të tyre. Prandaj në këto rrethana nuk është siguruar vlera më e mirë për para.

Planifikimi i aktiviteteve që ndërlidhen me ndërtimin e rrugëve nuk ishte adekuat, nuk ishin plotësuar të gjitha parakushtet për dhënie të kontratës (shpronësimet), aktivitetet e prokurimit nuk ishin nisur në kohë të përshtatshme. Entitetet e audituara nuk kishin buxhetuar fonde të mjaftueshme për të siguruar zbatimin e pandërprerë të kontratave. Subjektet e audituara kishin pranuar projekte kryesore që kishin mangësi dhe për pasojë, shumica e tyre ishin modifikuar pas fillimit të punëve në rrugë. Rrugët e ndërtuara, edhe pse i përkisnin kategorisë së njëjtë, për nga dizajni dhe struktura ishin të ndryshme për shkak se subjektet e audituara nuk kishin një standard të cilit do t'i referoheshin në mënyrë që rrugët të jenë uniforme. S’kishte as studime të fizibilitetit e në mungesë të të cilave ishin ndërtuar disa rrugë që kishin dhënë pak vlerë për paratë e shpenzuara. Për përmirësimin e këtyre çështjeve kemi dhënë 5 rekomandime për Ministrinë dhe komunat.

Tema 7 - Mbledhja, trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave komerciale

Mbeturinat janë substanca apo objekt për hedhje, të cilat mund të riciklohen apo ripërpunohen. Menaxhimi i tyre është i rëndësishëm së veçantë pasi që ndikon në mjedis të pastër dhe siguri për shëndetin e popullatës.

Mesazhi i auditimit: *Menaxhimi mbeturinave vazhdon të mbetet sfida për institucionet në vend. Grumbullimi, transportimi, riciklimi, ripërpunimi dhe deponimi i tyre ka ndikim në jetën e qytetareve. Nëse nuk trajtohen si duhet ato mund të kontaminojnë tokën, ujin dhe ajrin.*

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, komuna e Ferizajt dhe Fushë Kosovës nuk kanë arritur të krijojnë kushte për ndarjen dhe trajtimin e mbeturinave. Po ashtu, Kompanitë Regjionale të Mbeturinave gjatë grumbullimit nuk i ndajnë mbeturinat sipas katalogut shtetëror për mbeturina dhe një gjë e tillë nuk bëhet as nga Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë gjatë deponimit të tyre. Mbrojtja e mjedisit është e rrezikuar pasi që deponitë sanitare dhe stacionet e transferit vazhdojnë të mos kenë leje të integruara. Edhe pse procesi i marrjes së lejes së integruar ka filluar nga vitit 2012 e cila lëshohet nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ky proces deri në prill të vitit 2021 nuk ka përfunduar dhe tregon se deponitë sanitare dhe stacionet e transferit vazhdojnë të deponojnë mbeturina pa i plotësuar kushtet për të mbrojtur tokën, ujin dhe ajrin.

Tema 8 - Projektet e Financuara nga Granti i Performances Komunale - DEMOS

Në vitin 2017, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) u pajtuan për krijimin dhe financimin e një sistemi gjithë-kombëtarë të Grantit të Performancës Komunale. Për vitet 2018-2021, Granti ka në dispozicion buxhetin prej nëntë milionë €. Në vitin 2019, Qeveria Suedeze përmes SIDA (Swedish International Development Cooperation) vendosi që t'i bashkohet këtij Granti me 504,413 €. Të gjitha (38) komunat e Kosovës gëzojnë të drejtën e aplikimit për grantin e performancës.

Mesazhi i auditimit: *Granti i Performancës Komunale në përgjithësi i ka ndihmuar komunat në arritjen e objektivave strategjike dhe ka arritur qëllimin e tij kryesor, duke ofruar shërbime komunale më të mira për qytetarët.*

Mirëpo, pavarësisht që Granti i Performancës Komunale ka arritur qëllimin e synuar, komunat duhet të përmirësohen në disa aspekte të menaxhimit të këtij Granti. Komunat ende nuk kanë një proces standard të pranimit të kërkesave nga qytetarët, shqyrtimit të tyre dhe prioritizimit të nevojave për investim. Po ashtu, disa projekte nuk kanë arritur të përfundohen me kohë për arsye siç janë: iniciimi me vonesë i procedurave të prokurimit, mos ofrimi kushteve të përshtatshme të punës për Operatorët Ekonomik dhe papërgjegjshmëria e Operatorëve Ekonomik ndaj kontratës. Andaj, procesi i menaxhimit të kontratës duhet të monitorohet dhe forcohet më tepër për të maksimizuar rezultatet e synuara.

Tema 9 - Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të vitit 2017

Gjatë vitit 2020 Zyra Kombëtare e Auditimit ka shqyrtuar progresin gjegjësisht të arriturat e institucioneve publike në procesin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të adresuara gjatë vitit 2017. Raporti ka përfshirë gjashtë fushat kryesore të zhvillimit ekonomik-social; gjyqësorin, prokurimin publik, administratën publike, zhvillimin ekonomik, arsimin dhe shëndetësinë.

Ky vlerësim është arritur përmes pyetësorëve të dërguar në 35 institucione të audituara duke u bazuar në temat e ndryshme të trajtuara në shtatë raporte të auditimit të performancës.

Mesazhi i auditimit: *Niveli i zbatimit të rekomandimeve audituese nuk është i kënaqshëm. Të dhënat e raportit sinjalizojnë për një nivel të ulët të zbatimit të rekomandimeve dhe kërkojnë angazhim dhe përkushtim më të madh të autoriteteve përgjegjëse për përmirësimin e proceseve të tyre të punës përmes vendimeve dhe*

aktiviteteve të ndërmarra. Po ashtu, ngritja e llogaridhënës së institucioneve publike paraqitet si një domosdoshmëri për bashkëpunim dhe angazhim më efikas ndërinstitucional.

Në bazë të konfirmimeve dhe dokumenteve mbështetëse, ky vlerësim nxjerrë në pah se nga 74 rekomandimet e dhëna/vlerësuara, 59% e rekomandimeve cilësohen si të zbatuara apo në proces (36% e tyre ishin zbatuar, 10 ishin në fazën finale, ndërsa 13% cilësohen në fazën që të paktën kanë filluar zbatimin). Rekomandimet e pazbatuara marrin pjese me 10% në numrin total të rekomandimeve të vlerësuara dhe për 31% të rekomandimeve nuk kemi pranuar përgjigje/informata.

Auditimet e Teknologjise se Informacionit

Tema 10 - Sistemet elektronike për menaxhimin e granteve dhe subvencioneve në AZhB-MBPZhR

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë është në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e cila ka rol ekzekutiv me qëllim të zbatimit të programeve për mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Me qëllim të menaxhimit dhe realizimit sa më të mirë të proceseve të punës për mbështetje financiare të fermerëve kosovarë, qoftë përmes granteve apo subvencioneve bujqësore, Agjencia ka zhvilluar disa sisteme të informacionit.

Mesazhi i auditimit: *Aplikacionet që ka në shfrytëzim Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë nuk i përmbajnë standardet e kërkuara që të menaxhojnë në mënyrë efektive proceset për shpërndarjen e granteve dhe subvencioneve bujqësore.*

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë nuk kishte të hartuar planin strategjik apo strategjinë të teknologjisë së informacionit, politikat dhe procedurat e teknologjisë së informacionit të cilat do të përcaktonin se si teknologjia e informacionit do të mbështeste nevojat e institucionit. Si pasojë nuk kishte bërë shpërndarjen e burimeve financiare dhe njerëzore sipas nevojave të saj dhe kishte krijuar varësi nga palët e treta duke rrezikuar disponueshmërinë, integritetin dhe besueshmërinë e proceseve të teknologjisë së informacionit.

Në aplikacionet që përdorte Agjencia nuk kishte të vendosura kontrole për t'u siguruar që ato pranojnë vetëm të dhëna të autorizuara, të sakta dhe të plota. Si pasojë, bazat e shënimeve përmbanin të dhëna jo të sakta, po ashtu kishte ndikuar në punë shtesë për përdoruesit e aplikacioneve pasi që secili duhej që vazhdimisht dhe në mënyrë të përsëritur t'i verifikonte të dhënat nëse janë të sakta duke shkaktuar mungesë efikasiteti në punën e tyre.

Po ashtu, mangësi janë vërejtur edhe në sigurinë e sistemeve të informacionit të cilat rrezikojnë që infrastruktura dhe sistemet të jenë të pasigurta dhe të cenueshme kundrejt gabimeve dhe keqpërdorimeve të mundshme. Ekziston rreziku që të ndryshohen të dhënat e ruajtura në bazat e të dhënave pa u identifikuar, pasi që nuk kishte një konfigurim adekuat të mbledhjes, trajtimit dhe ruajtjes së gjurmëve të aktiviteteve në bazat e të dhënave.

Tema 11 - Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës

Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës kanë obligime kushtetuese dhe ligjore për të siguruar sistem efikas të drejtësisë, të drejtë dhe njëkohësisht për të siguruar transparencë dhe përgjegjësi në punën e vet. Këto institucione kanë zhvilluar Sistemin për Menaxhimin e Informativ të Lëndëve për të rritur efikasitetin në procedurat dhe afatet kohore në zgjidhjen e lëndëve, sigurimin e statistikave të sakta dhe me kohë, si dhe shërbime me të mira për qytetarët.

Mesazhi i auditimit: KGJK-ja dhe KPK-ja kanë bërë përparim të vazhdueshëm në SMIL, por pavarësisht kësaj rezultatet e auditimit kanë treguar që ende janë disa mangësi dhe nuk është realizuar shtrirja e plotë e zbatimit të këtij sistemi në të gjitha instancat në gjykata dhe prokurori.

Shpërndarja automatike e lëndëve në gjykatë dhe prokurori, ndërveprimi i SMIL-it të prokurorisë dhe gjykatës për të gjitha shkresat dhe raportet statistikore me tregues të avancuar janë disa nga zhvillimet që duhet të finalizohen plotësisht. Përveç këtyre, ende nuk është hartuar strategjia e teknologjisë së informacionit në KGJK dhe procedurat standarde të operimit nuk kanë arritur të zbatohen plotësisht në KPK.

Këto mangësi mund të ndikojnë në administrimin jo të mirë të SMIL-it dhe pasqyrimin jo të saktë të efikasitetit, transparencës dhe planifikimit të burimeve të nevojshme në gjykata dhe prokurori.

Në 11 raportet e auditimit të performancës dhe teknologjisë së informacionit, Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë 125 rekomandime për përmirësimin e aspekteve të ndryshme në administratën publike.

Rekomandojmë Kuvendin e Kosovës që:

Përmes Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike, Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe komisioneve tjera parlamentare për fusha përkatëse, të shqyrtoj raportet e auditimit të performancës dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të mbajtur llogaridhënës krrerët e institucioneve publike për zbatimin e rekomandimeve.

Rekomandojmë Qeverinë, kuvendet komunale dhe organet drejturse/qeverisëse të subjekteve të audituara që:

Të sigurojnë së janë përgatitur planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve që dalin nga auditimi i performancës dhe janë krijuar mekanizma për monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të këtyre planeve, duke caktuar dhe mbajtur përgjegjës funksionet përkatëse në organizatë dhe duke siguruar raportim të rregullt.

18. Ndërmarrjet Publike

ZKA-ja këtë sezone ka audituar 12 Ndërmarrje Publike (NP) për PFV-të e vitit 2020. Këto NP ishin subjekt i auditimit nga ZKA-ja edhe vitin paraprak dhe shumica e tyre për disa vite me radhe.

Auditimi ka nxjerrë në pah se sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrolli i brendshëm i tyre ka nevojë për përmirësime të dukshme. Fakti që në 10 prej 12 NP-ve të audituara kishin gabime materiale dhe ka rezultuar që opinioni të jetë i modifikuar, tregon për cilësinë jo të mirë të sistemeve financiare në NP-të dhe mangësitë në raportimin financiar dhe transparencën lidhur me menaxhimin e fondeve dhe të pasurive publike.

Edhe këtë vit NP-të janë përcjellë me mangësi të njëjta sikurse vitet e kaluara. Mangësi më të shpeshta ishin mos instalimi i një mekanizmi të qeverisjes së mirë i cili do t'i kontribuonte zbatimit të politikave efektive që sigurojnë se objektivat janë duke u arritur në mënyrë ekonomike dhe efikase.

Pastaj, dobësitë: mos ndarja e detyrave, auditime të brendshme jo efektive, mos publikimi i rregulloreve, raporteve për qëllime transparence, dhe gabime në PFV, tregojnë për domosdoshmërinë e reformave dhe ristrukturimeve të thella në NP-të që ishin objekt i auditimeve nga ZKA-ja.

Proceset ekzistuese të përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore nuk ishin adekuate. Ato nuk përmbajnë analiza të mjaftueshme dhe nuk marrin në konsideratë rreziqet të cilat mund të ndodhin dhe të rrezikojnë NP-të në arritjen e objektivave të përcaktuara për të prezantuar gjendjen e saktë dhe të drejtë të transaksioneve, zërave dhe pasqyrave financiare.

Për të përmirësuar mënyrën aktuale të menaxhimit të Ndërmarrjeve Publike, kemi dhënë një numër të rekomandimeve për përgatitjen e PFV-ve dhe forcimin e kontroleve të brendshme, të cilat janë prezantuar në raportet individuale të auditimit dhe janë adresuar tek personat e ngarkuar me përgjegjësi menaxhuese të NP-ve dhe tek aksionaret e tyre.

18.1 Opinione të auditimit për Ndërmarrjet Publike

Në tabelën në vijim është dhënë një pasqyre e opinionëve të dhëna për PFV-të e vitit 2020 dhe 2019 të audituara nga ZKA-ja.

Tabela 34 - Opinione të dhëna për NP-të të audituara për vitin 2020 dhe 2019

Nr.	Ndërmarrjet e Audituar	Opinion i Auditimit 2020	Opinion i Auditimit 2019
1	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë sh.a.	I pamodifikuar	I kualifikuar
2	Ndërmarrja e Re Energjetike e Kosovës sh.a (NREK sh.a)	I pamodifikuar me theksim të çështjes	I pamodifikuar me theksim të çështjes
3	Hekurudhat e Kosovës Trainkos sh.a.	I kualifikuar	I kualifikuar
4	KRU Hidroregjioni Jugor sh.a	I kualifikuar	I kundërt
5	Posta e Kosovës sh.a	I kundërt	I kundërt
6	Telekomi i Kosovës sh.a	I kundërt	I kundërt
7	KRU Prishtina sh.a.	I kundërt	I kundërt
8	KRM Pastrimi sh.a	I kundërt	I kundërt
9	KRU Drini i Bardhe sh.a.	I kundërt	I kundërt
10	KRU Bifurkacioni sh.a	I kundërt	I kundërte
11	KRU Hidromorava sh.a	I kundërt	I kualifikuar
12	Hortikultura sh.a. Prishtinë	I kundërt	I kualifikuar

Parregullsitë e identifikuar gjatë auditimit të cilat kanë shkaktuar modifikimin e opinionit apo theksimin e çështjes, kanë të bëjnë me shkaqet si në vijim:

- **Opinion i pamodifikuar** - ishte dhënë vetëm për Kompaninë e Menaxhimit të Deponive në Kosovë sh.a, e cila kishte prezantuar PFV-të pa gabime materiale.
- **Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes** - ishte dhënë për NREK sh.a për shkak që ekzistojnë pasiguri materiale të cilat mund të shkaktojnë dyshime të rëndësishme për aftësinë e Ndërmarrjes, për të vazhduar në vijimësi dhe rrjedhimisht ajo mund të mos jetë në gjendje të realizojë aktivitetet e saj dhe të shlyejë detyrimet gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë. Investitori i projektit Kosova e Re kishte deklaruar tërheqjen e tij nga ndërtimi i termocentralit Kosova e Re dhe kishte paditur qeverinë e Kosovës në Gjykatën e Arbitrazhit.
- **Opinionet e kualifikuara** - janë dhënë [Hekurudhat e Kosovës – Trainkos sh.a, dhe KRU Hidroregjioni sh.a] për shkak të mos **rivlerësimit** të pasurive jo qarkulluese për me gjatë se pesë vite respektivisht që nga korporatizimi i tyre në vitin 2007, kur ishin nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Të hyrat e shtyra nga granti janë mbivlerësuar në PFV-të, Llogaritë e pagueshme tregtare janë mbivlerësuar, vlerat e prezantuara të pasurive në PFV-të nuk ishin të sakta, shpenzimet e zhvlerësimit dhe rezervat e rivlerësimit ishin nënvlerësuar si dhe shënimet shpjeguese që nuk ishin të plota dhe të sakta..
- **Opinionet e Kundërta** – janë dhënë [KRU Drini i Bardhë sh.a, KUR Prishtina sh.a, KRU Hidromorava sh.a, KRU Bifurkacioni sh.a, Posta e Kosovës sh.a, Telekom i Kosovës sh.a, Hortikultura sh.a, dhe KRM Pastrimi sh.a] për shkak të pasaktësive materiale në prezantimin e pasqyrave financiare, konkretisht për zërat dhe informacionet lidhur me: llogaritë e arkëtueshme, llogaritë e pagueshme, pasuritë jo qarkulluese, prona, pajisjet dhe impiantet, investimet në vijim, stoku, të hyrat e shtyra nga grantet, pasuritë tjera afatshkurtra, mbivlerësimi i të hyrave nga qiraja, detyrimet tjera afatshkurtra, llogaritë e pagueshme tregtare, të hyrat, rrjedha e parasë sipas aktiviteteve (operative dhe investuese), shpalosje e pamjaftueshme e hipotezës se vijimësisë, pasqyra e ndryshimeve në ekuitet si dhe shënimet shpjeguese nuk ishin të plota dhe të sakta.

Rekomandimet për Bordet Drejtuese dhe Aksionarët e Ndërmarrjeve

- Bordet e Drejtorëve të NP-ve përkatëse duhet të analizojnë shkaqet të cilat kanë ndikuar tek Modifikimi i Opinionit dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme që këto shkaqe të korrigjohen dhe parandalohen. Të sigurojnë se janë vendosur procese dhe kontrole efektive që konfirmojnë se hartimi i PFV-ve i adreson mangësitë e identifikuar në vitin paraprak; dhe
- Aksionarët të mbajnë përgjegjës Bordet e Drejtorëve të NP-ve përkatëse dhe të kërkojnë llogari që përgatitja e PFV-ve të jetë e drejtë dhe korrekte e që do të rezultonte me Opinione të pamodifikuara për ndërmarrjet respektive.

18.2 Rekomandimet e vitit paraprak dhe niveli i zbatimit

NP-të që janë audituar nga vitet e mëhershme nga ZKA-ja në vazhdimësi (nga viti në vit) kanë numër me të vogël të rekomandimeve dhe njëkohësisht kanë një nivel me të lartë të zbatimit të tyre (me ndonjë përjashtim të rrallë).

Tabela më poshtë ofron të dhëna në detaje për numrin e rekomandimeve të zbatuara, në proces të zbatimit apo të pazbatuara për secilën ndërmarrje veç e veç, nga rekomandimet e vitit 2019.

Tabela 35 - Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të jashtëm për vitin 2019

Nr.	Subjektet e audituara	Numri i rekomandimeve	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	I mbyllur i pazbatuar	Të pazbatuara
1	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë sh.a.	9	9			
2	Hortikultura sh.a. Prishtinë	6	4	2		
3	Hekurudhat e Kosovës Trainkos sh.a.	10	5			5
4	KRU Hidroregjioni Jugor sh.a.	11	6	4		1
5	Posa e Kosovës sh.a	25	18	2		5
6	Telekomi i Kosovës sh.a	36	16	4		16
7	KRU Prishtina sh.a.	36	9	3	2	22
8	KRM Pastrimi sh.a	44	24			20
9	Drini i Bardhe sh.a.	20	13	1		6
10	KRU Bifurkacioni sh.a	34	22	4		8
11	KRU Hidromorava sh.a	11	6	1		4
12	Ndërmarrja e Re Energjetike e Kosovës sh.a ³¹	2	1			1
	Gjithsej rekomandimet	244	133	21	2	88

Nga tabela më lartë shihet se, rekomandimet e dhëna në vitin 2019 kishin status: 54% janë zbatuar, 9% janë në proces të zbatimit, 1% ishin mbyllur të pazbatuara dhe 36% edhe me tutje nuk janë zbatuar.

Ndërsa situata një vit me herët (rekomandimet e vitit 2018 të zbatuara gjatë vitit 2019) ishte si në vijim: 41% prej tyre ishin zbatuar, 12% ishin në proces të zbatimit, 9% ishin mbyllur të pazbatuara dhe 38% prej tyre edhe me tutje nuk ishin zbatuar.

Rekomandimet për Aksionarët

- Aksionarët duhet të sigurojnë që Bordet e Drejtorëve të ndërmarrjeve publike të audituara përgatisin plane cilësore të veprimit dhe sigurojnë zbatimin e plotë të tyre me qëllim të rritjes së shkallës së zbatimit të rekomandimeve të auditimit. Aksionarët poashtu duhet të sigurojnë që BD-të dorëzojnë së paku dy herë në vit raporte të progresit lidhur me zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

18.3 Prokurimet në ndërmarrjet publike

Procesi i prokurimit edhe te NP-të duhet të zbatohet sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Ligjin e Prokurimit Publik në Kosovë.

Rezultatet e auditimit kanë treguar se kontrollet ekzistuese në fushën e prokurimit publik te ndërmarrjet publike përcillen me mangësi në të gjitha fazat. Të gjitha çështjet e ngritura në këtë fushë, janë paraqitur në detaje në raportet individuale të auditimit, por në mënyrë përmbledhëse, po i paraqesim edhe në tabelën në vijim.

Tabela 36 - Çështjet kryesore të cilat janë identifikuar gjatë auditimit të Ndërmarrjeve Publike

³¹ Ndërmarrja e Re energjetike e Kosovës është themeluar nga qeveria në vitin 2018 ndërsa ka filluar me operuar nga viti 2019

Çështja	Shkaku	Ndikimi	Veprimet e kërkuara nga menaxhmenti
Lidhja e kontratave jo sipas udhëzuesve të KRPP-së (KRU Hidromorava)	Kjo kishte ndodhur nga mungesa e kontrolleve të brendshme të kompanisë në zbatimin e procedurave të prokurimit në lidhjen e kontratave.	Lidhja e kontratave jo sipas udhëzimeve të KRPP-së rrezikon dëmtimin e buxhetit të kompanisë duke paguar më shumë se sa çmimi i kontratave.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, se janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për korrigjimin në regjistra kontabël dhe gjithashtu lidhja e kontratave të bëhet vetëm sipas udhëzuesve të KRPP-së.
Vonesa në realizimin e projekteve kapitale (KRU Hidromorava)	Sipas menaxherëve të kontratës vonesat janë si pasojë e thatësisë që ishte përballur komuna e Gjilanit (që ishte shpallë gjendje e emergjencës). Po ashtu, furnizimin me gypa, sipas marrëveshjes, do ta bënte donatori (CDI), i cili ishte vonuar në furnizimin me gypa të ujësjellësit.	Mos përfundimi i projekteve kapitale sipas afateve kohore, ndikon potencialisht në hyrje në obligime dhe implikime financiare që mund të dalin nga zgjatja e afateve kohore.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë që të ndërmerren veprimet e nevojshme në menaxhimin dhe realizimin e projekteve për investime kapitale, në mënyrë që ekzekutimi i punëve të realizohet brenda afateve të parapara kohore.
Prokurime të shpeshta me vlera minimale (KRU Hidromorava)	Ndarja e kërkesave ka rrjedhur si rezultat i mos identifikimit të nevojave për furnizime me kohë dhe planifikimit të dobët dhe jo të duhur të sasisë për këto furnizime.	Aplikimi i shumë procedurave me vlerë minimale për artikujt e njëjtë mund të rezultojë me kosto më të lartë për këto furnizime krahasuar me aplikimin e procedurave tjera të zhvilluara në konkurrencë të hapur.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, se bëhet identifikimi i nevojave për furnizime nga të gjitha njësitë kërkuese dhe të njëjtat përfshihen në planin vjetor të prokurimit. Përpilimi adekuat i planeve për furnizime ndihmon në zhvillimin e procedurave adekuate dhe shtim të vlerës për para.
Nënshkrimi i kontratës për furnizim pa siguri të ekzekutimit (Hortikultura Sh.a.)	Bazuar në konfirmimet zyrtare, siguria e ekzekutimit nuk është dorëzuar në kohën e duhur, para nënshkrimit të kontratës për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid 19. Mirëpo, në Njoftimet e KRPP-së të datës 30.03.2020 dhe 21.04.2020 për Autoritetet kontraktuese lidhur me masat lehtësuese në zhvillimin e procedurave tenderuese dokumenti –siguria e ekzekutimit nuk është përfshirë në këto dy njoftime.	Në rastet e mos realizimit së kontratës Kompania në mungesë të sigurisë së ekzekutimit mund të përballët me shpenzime shtesë, dhe mos të arrijë të marr kompensimin e dëmeve të mundshme të shkaktuara nga mos përmbushja e saj.	Bordi i Drejtorëve të rishikojë, arsyet për dështimin e kontrolleve dhe të marrë masa dhe veprime për forcimin e tyre, në mënyrë që kontratat të nënshkruhen në përputhje të plotë me kërkesat ligjore të prokurimit publik.

<p>Mos përfshirja e të gjitha prokurimeve në planin përfundimtar vjetor të prokurimit dhe mos detajimi i planit</p> <p>(KRU Bifurkacioni)</p>	<p>Kjo kishte ndodhur si rrjedhojë e mos parashikimit të nevojave në kohën e përgatitjes së planit vjetor të prokurimit dhe po ashtu edhe për shkak të mos detajimit të kërkesave nga njësitë kërkuese.</p>	<p>Mos përfshirja e disa projekteve në planin vjetor pamundëson përcjelljen e afateve të paracaktuara, mund të shkaktojë procedura dhe kosto shtesë për kryerjen e aktiviteteve të prokurimit dhe të mos arrihet vlera e synuar për parane.</p>	<p>Bordi i Drejtorëve të sigurojë se njësia e prokurimit dhe njësitë kërkuese, koordinohen gjatë hartimit të “Planit Përfundimtar Vjetor të Prokurimit”, duke mundësuar përgatitjen e një plani të detajuar për secilin produkt, shërbim, punë si dhe të eliminohet çfarëdo nevojë për prokurime jashtë planit.</p>
<p>Ndarja e tenderëve për furnizime/shërbime të njëjta/ndërlidhura</p> <p>(KRU Bifurkacioni)</p>	<p>Kjo kishte ndodhur edhe përkundër faktit se njësitë kërkuese janë informuar me kohë për evidentim të saktë të kërkesave ashtu që të mund të shmangen mundësitë për ndarje të tenderëve, ndërsa në disa raste ndarja e tillë ka ndodhur për shkak të paraqitjes së nevojave të paparashikuara në terren për furnizime/shërbime.</p>	<p>Ndarjet dhe shmangiet e procedurave të përshtatshme të prokurimit reflektojnë me mungesë transparence dhe kufizim të konkurrencës, duke rrezikuar edhe aspektin kualitativ të furnizimeve të pranuar për parane e shpenzuar.</p>	<p>Bordi i Drejtorëve të sigurojë një planifikim të drejtë dhe të saktë, duke evituar çfarëdo ndarje të aktiviteteve të njëjta të prokurimit, ashtu që të sigurohet blerje efektive dhe të mundësohet në këtë formë respektimi i kërkesave ligjore për parane e shpenzuar.</p>
<p>Blerje pa procedura të prokurimit</p> <p>KRU Drini i Bardhë Sh.a.</p>	<p>Këto blerje kanë ndodhur si rezultat i mosfunksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme në procesin e planifikimit dhe realizimit të blerjeve të mallrave dhe shërbimeve.</p>	<p>Blerja e mallrave dhe shërbimeve duke anashkaluar procedurat e prokurimit rrezikon që Kompania të dëmtoj buxhetin dhe të mos arrij vlerën për parane e shpenzuar si dhe ndikon në kufizimin e konkurrencës.</p>	<p>Bordi i Drejtorëve të sigurojë se është bërë një vlerësim dhe planifikim i duhur i nevojave të Kompanisë dhe në të gjitha rastet ku janë të aplikueshme, të aplikohen procedurat e prokurimit dhe të shmangen blerjet direkte nga OE.</p>
<p>Ndarje e tenderëve dhe mos aplikimi i procedurës së hapur</p> <p>(KRM Pastrimi)</p>	<p>Sipas zyrës së prokurimit, kjo ka ndodhur për shkak se nuk kanë mundur të përfshihen kërkesat që janë paraqitur pas hartimit të planit. Po ashtu, për aktivitetet brenda planit të cilat nuk janë realizuar, zyrtarja konfirmon se, nuk kanë pasur kërkesa nga njësia kërkuese.</p>	<p>Ndarja e tenderëve dhe shmangia nga procedurat e hapura e shtojnë rrezikun që Autoriteti Kontraktues nuk do të arrijë të marrë vlerën për parane e shpenzuar si dhe ndikon në kufizim të konkurrencës.</p>	<p>Bordi i Drejtorëve të sigurojë një vlerësim dhe planifikim të duhur të nevojave të ndërmarrjes dhe duke u siguruar që artikujt e ngjashëm grupohen dhe për to përdoren procedurat e prokurimit sipas kërkesave të LPP-së.</p>
<p>Planifikim jo i duhur i prokurimit</p> <p>(KRM Pastrimi)</p>	<p>Sipas zyrës së prokurimit arsyeja e mos realizimit të aktiviteteve brenda planit është mungesa e kërkesave nga njësia kërkuese. Ndërsa, përkundër përpjekjeve kundrejt njësisë kërkuese për respektim të planit, në momentin që vjen vendimi dhe zotimi i mjeteve atëherë fillohet procedura e prokurimit.</p>	<p>Nënshkrimi i kontratave që nuk janë paraparë në planin e prokurimit dhe mos zhvillimi i atyre të planifikuara, është sinjal i kontrolleve jo adekuate në ndërmarrje në procesin e prokurimit dhe kjo dukuri mund të ndikojë në keqmenaxhim të buxhetit.</p>	<p>Bordi i Drejtorëve të forcojë kontrollet e brendshme për procesin e prokurimit duke siguruar që njësitë kërkuese parashitjnë kërkesat me kohë, për t’i lejuar zyrës së prokurimit planifikimin dhe iniciimin me kohë të aktiviteteve dhe procedurave të prokurimit.</p>

Prokurimi i mallrave të përdorura (KRM Pastrimi)	Sipas arsytimit të dhëna nga zyrtarët e prokurimit, këto procedura të blerjeve të kamionëve të përdorur, ishin realizuar në mungesë të mjeteve financiare.	Prokurimi i mallrave të përdorura mund të ndikojë në cilësinë, performancën dhe funksionalitetin e mallrave të blera. Blerja e produkteve të përdorura vë në pikëpyetje cilësinë e shërbimeve/produkteve të pranuar për parandë e dhënë duke ndikuar që ndërmarrja të paguajë çmime jo konkurruese për produkte të tilla.	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që para inicimit të procedurave të prokurimit, të mos ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një apo më shumë operatorëve ekonomik. Kriteret teknike duhet të sigurojnë që procesi i vlerësimit të ofertave të jetë i barabartë dhe jo diskriminues. Përveç kësaj, duhet të siguroj që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike duke mundësuar që të merret vlera për parandë e dhënë.
--	--	---	--

18.4 Analiza e gjendjes financiare në Ndërmarrjet Publike

Në tabelë janë paraqitur treguesit kryesor të gjendjes financiare për 12 ndërmarrje publike (10 të nivelit qendror dhe dy të nivelit lokal). Subjekt i kësaj analize kanë qenë: të hyrat, shpenzimet, rezultati financiar, detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata.

Tabela 37 - Rezultati financiar dhe detyrimet e Ndërmarrjeve Publike më 31.12.2020 (në €)

Nr	Subjekti i Audituar	Të hyrat	Shpenzimet	Rezultati Financiar	Detyrimet Afatshkurtra	Detyrimet Afatgjata
1	Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës Sh.a	2,368,312	2,256,324	111,988	141,677	325,290
2	Hortikultura Sh.a	1,457,597	1,466,871	(9,274)	482,515	0
3	Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.a	4,099,843	3,869,820	230,023	1,396,591	1,397,666

4	KRU Hidroregjioni Jugor Sh.a, Prizren	5,687,631	5,632,852	54,779	2,538,143	15,307,110
5	Posta e Kosovës sh.a	11,724,170	12,701,864	(977,694)	4,062,583	0
6	Telekomi i Kosovës sh.a	51,700,000	68,283,000	(16,583,000)	73,534,000	11,900,000
7	KRU Prishtina Sh.a	17,701,999	17,274,423	427,576	4,632,241	41,213,808
8	KRM Pastrimi Sh.a	7,953,771	9,886,107	(1,932,337)	2,043,060	0
9	KRU Drini i Bardhë sh.a	379,538	394,480	(14,942)	43,888	1,581,596
10	KRU Bifurkacioni sh.a	2,501,168	2,473,026	28,142	150,235	3,035,740
11	KRU Hidromorava sh.a	2,629,816	2,552,219	77,597	275,203	5,609,514
12	Ndërmarrja e Re Energjetike e Kosovës	300,000	120,742	179,258	1,864	0

Të hyrat e realizuara nga ndërmarrjet e audituara në vitin 2020 janë në shumën 108,503,844 €, kurse totali i shpenzimeve është në shumën 124,622,219 €. Pesë (5) ndërmarrje publike kishin prezantuar rezultat negativ financiar që në total paraqesin humbje prej 19,505,305 €, ndërsa shtatë ndërmarrjet tjera kishin prezantuar rezultat pozitiv financiar me një fitim total prej 1,109,359 €. Pjesën më të madhe të humbjeve e përbënë Telekomi i Kosovës sh.a në shumën 16.6 milionë €.

Tabela më lartë prezanton shifra shqetësuese për stabilitetin financiar të këtyre ndërmarrjeve. Ato, të gjitha së bashku, kanë mbi 89,3 milionë € detyrime afatshkurtra dhe 80,3 milionë € detyrime afatgjata. Kthimi i këtyre detyrimeve është mjaft i pasigurt, marrë parasysh faktin se të gjithat janë në kufij të rentabilitetit, e në terma real, operojnë edhe me humbje. Madje, parimi i vijimësisë së veprimtarisë në disa prej tyre, mund të vije në pikëpyetje serioze.

Pasi që mbi 89,3 milionë € janë obligime afatshkurtra, ekziston rreziku që këto ndërmarrje të mos jenë në gjendje t'i përmbushin këto detyrime. Në një situatë të tillë, Qeveria do të jetë nën presion që t'i mbulojë disa deficite të këtyre ndërmarrjeve për t'iu shmangur procedurave të falimentimit për shkak të interesit publik. Kështu që, nëse nuk merren masa për hartimin e strategjive për tejkalimin e situatës së krijuar, barra financiare e Qeverisë do të ngarkohet edhe më shumë.

Konkluzionet tona janë se Bordet Drejtuese të ndërmarrjeve publike, nuk ishin mjaftueshëm të përkushtuara për vendosjen e politikave dhe strategjive për tejkalimin e gjendjes jo të mirë në të cilat ndodhen ato ndërmarrje. Prandaj, përfshirja më aktive e Aksionarit në zgjidhjen e problemeve është e domosdoshme.

Rekomandojmë Qeverinë, Ministrinë e Ekonomisë dhe komunat që:

- Të sigurojnë që Bordet e Drejtorëve kanë analizuar rezultatet financiare të ndërmarrjeve publike, kanë hartuar dhe siguruar zbatimin e planeve të biznesit me qëllim të përmirësimit të gjendjes financiare dhe afarizmit të këtyre ndërmarrjeve.

Shtojcat:

- Shtojca 1: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna në RVA-në 2019;
- Shtojca 2: Shpjegimi i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA-ja; dhe
- Shtojca 3: Pasqyrat kryesore financiare të Qeverisë.

Shtojca I: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna në RVA 2019

Institucioni përgjegjës	Rekomandimet e dhëna në RVA-në 2019	Progresi në zbatimin e rekomandimeve Përshkruani çfarë masa janë ndërmarrë për zbatimin e rekomandimeve Paraqitni dëshmitë nëse ka		
		Të zbatuara	Pjesërisht të zbatuara	Të pazbatuara
Kuvendi i Kosovës		<i>Kapitulli 1 Auditimi i PFV-ve 2019</i>		
	<ul style="list-style-type: none"> Komisionet parlamentare për Buxhet dhe Financa, si dhe ai për Mbikëqyrje të Financave Publike duhet t'i forcojnë kontrollet monitoruese ndaj Qeverisë dhe Kuvendit në mënyrë që Kuvendi i Kosovës, para se të miratojë Ligjin vjetor të ndarjeve buxhetore për vitin vijues, duhet të sigurohet se të gjitha shpenzimet janë planifikuar sipas kategorive ekonomike adekuate. 		<ul style="list-style-type: none"> Sipas raporteve individuale të auditimit, rastet janë reduktuar, megjithatë, ende ekzistojnë raste të keqklasifikimit të shpenzimeve si pasojë e planifikimit jo adekuat të shpenzimeve. 	
Qeveria e Kosovës / Ministria e Financave	<ul style="list-style-type: none"> Ministria e Financave duhet të vazhdojë me masat e filluara me përmirësimin e kontrolleve buxhetore, në mënyrë që shumat e keqklasifikuara me buxhet të reduktohen sa më shumë; Departamenti i Makroekonomisë, në Tabelën 1 të shpalos planin e të hyrave jo tatimore të nivelit qendror, sipas OB-ve, dhe i njëjti të shërbejë si plan i të hyrave për secilën OB në pasqyrat financiare; Me rastin e planifikimit të të hyrave buxhetore, të sigurojë se ekzistojnë analiza të mjaftueshme dhe të qarta për dokumentimin e burimeve përkatëse të të hyrave. Departamenti i Makroekonomisë, Departamenti i Buxhetit dhe Thesari duhet të punojnë ngushtë për eliminimin e këtyre gabimeve, para se Plani 	<ul style="list-style-type: none"> I zbatuar I zbatuar 	<ul style="list-style-type: none"> Sipas Departamentit të Buxhetit Udhëzimi Administrativ për kriteret përzgjedhëse të projekteve kapitale ka filluar të implementohet që nga 01.01.2020. Për Nivelin Lokal kemi arritur t'i mbajmë në këtë standard, por për nivelin qendror Qeveria ka vendosur me i kthyer këto në buxhet. Projekt propozimet në nivel lokal që nuk kanë plotësuar kriteret nuk janë lejuar të bëhen pjesë e buxhetit, kanë mbetur në rezervë komunale, por është lenë mundësia që gjatë vitit fiskal kurdo që komuna e caktuar i plotëson kriteret për projekt të ri kapital, lejohet të bëhet pjesë e buxhetit pas aprovimit nga Kuvendi i Komunës. Kurse, në nivel qendror, qeveria ka vendosur që projekt propozimet që janë 	

	<p>buxhetor t'i dorëzohet Qeverisë. Në veçanti, duhet të bashkëpunojnë lidhur me të dhënat e paraqitura në Tabelën 1 dhe të analizohen ndikimet e mëvonshme në Pasqyrat Financiare;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Thesari të kërkojë nga komunat që ta dërgojnë planin e rrjedhës së parasë edhe për të hyrat vetjake të bartura, ashtu që të ketë një financim të balancuar të buxhetit, gjithnjë duke respektuar të drejtën që komunat e kanë për të destinuar këto mjete në kohën dhe projektet e caktuara; dhe • Me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit të Buxhetit, për të gjitha lëvizjet dhe ndryshimet në librat kontabël të SIMFK-së duhet të mbeten gjurmë, ndërsa vetëm Thesari si ekzekutues i buxhetit (përkatësisht zbatues i ligjit) të realizojë ndryshimet në librat kontabël, duke përfshirë ekzekutimin e të gjitha vendimeve për ndryshime të ndarjeve buxhetore në përputhje me vendimet e marra në pajtim me legjislacionin. 		<p>lenë në rezerve nga DB për shkak të mos plotësimit të kushteve, janë kthyer sërish pjesë e buxhetit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Edhe gjatë vitit 2021 nuk ka ndodhur përgatitja e planit të rrjedhës së parasë për fondin burimor të hyrat vetanake të bartura nga viti 2020 për vitin 2021, për Organizata Buxhetore niveli lokal (komunat). • Departamenti i buxhetit edhe në vitin 2020 ka bërë ndryshimet në librat kontabël, me rastin e ndarjeve, rindarjeve dhe transfereve buxhetore.
2.1.2 Realizimi i të hyrave Buxhetore				
<p>Qeveria e Kosovës</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë se janë krijuar të gjitha kushtet që stafi i punësuar në bazë të Marrëveshjes së Brukselit të vijoj procesin normal të punës. Deri atëherë, në listën e pagave të Thesarit, norma e punës duhet të jetë zero (0). Në të kundërtën, këto pagesa duhet të ndërpriten dhe vazhdimi i këtyre pagesave mund të bëhet nga kategoria e subvencioneve, me një bazë ligjore të mirëfilltë, sepse askush nuk duhet të kompensohet në emër të pagave, përderisa nuk kryen asnjë detyrë pune në interes të punëdhënësit. 			<ul style="list-style-type: none"> • I pazbatuar

Ministria e Financave	<ul style="list-style-type: none"> MF-ja duhet që përfundimisht me rastin e përgatitjes së Buxhetit fillestar të sqarojë të gjithë zërat buxhetor në mënyrë që bartja e të dhënave nga Tabela 1 në Pasqyra Financiare të jetë e qartë, konsistente dhe pa gabime; dhe Ministri i Financave dhe Departamenti i Buxhetit duhet të sigurojnë se me rastin e aplikimit të organizatave buxhetore për fonde shtesë për nevoja urgjente apo të paparashikuara, të shpjegojnë në hollësi rrethanat të cilat kanë shkaktuar nevojën për këto fonde, të shpjegohen arsyet pse këto rrethana nuk kanë mundur të parashikohen dhe të identifikohen me rastin e përgatitjes së rregullt të buxhetit, dhe pas shqyrtimit nga Ministria e Financave, të dërgohen në Qeveri për aprovimin dhe ndarjen e këtyre fondeve nga rezerva. 	<ul style="list-style-type: none"> Për vitin 2021 kjo çështje është e rregulluar. I zbatuar 		
3.3 Borxhet publike dhe Garancitë shtetërore				
Qeveria e Kosovës	<ul style="list-style-type: none"> Qeveria duhet që t'i shqyrtojë raportet periodike për borxhet publike të Ministrisë së Financave, dhe të analizojë ngeçjet e identifikuar. Gjithshtu, në baza periodike të analizojë kushtet dhe kriteret për përzgjedhjen e projekteve për financim, buxhetim dhe monitorimin e shfrytëzimit të fondeve të huamarrjes, si dhe të shqyrtojë vonesat eventuale në tërheqjen e këtyre fondeve. 		<ul style="list-style-type: none"> Qeveria kishte shqyrtuar raportete për borxhet publike të MF-së, mirëpo edhe në vitin 2020 ka pasur vonesa në disbursimin e mjeteve, për shkak të mosplotësimit të kushteve të marrveshjeve për disbursimin e mjeteve që kane të bëjnë me projekte të caktuara. 	
Ministria e Financave	<ul style="list-style-type: none"> Ministria e Financave, duhet të vazhdojë me veprimet e ndërmarra në adresimin e projekteve që financohen nga huamarrja dhe t'i paraqesë dy herë në vit Qeverisë për informim dhe shqyrtim raport të konsoliduar të progresit të projekteve, duke i identifikuar sfidat 		<ul style="list-style-type: none"> Në bazë të inputit nga OB-të zbatuese të projekteve Thesari gjatë vitit 2020 ka përgatitur dhe dërguar në Qeveri për informim dhe shqyrtim dy raporte gjashtë mujore 	

	<p>përkatëse dhe duke propozuar masat për tejkalimin e tyre;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të miratojë ligjin e rishikuar të borxhit publik i cili ka adresuar në masë të konsiderueshme aspektet e trajtuara në këtë raport, që ka të bëjë me hyrjen në borxh dhe një qasje të bazuar në vlerësimin e nevojave nga MF dhe jo nga organizatat zbatuese me kreditorët; dhe • Para aprovimit të buxhetit (projekteve kapitale dhe jo vetëm), të monitorojë zbatimin e kriterëve përzgjedhëse si dhe prioritetëve të projekteve. Miratimi i projekteve duhet të bëhet vetëm nëse për to janë kryer të gjitha përgatitjet dhe ekziston siguri e mjaftueshme dhe e dokumentuar se realizimi i projekteve do të bëhet në kohën e duhur. 		<ul style="list-style-type: none"> • Ligji për borxhin publik është në proces dhe pritet që në vitin 2021 të dërgohet në Qeveri për aprovim. • Sipas Departamentit të Thesarit, gjatë monitorimit dhe zbatimit të kriterëve përzgjedhëse si dhe prioritetëve të projekteve në aspektin e monitorimit respektohet Udhëzimi administrativ për kriterë përzgjedhëse të projekteve kapitale. Ka hyrë në fuqi me 1 janar 2020 dhe OB kanë obligim ligjor zbatimin e këtij UA, nëse OB-të nuk reflektojnë, MF-ja nuk do të përfshijë në propozim-buxhetin që dërgohet në Qeveri. Qeveria ka vendosur që projekt propozimet që janë lënë në rezervë nga DB-ja për shkak të mosplotësimit të kushteve për Organizatat Buxhetore te niveli qendror, janë kthyer serish si pjesë e buxhetit. 	
4. Pasuritë dhe Stoqet				
<p>Qeveria e Kosovës</p>	<p>Pjesërisht përsërisim rekomandimet e vitit të kaluar se Qeveria duhet të luaj një rol proaktiv në adresimin e të gjitha çështjeve lidhur me menaxhimin e pasurive dhe të ndërtoj mekanizma llogaridhënës që:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të gjitha organizatat t'i përmbushin detyrimet ligjore, duke i regjistruar dhe raportuar saktë të gjitha pasuritë në posedim; dhe • Të merr masa për funksionalizimin e plotë të sistemit e-pasuria, si një problem i trashëguar për vite me radhë. Në të kundërtën, të shfuqizojë pjesën e rregullores e cila i obligon OB-të që ta përdorin këtë sistem, dhe të dhënat të mbahen veçmas në programe tjera të OB-ve. 		<ul style="list-style-type: none"> • Kjo çështje nuk është e përhapur në të gjitha OB-të, megjithatë ende ekzistojnë sfida në këtë proces, qoftë në sistem apo edhe te organizatat individuale. 	<ul style="list-style-type: none"> • I pazbatuar, çështjet e njëjta janë përsëritur në raportet individuale të auditimit.

Ministria e Financave	<ul style="list-style-type: none"> Thesari përmes trajnimeve të fund vitit lidhur me hartimin e Pasqyrave financiare, të fuqizoj kërkesën që të gjitha organizatat buxhetore t'i themelojnë me kohë komisionet e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive, dhe rezultatet e inventarizimit t'i reflektojnë në pasqyrat financiare të fundvitit; dhe Me rastin e pranimit të PFV-ve nga organizatat buxhetore, të vendosë kontrolle formale në veçanti lidhur me raportimin e stoqeve me gjendjen zero, dhe në rastet e tilla të kërkoj sqarime, ngase në raportet e tri viteve të fundit ka diferenca të theksuara dhe raportim të mangët. 	<ul style="list-style-type: none"> Thesari i Kosovës në bashkëpunim me USAID-in ka organizuar takim virtual dy ditor me OB-të duke adresuar rekomandimet e dalura nga RVA-ja 2019, në takim është kërkuar nga OB-të respektimin rregullores financiare për menaxhimin e pasurive jofinanciare. 	<ul style="list-style-type: none"> Sipas raporteve individuale të auditimit ende ekzistojnë raste të tilla. 	
5. Llogaritë e Arkëtueshme				
Qeveria, Ministria e Financave dhe MAPL-ja	<ul style="list-style-type: none"> Në koordinim me komunat dhe organizatat tjera që krijojnë të hyra, duhet të analizojnë në hollësi strukturën e këtyre llogarive, vjetërsinë si dhe gjasat për t'i inkasuar këto borxhe të trashëguara për vite me radhë. Gjithashtu, nga OB-të duhet të bëhet një vlerësim se cilat nga këto borxhe përmbushin kriteret e borxheve të këqia dhe të njëjtat të shlyhen nga llogaritë aktive. Qeveria duhet të shqyrtojë edhe masat 			<ul style="list-style-type: none"> I pazbatuar, llogaritë e arkëtueshme janë në rritje dhe gjendja nuk është përmirësuar.

	tjera stimuluese, duke mos përjashtuar edhe masat ligjore për inkasimin e tyre.			
6. Detyrimet e papaguara dhe Kontingjente				
Ministria e Financave	<ul style="list-style-type: none"> Ministria e Financave në koordinim me organizatat që kanë detyrime të papaguara, me rastin e ndarjeve buxhetore duhet të kenë prioritet të parë ndarjen e fondeve për pagesën e faturave apo detyrimeve nga vitet e mëhershme në mënyrë që të mënjanohen shpenzimet shtesë të kamatave dhe shpenzimet tjera administrative. 		<ul style="list-style-type: none"> Thesari i Kosovës ka derguar një draft raport të obligimeve të raportuara nga OB-të për vitin 2020 tek Departamenti i Buxhetit, ndërsa versionin final të raportit do të dërgoj në momentin e konsolidimit të RFV-ve 2020 dhe obligimet e OB-të do të diskutohen dhe trajtohen gjatë procesit buxhetor 2021 (rishikimit) dhe 2022. 	
6.1 Detyrimet Kontingjente				
Ministria e Financave/ Thesari/ MD dhe Avokatura Shtetërore	<ul style="list-style-type: none"> Ministria Financave duhet të udhëzojë dhe kërkojë nga organizatat buxhetore të bëhet një vlerësim i përafërt i detyrimeve kontingjente në mënyrë që shpalosjet në RFV të jenë sa më të plota dhe të merren në konsiderate për analiza të mëtejme për adresimin e këtyre detyrimeve. Aty ku gabimisht nuk janë bartur shënimet në PFV-të, të njëjtat të korrigjohen për vitin e ardhshëm dhe që të sigurohen se evitohen gabimet teknike gjatë raportimit. 		<ul style="list-style-type: none"> Thesari ka kërkuar nga të gjitha OB-të në kuader të takimit vjetor me OB-të, respektimin e rregullores për raportim vjetor financiar të organizatave buxhetore, pjesë e së cilës rregullore janë edhe detyrimet kontingjente në mënyrë që të prezantohet një vlerë e drejtë në bazë të vlerësimeve paraprake. 	
7.1 Pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe përmbartimore				
Ministria e Financave/ MD / MAPL dhe Komunitat	<ul style="list-style-type: none"> Të shqyrtohen të gjitha mundësitë ligjore që për rastet në gjykata, që kryesisht kanë të bëjnë me marrëveshjet kolektive, nga komunat të arrihen marrëveshje jashtë gjyqësore dhe ri-programim i tyre në bazë të mundësive buxhetore dhe të njëjtat t'i planifikojnë në buxhetet e tyre, me qëllim që të shmangin pagesat për tarifa dhe kamata ligjore. Bashkëpunimi me Këshillin Gjyqësor dhe 			<ul style="list-style-type: none"> I pazbatuar

	strukturat tjera, gjithashtu do të ishte i nevojshëm.			
Ministria e Financave	<ul style="list-style-type: none"> • Me rastin e përgatitjes së Buxhetit vjetor të vitit 2021, Ministria e Financave duhet të kërkojë të gjitha të dhënat nga secila organizatë buxhetore lidhur me paditë e ngritura së bashku me një vlerësim nga zyrat ligjore për mundësinë e daljes së parasë, dhe të njëjtat sipas kategorive përkatëse t'i planifikojnë me ndarjet e rregullta buxhetore, në mënyrë që t'i shmangët vështirësive në sigurimin e fondeve për këto pagesa si dhe keqklasifikimit të tyre në kodet ekonomike; • Specifikisht të kërkohet nga të gjitha OB-të që me rastin e kalkulimit të pagave për stafin e tyre, të përlogarisin edhe detyrimet që dalin nga kontratat kolektive dhe të njëjtin plan t'ia dorëzojnë Ministrisë së Financave në mënyrë që këto shpenzime të parashihen me buxhet të rregullt dhe të shmangen proceset gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore shtesë lidhur me këto konteste; dhe • Si alternativë, të shqyrtojë mundësinë e rritjes së fondit kontingjent në Ministrinë e Financave, dhe nga i njëjti fond, të kompenzohen të gjitha pagesat fillimisht, ndërsa me rishikim buxheti apo me rregullimet e fundvitit, të korrigjohet buxheti i organizatave buxhetore për të njëjtat shuma. 			<ul style="list-style-type: none"> • I pazbatuar, gjendja është e njëjtë me keqklasifikime. • I pazbatuar, gjendja është e njëjtë me keqklasifikime. • I pazbatuar, gjendja është e njëjtë me keqklasifikime.
8.1 Të punësuarit jashtë listës së pagave dhe me kontrata për shërbime të veçanta				

Ministria e Financave	<ul style="list-style-type: none"> Ministri i Financave, të shtojë kontrollet dhe bashkë me krerët e organizatave buxhetore të siguroj se me rastin e planifikimeve, organizatat buxhetore kanë bërë analiza të mirëfillta dhe të qëndrueshme si dhe raportimi për të punësuarit faktik të jetë i harmonizuar; dhe Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit, të sigurojnë se institucionet për- katëse do të respektojnë të gjitha kërkesat ligjore sa i përket të punësuarve me marrëveshje për shërbime të veçanta, duke u pershtatur me kërkesat e Ligjit të ri për zyrtarët publik. 	<ul style="list-style-type: none"> Thesari i Kosovës ka ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme duke pasivizuar furnitorët individual në SIMFK dhe lejohen/akti vizohen vetëm pas kërkesës së OB-së dhe arsyeshmëri së bazuar në legjislacioni n në fuqi. 	<ul style="list-style-type: none"> Sipas MF-DB-së përmes qarkoreve dhe gjatë dëgjimeve buxhetore, vazhdimisht kërkon nga OB-të eliminimin e diskrepancës në mes numrit të lejuar dhe numrit faktik të të punësuarve, por ndodh që në Kuvend ose në Qeveri merren vendime për shtimin e numrit të të punësuarve edhe pa buxhet. 	
9.2 Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale 2018				
Kuvendi i Kosovës	<ul style="list-style-type: none"> Përsërisim rekomandimin e vitit të kaluar se Kuvendi duhet të sigurojë që plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve i përgatitur nga Qeveria, është shqyrtuar nga KMFP-ja. Po ashtu, të përcaktoj saktë veprimet, afatet kohore dhe personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve dhe monitorimin e tyre. Po ashtu, të sigurojë që të paktën një herë në vit të shqyrtojë progresin e arritur për rekomandimet e dhëna. 		<ul style="list-style-type: none"> Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve është përgatitur. KMFP-ja, ka rekomanduar Kuvendin që të merret në shqyrtim RVA-ja dhe rekomandimet e dhëna. Mirëpo, nuk është trajtuar progresi i arritur për rekomandimet e dhëna. 	

Kuvendet Komunale	<ul style="list-style-type: none"> Përsërisim rekomandimin e vitit të kaluar që Kryetarët e Komunave t'i diskutojnë në baza të rregullta raportet e menaxherëve përgjegjës për zbatimin e planeve të veprimit, dhe së paku dy herë në vit, të raportojnë në Kuvendin Komunal lidhur me progresin dhe sfidat në këtë fushë. 		<ul style="list-style-type: none"> Raportet kryesisht janë diskutuar në Kuvendet Komunale, por jo në baza të rregullta dhe në të gjitha komunat. Megjithatë, numri i rekomandimeve të përsëritura është i ndjeshëm në raportet individuale të komunave. 	
11. Sistemi i auditimit të brendshëm				
Qeveria / NjQH/AB	<ul style="list-style-type: none"> Menaxhmenti i OB-ve të cilat janë të obliguara të themelojnë NjAB sipas Rregullores QRK-nr. 01/2019, duhet t'i themelojnë këto njësi, ndërsa OB-të që nuk janë të obliguara të kenë NjAB, funksionin e auditimit të brendshëm ta përmbushin përmes mënyrave tjera të parapara me këtë rregullore dhe në përputhje me ligjin për funksionimin dhe organizimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura; dhe Për ta kompletuar sistemin e auditimit të brendshëm, NjAB-t duhet të plotësohen me staf dhe të themelojnë Komitetet e Auditimit për të mbështetur realizimin e objektivave të NjAB-së. Po ashtu, KA-të duhet të jenë efektive në mbajtjen e takimeve dhe të kontribuojnë në rritjen e llogaridhënies dhe forcimin e rolit të AB-së, si dhe të dorëzojnë raporte vjetore të punës, siç kërkohet me UA-në. 		<ul style="list-style-type: none"> Na auditimet individuale, është vërejtur se rastet janë përsëritur por në një nivel më të ulët, një vit më parë kanë qenë pesë ndërsa në këtë vite tre raste. Vitin e kaluar kanë qenë tetë raste, ndërsa në këtë vite janë identifikuar katër raste. 	
12.1 Çështjet e rregullsisë në fushën e prokurimit				
Për Organizatat Buxhetore	<ul style="list-style-type: none"> Ministritë që ndajnë fonde për bashkëfinancim të projekteve në komuna, të caktojnë nga një anëtarë në komisionet e hapjes dhe vlerësimit të ofertave për t'u siguruar se procedurat e prokurimit për projektet e bashkëfinancuara janë zhvilluar në përputhje me legjislacionin 	<ul style="list-style-type: none"> Nuk janë evidentuar raste me çështje të pazgjidhura rreth 		

	<p>dhe të jenë të informuar me kohë për zhvillimin e projekteve; dhe</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të reduktojnë sa më shumë përdorimin e procedurave të prokurimit për kontrata me vlerë minimale në mënyrë që përmes procedurave tjera të sigurojnë një konkurrencë më të hapur dhe të sigurohen çmime sa më të volitshme të tregut. 	komisioneve të vlerësimit.		<ul style="list-style-type: none"> • I pazbatuar
13. Aplikueshmëria e ligjeve dhe sfidat ligjore				
<p>Qeverinë/ Ministrinë e Financave/ dhe Ministrinë e Ekonomisë</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Qeveria të iniciojë ndryshimin e Ligjit të NP-ve dhe të bëjë harmonizimet përkatëse ligjore të datave të raportimeve të auditimit financiar, apo të precizohet/qartësohet mbizotërimi i rregullimeve të përcaktuara me njërin apo tjetrin ligj që rregullojnë këtë çështje; • Qeveria të bëjë interpretim ligjor të mandatit dhe kompetencave të KKRF-së ndërlidhur me auditimin e PVF-ve të NP-ve kur auditohen nga ZKA-ja. Ky interpretim të jetë obligues për KKRF-në, apo në të kundërtën të inicioj plotësim/ndryshimin e ligjit të KRFA-së për t'i eliminuar kundërthëniet e lartpërmendura; dhe • Qeveria në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, në pajtim me ligjet në fuqi dhe vendimin e Qeverisë të ndërmarrë hapat e nevojshme për transferimin e buxhetit nga komunat në AME, respektivisht në MPB. 		<ul style="list-style-type: none"> • Qeveria e kaluar kishte iniciuar ndryshimin e ligjit për NP-të, por meqenëse tani është legjislaturë dhe qeveri e re, ajo duhet të iniciohet përsëri nga fillimi. 	<ul style="list-style-type: none"> • I pazbatuar, ne nuk kemi pranuar ndonjë interpretim ligjor nga Qeveria për kompetencat e KKRF-së. • Nuk ka ndryshim të situatës, gjendja mbetet e njëjtë.
<p>Komunat/ MAPL</p>				

	<ul style="list-style-type: none"> Kryetarët e komunave Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok duhet të sigurojnë zbatimin e ligjeve për mbledhjen e të hyrave, që kanë për qëllim në radhë të parë zbatimin e kërkesave ligjore si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunave përkatëse. Njëherit, duhet të iniciojnë pa vonesë hartimin e rregulloreve të brendshme për taksat, tarifat dhe ngarkesat e qytetarëve për shërbimet e ofruara publike. 			<ul style="list-style-type: none"> Nuk ka ndryshim të situatës, gjendja mbetet e njëjtë.
Ministria e Arsimit dhe Shkencës	<ul style="list-style-type: none"> Ministri i Arsimit duhet të merr masa të menjëhershme që të ndalojë të gjitha pagesat e paligjshme për kompensimin e komisioneve të brendshme në universitetet e përmendura më lart, dhe të kërkojë që statutet e tyre të harmonizohen me ligj. 			<ul style="list-style-type: none"> I pazbatuar
14 Auditimet e performancës				
Kuvendi i Kosovës	<ul style="list-style-type: none"> Përmes Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike, Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe komisioneve relevante për fusha përkatëse, të shqyrtojnë raportet e auditimit të performancës dhe të mbajnë llogaridhënës krerët e institucioneve publike për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të dhëna në raportet e performancës. 	<p>Kuvendi i Kosovës, përmes komisioneve relevante ka ndërmarr veprime për trajtimin e Raporteve të auditimit të performancës dhe teknologjisë së informacionit duke kërkuar llogari dhe mbajtur përgjegjës krerët e organizatave të audituara.</p>		

		<p>Rrjedhimisht në periudhën prill-qershor 2021 nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike janë trajtuar shtatë (7) raporte të auditimit të performancës dhe teknologjisë së informacionit (5 raporte të performances dhe 2 raporte të auditimit të TI-së). Për secilin raport gjatë trajtimit KMFP-ja ka ftuar krerët e organizatave e në disa raste kanë marrë pjese edhe Komisionet e kuvendit të fushave relevante. KMFP-ja ka nxjerrur rekomandimet e veta, po ashtu tri raporte janë dërguar dhe diskutuar edhe në seance</p>		
--	--	--	--	--

		plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.		
Qeveria /Komunat	<ul style="list-style-type: none"> T'i analizojnë rekomandimet të cilat kanë rezultuar nga auditimet e performancës dhe të përgatisin dhe monitorojnë planet e veprimit për zbatimin e tyre. Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve duhet të bëhet duke caktuar dhe mbajtur përgjegjës funksionet përkatëse në organizatë përmes raportimit të rregullt. 		<ul style="list-style-type: none"> Përkundër zotimit në planin e veprimit të Thesarit të Kosovës-Ministrisë së Financave, se Qeveria dhe ministrinë përkatëse do të marrin veprime për shqyrtimin e progresit të zbatimit të rekomandimeve, nuk kanë dëshmuar se kanë marrë ndonjë veprim lidhur me këtë rekomandim. Me përjashtim të përgatitjes së planeve individuale të veprimit nga disa organizata të audituara. Nga 21 organizata përgjegjëse për hartimin dhe dorëzimin e planit të veprimit, prej tyre 11 organizata i kanë hartuar dhe dorëzuar, ndërsa 10 tjera nuk kanë përgatitur planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimet e performancës dhe teknologjisë së informacionit gjatë periudhës shtator 2020 - korrik 2021. 	
15 Ndërmarrjet publike				
Bordet Drejtuese /Aksionaret e Ndermarrjeve	<ul style="list-style-type: none"> Bordet e Drejtorëve të NP-ve përkatëse duhet të analizojnë shkaqet të cilat kanë ndikuar për Modifikim të Opinionit dhe të merren të gjitha veprimet e nevojshme që çështjet të cilat kanë ndikuar në opinion të korrigjohen apo parandalohen. Gjithashtu, të sigurojnë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që hartimi i PFV-ve të vitit 2020 i adreson të gjitha çështjet që janë ngritur nga auditimi i PFV-ve të vitit 2019; dhe Aksionarët të mbajnë përgjegjës Bordet Drejtuese të NP-ve përkatëse dhe të kërkojnë llogari për përgatitjen e drejt dhe korrekte të 		<ul style="list-style-type: none"> BD-të kanë bërë vlerësime të shkaqeve dhe rreziqeve që kanë qar në modifikim të opinionëve, por opinionet të shumica e NP-ve mbetën të njëjta edhe këtë vit. Aksionaret i kanë mbajtur përgjegjës BD-të dhe në shumicën e rasteve i kanë ndryshuar dhe zëvendësuar duke i emëruar BD-të e përkohshme deri në zgjedhjen e tyre me konkurs. 	

	PFV-ve, si dhe zbatimin e rekomandimeve në të gjitha fushat.			
15.4 Analiza e gjendjes financiare në ndërmarrjet publike				
Qeveria/ Ministria e Zhvillimit Ekonomik/ Komunat	<ul style="list-style-type: none"> Në bashkëpunim me Bordet e Drejtorëve, të analizojnë rezultatet financiare të ndërmarrjeve publike, me theks të veçantë të atyre që me vite operojnë me humbje, marrjen e masave për një riorganizim të tyre, analizën e detyrimeve afatshkurtëra dhe hartimin e planeve strategjike me masa konkrete përmirësuese; dhe Aksionarët të shqyrtojnë performancën e Bordeve të Drejtorëve, dhe aty ku ka nevojë në përmbushjen e detyrave, të merren masa për rritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies. 		<ul style="list-style-type: none"> Qeveria në disa raste për shkak të performances së pamjaftueshme i kishte shkarkuar disa nga BD-të të NP-ve të nivelit Qendror. 	<ul style="list-style-type: none"> I pazbatuar, ne nuk kemi pranuar ndonjë analizë të rezultateve financiare të qeverise për NP-të.

Shtojca II: Shpjegimi i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionit i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe i përhapur.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin ‘Theksim i çështjes’ ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç’pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe

- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shtojca III: Letra e konfirmimit

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansija Ministry of Finance Arkiva - Arhiva - Archive			
Nr. Org. Org. Jedin. Org. Unit:	01/400	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.:	1335/2021
Nr. i faqever Broj stranica No. pages:	✓	Data Datum Date:	27/08/2021
Drejtore PRISHTINE/A			



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo za Finansija -

Ministry of Finance, Labor and Transfers

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të Buxhetit Republikës së Kosovës, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Hekuran Murati

Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve

Data: 27 gusht 2021, Prishtinë



Shtojca IV: Pasqyrat kryesore financiare të Qeverisë 2020

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme për Qeverinë e Përgjithshme

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020

	Shënim	2020	2019	2018
		Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €	Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €	Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €
PRANIMET				
Tatimet Direkte				
Tatimi në të ardhura të korporatave	2	85,279	94,593	86,797
Tatimi në të ardhura personale	3	157,966	165,616	152,820
Tatimi në pronë	4	22,707	27,277	24,196
Tatime tjera direkte	5	1,294	4,773	3,692
		267,247	292,259	267,504
Tatimet Indiekte				
Tatimi mbi vlerën e shtuar	6	770,145	845,647	799,020
Detyrimi doganor	7	101,618	130,325	123,748
Akciza	8	398,072	435,496	418,903
Tatime tjera indirekte	9	2,900	3,822	2,460
		1,272,735	1,415,291	1,344,130
Kthimet tatimore				
Kthimet tatimore	10	-32,999	-45,507	-47,880
		-32,999	-45,507	-47,880
Të hyrat jo-tatimore				
Taksa, ngarkesa dhe tjera nga OB-të Qeveria Qendrore	11	103,486	121,405	110,398
Taksa, ngarkesa dhe tjera nga OB-të Qeveria Lokale	12	42,716	50,050	46,350
Taksa koncesionare	13	2,651	11,083	8,792
Renta minerare	14	29,362	29,385	25,234
Të hyrat nga interesi (kreditë për NP)	15	2,986	2,691	2,092
		181,201	214,614	192,865
Huamarrja				
Huamarrja e jashtme shtetërore	16	211,389	35,040	11,334
Pranimet për shërbimin e nën-huazimeve	17	7,688	7,901	8,250
Huamarrja e brendshme shtetërore	18	169,955	115,322	102,434
		389,031	158,264	122,018
Grantet dhe ndihmat				
Grantet e përcaktuara të donatorëve	19	9,048	7,987	8,319
Grantet për mbështetje buxhetore	20	34,030	11,500	-
		43,078	19,487	8,319
Pranimet tjera				
Fondi i depozitave	21	1,018	2,081	3,612
Kthimet e kredive nga ndërmarrjet publike	22	11,387	10,876	10,876
Të hyrta e dedikuara	23	2,473	5,555	10,493
Financimi i njëhershëm i AKP-së	24	71,476	150,002	86,146
Financimi i njëhershëm nga FKPK-së	25	-	-	11,590
Gjithsej Pranimet		2,206,647	2,222,922	2,009,673
PAGESAT				
Operacionet				
Paga dhe shtesa	26	661,343	616,921	592,587
Mallra dhe shërbime	27	280,007	273,313	229,057
Shërbime komunale	28	22,168	24,866	23,440
		963,518	915,099	845,085
Transferet				
Subvencione dhe transfere ¹	29	868,480	627,959	558,778
Shpenzimet kapitale				
Prona, impiantet, pajisjet, transferet ²	30	384,471	533,773	533,064
Pagesat tjera				
Pagesa e borxhit	31	115,713	74,633	40,741
Kthimet nga fondet e depozitave	32	2,761	1,082	1,890
Gjithsej Pagesat		2,334,943	2,152,546	1,979,559
Rritje/Zbritje në para të gatshme		(128,295)	70,376	30,115
Para të gatshme në fillim të vitit	33	458,251	387,874	357,760
Para të gatshme në fund të vitit	33	329,955	458,251	387,874

¹ Përfshihet shpenzimi i aprovuar në SIMFK nga MASHT në shumë prej 270 mijë euro, për të cilin transaksion dalja nga LLVTH ka ndodhur në vitin 2021.

² Në kuader të shpenzimeve kapitale është përfshirë edhe shuma prej 2,077,995.90 euro si dalje e pa autorizuar e fondeve nga kategoria e kapitaleve të organizatës buxhetore Ministria e Infrastruktura (shënim 30). Kjo shumë e fondeve nga aspekti kontabël trajtohet si kërkesë për fonde dhe është prezantuar në aneksin 11.

Pasqyra e konsoliduar e krahasimit të buxhetit me realizimin për Qeverinë e Përgjithshme

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020

	2020				2019	2018
	Realizimi	Buxheti përfundimtar	Buxheti fillestar	Ndryshimet buxhetore	Realizimi	Realizimi
	A Shënim '000 €	B '000 €	C '000 €	D = B - A '000 €	'000 €	'000 €
RRJEDHA HYRËSE E PARASË SË GATSHME						
Tatimet direkte	267,247	282,410	312,000	15,163	292,259	267,504
Tatimet indirekte	1,272,735	1,322,392	1,521,000	49,657	1,415,291	1,344,130
Kthimet tatimore	(32,999)	(39,631)	(50,000)	(6,631)	(45,507)	(47,880)
Të hyrat jo-tatimore	181,201	188,913	226,487	7,712	214,614	192,865
Grantet dhe ndihmat ³	43,078	46,410	22,500	3,332	19,487	8,497
Huamarrja	389,031	596,200	323,474	207,169	158,264	122,018
Pranimet tjera ⁴	86,355	244,609	124,609	158,254	168,514	122,717
Gjithsej Pranimet	2,206,647	2,641,303	2,480,070	434,655	2,222,922	2,009,851
RRJEDHA DALËSE E PARASË SË GATSHME						
Shërbimet e përgjithshme publike	287,820	444,606	362,148	156,785	285,221	204,611
Mbrojtja	59,653	65,079	69,569	5,427	49,936	46,477
Rendi dhe siguria publike	204,834	218,821	207,569	13,986	197,747	176,342
Çeshtjet/marrëdhëniet ekonomike ⁵	462,356	610,833	458,558	148,477	404,517	450,818
Mbrojtja e ambientit	14,780	28,182	35,105	13,402	23,672	16,447
Çeshtje banimi dhe komuniteti	37,227	55,172	55,099	17,944	43,706	43,212
Shëndetësia	261,683	302,480	238,424	40,798	220,805	199,806
Rekreacion,kulturë religjion	51,790	71,394	78,182	19,604	60,992	57,080
Arsim ⁶	313,146	343,547	374,162	30,401	323,007	301,877
Mbrojtja sociale	550,685	553,699	478,047	3,014	490,679	440,435
Të tjera ⁷	90,969	153,000	144,873	62,031	52,264	42,631
Gjithsej Pagesat	33 2,334,943	2,846,813	2,501,734	511,870	2,152,546	1,979,737
Deficiti/Suficiti	(128,295)	(205,510)	(21,664)	(77,215)	70,376	30,115

³ Te planifikimi buxhetor (kolona B dhe C) përfshihen grantet e percaktuara te donatoreve (12 milionë euro) si dhe grantet per mbeshtetje buxhetore (34 milionë euro, respektivisht 10.5 milionë euro te kolona C), si fonde të pranuar në LLVTH.

⁴ Përfshihen: të hyrat e dedikuara, kthimet e kredive nga ndërmarrjet publike, të hyrat e njëhershme të AKP-së, pranimet nga depozitat, si dhe pranimet nga të hyrat e bartura të komunave (22 milionë euro). Ky pozicion te planifikimi buxhetor (kolona B dhe C) është pasqyruar në përputhje me tabelën 1 të Ligjit të Buxhetit Nr. 07/L-001 dhe Ligjit Nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit me Nr. 07/L-001, ndërsa sipas kërkesave te standardeve te kontabilitetit për sektorin publik (SNKSP) nuk trajtohen si pranime në LLVTH (veçse janë pjese e bilancit bankar të vitit paraprak), por meqë janë planifikuar si pranime - burim i financimit (pra vetem si e hyrë) sipas ligjit të buxhetit (Tabelës 1), pozicioni pranimet nga të hyrat e bartura të komunave është paraqitur në këtë pasqyrë, ashtu siç është aprovuar me ligjin e buxhetit Nr 06/L-133 dhe Ligjit Nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit me Nr. 07/L-001, dhe praktika nga PF të vitit 2019.

⁵ Është përfshirë si pagesë edhe shuma prej 2,077,995.90 siç shpjegohet në fusnoten 1, në kuader të pasqyrës së pranimeve dhe pagesave.

⁶ Përfshihet shpenzimi i aprovuar në SIMFK nga MASHT, siç paraqitet ne fusnoten 1.

⁷ Përfshihen, pagesa e kryegjësë, nen-huazimi dhe kthimet nga fondet e depozitave.

Pasqyra e konsoliduar e pasurive financiare dhe bilanceve të fondeve për Qeverinë e Përgjithshme

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020

	<u>Shënim</u>	<u>2020 Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €</u>	<u>2019 Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €</u>	<u>2018 Llogaria e Vetme e Thesarit '000 €</u>
Pasuritë financiare - paraja e gatshme				
Banka Qendrore e Kosovës	34	316,897	444,301	374,663
Kuotat në IFN	35	1,741	1,741	1,741
Fondi në mirëbesim për zhvillim	36	1,971	4,754	4,514
Paratë e gatshme në transit	37	4,851	4,632	4,031
Llogaritë e Ambasadave të Republikës së Kosovës	38	1,751	1,135	1,074
Paratë e gatshme në dorë (arka) dhe avance te hapura	39	2,744	1,687	1,851
Gjithsej pasuritë financiare dhe para të gatshme		<u>329,955</u>	<u>458,251</u>	<u>387,874</u>
Qëllimet specifike				
Të përcaktuara nga donatorët	40	9,752	8,865	7,803
Të hyrat vetanake të bartura - niveli qendror	41	1,765	5,741	3,931
Të hyrat vetanake të bartura - niveli lokal	42	55,994	49,477	44,308
Fondi në mirëbesim për zhvillim	43	7,078	6,837	7,514
Të hyrat e dedikuara	44	52	803	1,706
Të tjera	45	15,894	17,504	16,432
Fondet e pashpenzuara nga huamarrja ⁸	46	3,891	7,000	-
		94,425	96,227	81,695
Të pashpërndara		<u>235,530</u>	<u>362,023</u>	<u>306,179</u>
Gjithsej Bilanci i Fondeve	33	<u>329,955</u>	<u>458,251</u>	<u>387,874</u>

⁸Përfshihet shuma e pashpenzuar e mjeteve të kredisë së disbursuar për projektin: "Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore 10 nga kreditori Banka Evropiane për Investime". Për detaje referohu tek aneksi 21.1